



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3420 · e hënë, 23 korrik 2018

19°C | 30°C

15 DEN

EDITORIAL

**Kosova
e përçarë
përballë
Serbisë dinake**



Kosova po shkon e përçarë në tryezat e bisedimeve ku po vendoset për fatin e saj. Kauzat opozitare në Prishtinë ende quhen blasfemi, kurse "baballarët" e kombit po dalin secili më axhami se tjetri. Një aeroplan privat që iu kishte "dorëzuar" kursit amator të fluturimit, mund të jetë përshkrimi më adekuat i asaj çka po ndodhë aktualisht në Kosovë. Edhe po të mendohej mirë si synopsis regjie, ky kurs fluturimi i "bacave dhe çunave"

Fq.2

AKTUALE

**Rreth
një miliard
euro nga
diaspora hyjnë
në Maqedoni**

Fq.7

DOSSIER

**Si i morën
armët e
Skënderbeut
austriakët**

Fq.19



SHQIPTARËT DHE REFERENDUMI

UNITET VEPRIMI PËR NJË KONSENSUS KOMBËTAR



Ana shqiptare duhet të jetë pro referendumit kategorikisht me kushtëzimin që një Ligj kushtetues mbi identitetin shqiptar të jetë pjesë integrale e ndryshimeve kushtetuese përballë dhe si plotësim i brendshëm ndaj ndryshimeve kushtetuese që i rekomandon "Marrëveshja për emrin"

Fq.3

Kumanovë, treni godet për vdekje tre persona

Tre persona nga Haraçina e Shkupit, dje (të dielen) kanë humbur jetën pasi që një tren transportues e ka goditur veturën "Golf" në kalimin e fshatit Ramanli të Kumanovës, informon Ministria e Punëve të Brendshme.

Fatkeqësia ka ndodhur në orën 11:45 përpara stacionit hekurudhor "Terminali" mes stacioneve hekurudhore Kumanovë dhe

Ramanli në një kalim të shenjzuar për kalim.

Në fatkeqësi kanë humbur jetën vozitësi N.B dhe bashke udhëtarët S.B. dhe Z.B., ndërkaq bashkudhëtarë i katërt ka arritur që të kërcejë nga vetura përpara se ta godet veturën treni. Prokurori publik dhe ekipi i SPB Kumanovë kryejnë ekspertizë të vendin e ngjarjes.



**KOHA për
sport**

Fq.12-15

EDITORIAL

KOSOVA E PËRÇARË
PËRBALLË SERBISË DINAKE

Emin AZEMI

Kosova po shkon e përçarë në tryezat e bisedimeve ku po vendoset për fatin e saj. Kauzat opozitare në Prishtinë ende quhen blasfemi, kurse "baballarët" e kombit po dalin secili më axhami se tjetri. Një aeroplan privat që iu kishte "dorëzuar" kursit amator të fluturimit, mund të jetë përshkrimi më adekuat i asaj çka po ndodhë aktualisht në Kosovë. Edhe po të mendohej mirë si synopsis regjie, ky kurs fluturimi i "bacave dhe çunave" të Kosovës, nuk do të dilte më mirë për të shprehur gjithë këtë kaos veprimi politik, mu në kohën kur sërish janë aktivizuar idetë dhe opcionet për ripërkufizimin e hartës së Kosovës. |

Prishtina nuk po arrin të demonstrojë një lidhshmëri unike dhe të fuqishme përballë kanosjeve që vijnë nga jashtë, sidomos nga Serbia. Debatet në Kuvend janë një përplasje modeste për të diferencuar disponimin politik, por edhe kjo nuk po mjafton që të krijohet një alternativë e pushtetit aktual. Tani për tani LDK dhe VV janë ende larg idesë për të qenë unikë në shumë çështje që sa janë të përbashkëta, po aq janë edhe funksionale për t'u vënë në lëvizje. Opozitës kosovare i mungon një ventil që do ti shërbente asaj për zbrazjen e energjive negative në momentet më vendimtare kur ajo duhet të jetë e bashkuar. Historia e mospajtimeve sikur është më shumë e rëndësishme se sa ardhmëria e përbashkët. Gjithmonë kur peshorja e mospajtimeve projektohet si kauzë madhore që zëvendëson bashkëpunimin, opozita vazhdon të ngelë një kafshatë e lehtë për çdo pushtet të uritur. Kosova aktualisht ka më shumë çështje që e bënë të përbashkët veprimin politik opozitar, se sa çështje të kundërta. Tingëllon disi paradoksale kjo kokëfortësi e opozitës kosovare për t'u betonuar në istikamet e dallimeve, ndërkohë që Kosova çdo ditë e më tepër po rrëshqet në honet e paqartësive.

Bisedimet e pambaruara me Beogradin, çështjet e padefinuara rreth statusit të serbëve, lëshimi si ballon provues i temave që lidhen me ndarjen e Kosovës, janë peshat të rënda për çfarëdo lloj skene politike, e sidomos për ato që nuk janë të ngritura mbi një konsensus të fuqishëm pushtet-opozitë. Mund të radhiten shumë shembuj në historinë më të re të shteteve të rajonit, por edhe më gjerë, që dëshmojnë për domosdonë e unifikimit të veprimit politik para vendimeve të mëdha. Vetëm Kosova sikur po mundohet të na thotë se vendimet e mëdha i bie edhe pa patur nevojë të konsolidohet skena politike me të gjitha nuancat e veprimit politik e institucional. Por, kjo është e pamundur.

Në Kosovë mund të ketë politikanë që më tepër iu japin rëndësi kauzave të tyre personale, se sa atyre kolektive, por kjo është një kosto e riparueshme që shkon në dëm të gjithë qytetarëve të saj. Kauzat personale madje në botën e qytetëruar po përjashtohen edhe nga korporatat e mëdha ku vendimarrja menaxheriale po ndjek konkluzionet dhe ekspertizat e stafit profesional, e më pak të një menaxheri të vetëm, sado që të jetë i zoti ai. Fundja, Kosova nuk është biznes familjar i askujt për t'u trajtuar me qasje kaq të ngushtë e subjektivistike dhe përgjegjësi për të drejtuar Kosovën nuk do të duhej kuptuar si luftë për jetë e vdekje të individëve, por si përgjegjësi politike dhe ndërgjegje qytetare e një ekipi më të gjerë të njerëzve.

Shumë kush sot e ka të paqartë se çka po ndodhë me lidhshmërinë aktual të Kosovës. Paqartësia bëhet edhe më e madhe kur të ndiqet grafikoni i ngjarjeve që si rezultat kanë zgjidhjet finale dhe afatgjata për Kosovën. Nëse para Rambujesë dilemat e lidhshmërisë kosovare lëviznin në një qarkorë kontradiktash politike e pragmatike, sot Kosova vuan një tipologji tjetër kontradiktash, e që lidhet parasegjithash me mosunifikimin e mendimit dhe veprimit opozitar. Përderisa në Rambuje, Kosova pati një përfaqësim gjithëpërfshirës, madje edhe nga sektori joqeveritar, sot ajo në bisedimet me Serbinë dhe në temat akute që sfidojnë të ardhmen e saj, shkon e dezintegruar politikisht dhe me një deficit të madh moral përfaqësimi. Kosova e përçarë përballë një Serbie dinake dhe agresive, është hilja më e madhe që iu bëhet sakrificave të gjithë atyre që luftuan për lirinë dhe pavarësinë e saj.

Ku po rreziten vetarët mashtrues?

"E kemi harru një temë shumë të rëndësishme. Kah janë më shumë kah rreziten këta veteranet mashtrues, me ato 300 mijë euro tonat?"

Hiç nuk besoj që kane shku në rivieren shqiptare.

Garant janë kah bajne spektakël nëpër Mal të Zi apo Bullgari.

Edhe nuk i publikuan hiq emrat e veteranëve që do të shkojnë në deti me taksa tona. Shumë janë fulliranta", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, gazetari nga Prishtina Parim Olluri.

Vetëm zgjedhjet mund t'ia kthejnë
legjitimitetin institucioneve të Kosovës

"Koalicioni fitues i zgjedhjeve i përbërë nga Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma për Kosovën, Partia e Drejtësisë, Lëvizja për Bashkim, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, Partia Konservatore e Kosovës, Alternativa Demokratike e Kosovës, Republikanët e Kosovës, Partia e Ballit, Partia Socialdemokrate dhe Balli Kombëtar i Kosovës, të cilëve u janë bashkuar Lista Serbe, komunitetet jo serbe si dhe AKR-ja, rrallëherë i bëjnë 61 numra në Parlamentin e Kosovës.

Sot, krejt këta bashkë i patën vetëm 45 numra. Seanca e Kuvendit vazhdoi pa miratimin e rendit të ditës. Lidhja Demokratike e Kosovës lëshoi seancën me kërkesën që Koalicioni t'i bëjë numrat e nevojshëm për fillimin e saj. Natyrisht, nuk munguan akuzat e hyçmetit në drejtim të LDK-së.

Janë mësuar me parimin e institucionalizimit që e kultivon LDK-ja dhe shpeshherë e kanë keqpërdorur atë. Kësaj pune, siç thotë populli, i ka vdekë nana! Tash, për LDK-në, institucionalizëm do të thotë ndalimi i degradimit të institucioneve sepse kështu nuk mund të vazhdohet tutje. Vetëm zgjedhjet mund t'ia kthejnë legjitimitetin institucioneve të Kosovës.

Pushteti pa numra nuk mbahet!", ka komentuar në Facebook zhvillimet e fundit në Kosovë, deputetja Doruntinë Maloku.



Shqipëria, nevojë jetike për Politikë të Jashtme.


"Zhvillimet e fundit ndërkombetare, platforma e re në politike të jashtme që qartësisht SHBA po ndjek, ndikimi i madh i saj në zhvillimet globale dhe patjetër në Ballkan, dhe lidhja e pazgjidhshme e Shqipërisë dhe faktorit shqiptar në Ballkan me aleatën e madhe strategjike SHBA, imponon reflektim mençuri dhe kreativitet. SHBA aktori më i madh në skenën ndërkombetare po ve theksin në marrëdhëniet bilaterale duke mos përjashtuar por relativizuar ato multilaterale. Eshtë imperative ta kuptojmë kete. Në kushtet tona dhe sidomos gjatë ketyre viteve të fundit, politika e jashtme është identifikuar me procesin e integritimit në BE.

Kulmin e këtij njesimi mbërriti me krijimin e Ministrise se Evropes dhe Puneve të Jashtme, një shkrimje mes Ministrise se Integritimit dhe Ministrise se Puneve të Jashtme.

Që në krye të herës kam qene kunder bashkimit dhe njesimit të dy dikastereve, pasi mendoj se procesi i Integritimit në BE është një prioritet strategjik për shqiptaret por nuk mund të shterojë politikën e jashtme dhe marrëdhëniet me jashtë, qoftë të vendeve në BE qoftë dhe jashtë BE.

Në situatën e re ndërkombetare mendoj se ky gabim mund të shnderrohet në një dem të madh për interesat shqiptare në teresi.

Integritimi në BE duhet të vazhdojë të mbetet një prioritet e për kete detyrimisht kerkon një dikaster të tere ta ndjeke, por vendi ka nevojë dhe për politike të jashtme e për kete vendi ka nevojë për Ministrine të Jashtme si një vektor i pazvendësueshem i realizimit të interesave kombetare dhe marrëdhënies me jashtë të Shqipërisë", ka shkruar në profilin e saj në facebook, politikania Edita Tahiri.



MEDIACitate

Lugina e Preshevës
kërkon ndihmën
e Shqipërisë
dhe Kosovës

Shtypja dhe diskriminimi ndër dekada, i ka lodhur shqiptaret e kësaj treve, të cilët të ruajnë me fanatizëm traditën, zakonet, gjuhën dhe kulturën, por ata nuk janë dorëzuar.

Pavarësisht gjithçkaje vijojnë përpjekjen e përditshme sidomos në aspektin politik për të fituar vendin që i takon brenda shtetit, të cilin ia la për fat të keq si dhurate proceset historike.

Problemi më jetik për ta është mungesa e teksteve shqip në shkolla.

Tirana zyrtare thotë se përkthimi i 35 teksteve shqip për Luginën është në proces duke dhënë lajmin se në fillimin e vitit të ri shkollor ato do të jenë gati për nxënësit shqiptare.

Përfaqësuesit më të lartë politik të Luginës shpresojnë që Prishtina e Tirana të luajnë një rol edhe më të rëndësishëm në të ardhmen sa i takon presionit që duhet bërë tek shteti serb.

Presheva dhe dy komunat e tjera janë zonat më të varfra në gjithë Serbinë.

VizionPlus, 22 korrik/

Austria, shteti më
mikpritës në botë

Austria ka fituar një titull të lakmuar nga të gjithë, duke u cilësuar si vendi më mikpritës në botë. Me peizazhet natyrore, pastërtinë e qyteteve dhe organizimin modern, Austria është përzgjedhur si vendi më mikpritës në botë nga 'World Economic Forum'. Pas saj u rendit Spanja, e ndjekur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në vendin e katërt renditet Portugalia, për shkak të kostove të ulëta për turizmin. Më tej vijon Kroacia, Zvicra dhe Britania e Madhe.

Në vendin e tetë renditet Australia, e ndjekur nga Gjermania dhe Kanadaja.

Në vendin e njëmbëdhjetë gjëjmë Italinë, e pasuar nga Luksemburgu, Islanda, Bullgaria dhe Irlanda, shkruan noa.al.

Ky klasifikim u bë bazuar në 136 shtete nga e gjithë bota, pasi u vlerësuan 14 parametra të ndryshëm, mes tyre bukuria e peizazheve, siguria e të huajve, cilësia e shërbimit dhe tregu i punës.

(ÖRF, 22 korrik)

Ana shqiptare duhet të jetë pro referendumit kategorikisht me kushtëzim që një Ligj kushtetues mbi identitetin shqiptar të jetë pjesë integrale e ndryshimeve kushtetuese përballë dhe si plotësim i brendshëm ndaj ndryshimeve kushtetuese që i rekomandon "Marrëveshja për emrin"

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 22 korrik - Pas pavarësimit të Maqedonisë, në muajt që pasojnë kemi referendumin për ndryshimin e emri të shtetit, si ngjarjen më të rëndësishme politike. Shqiptarët përsëri janë çelësi i suksesit të këtij referendumi dhe përcaktues për ndryshimet kushtetuese që do të pasojnë lidhur me zbatimin e pikave të Marrëveshjes për emrin me Greqinë. Nga ana tjetër Shqipëria dhe Kosova dhe vetë partitë politike shqiptare në Maqedoni, si në të kaluarën edhe tani nuk e kushtëzojnë palën maqedonase për të avancuar statusin juridik dhe politike të shqiptarëve në Maqedoni. Me këtë rast faktori politik shqiptar më shumë preferon që shqiptarët në Maqedoni sërish të mbeten vrojtues kundruall përpjekjeve të maqedonasve për ta zhvilluar betejën e tyre identitare-shtetërore. Shqiptarët mbetëm duke vëzhguar se si kryeministri Zaev (njësoj siç bënte në fillimet e tij Nikolla Gruevski) po premtion reforma në vend, si Maqedonia do të hyj në NATO dhe në BE, ndërkohë që ligji për avancimin e gjuhës shqipe assesi të hyjë në fuqi me arsyetimin se ende nuk janë pjekur të gjitha kushtet që të shpallet në gazetën zyrtare.

Përderisa shqiptarët çdo ditë mbushin arkën e shtetit, përfshi edhe mërgimtarët me remitancat e tyre, buxheti i shtetit, në anën tjetër, lë shumë për të dëshiruar në sensin e kthimit për shumë nevoja që kanë shqiptarët. Një institucion i rëndësishëm shtetëror siç është Enti Shtetëror Statistikor, nga ku jepen të dhëna të sakta për shumë fusha e sektorë, por dhe shumë institucione tjera, përfaqësimi i të punësuarve shqiptare vazhdon të jetë minimal mos dhe zero përqind. Ishte lideri i BDI-së Ali Ahmeti që gjatë fushatës parazgjedhore të zgjedhjeve të vitit 2016 përmendi Entin Shtetëror Statistikor ku shqiptarët duhet të kenë qasje si në udhëheqje, ashtu edhe në të dhënat që jep ky institucion por se deri më tani asgjë pozitive nuk ka në këtë drejtim. Ata që duhet të riaktualizojnë kauzat për avancimin kushtetues të të drejtave të shqiptarëve, aktualisht janë

SHQIPTARËT DHE REFERENDUMI

UNITET VEPRIMI PËR NJË KONSENSUS KOMBËTAR



të përçarë. Kur u prit se Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja BESA e Bilall Kasamit mund të bashkohen në një front opozitar, ata si duket nuk gjeten gjuhë të përbashkët për përfaqësimin në KSHZ, dhe kush duhet të shkojë në takimin e liderëve këto ditë.

PASOJAT E MOSUNITETIT POLITIK TË SHQIPTARËVE

Sipas profesorit të së drejtës kushtetuese Mersim Maksuti partitë tona politike shqiptare pa dallim si ato deri dje dhe aq më shumë këto që i kemi sot, gjatë gjithë historisë së pluralizmit politik në Maqedoni, nuk mund t'i fajësojmë shumë pse nuk arritën të bëjnë më shumë.

"Por, e keqja është se, ato shpeshherë ishin vetërrënuesit dhe bartësit e së keqes si rezultat i mos konsolidimit të tyre në funksion të realizimit të të drejtave të shqiptarëve dhe të mundësive më shumë për ta. Mos homogjenizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni i krijuar në vite por i shprehur si asnjëherë më parë sot, është përgjigja më adekuate në të cilën gjendemi", thotë Mersim Maksuti. Sipas tij partitë tona politike duhet të kenë një shkallë më të lartë të vetëndërgjegjësimit, për ta kuptuar më mirë ndërlikueshmërinë e proceseve politike që ndodhin në Maqedoni.

"Partitë tona duhet të ndër-marrin hapa më racional se si duhet vepruar më tej me të drejtat e shqiptarëve siç janë çështja ende e pazgjidhur e gjuhës shqipe dhe të drejtat tjera që duhet të bëhen pjesë e Kushtetutës së këtij vendi, edhe atë pikërisht tani kur kemi përpara sfidën e referendumit që shpie Maqedoninë para momen-

teve të reja historike të saj. Është një mundësi e mirë për t'u hapë çështja e avancimit më tej të të drejtave të shqiptarëve në Kushtetutë me rastin e ndryshimeve kushtetuese që priten të ndodhin pas mbajtjes me sukses të referendumit", saktëson Maksuti.

A DO TË PRANOJNË SHQIPTARËT TË QUHEN "SEVERNOMAKEDONCI"?

Ndërkaq veprimtari politik Gafurr Adili thotë se partitë shqiptare në Maqedoni e mbështesin që të gjitha referendumin meqë sipas tij janë në hipoteka tek pala maqedonase. "Të gjitha partitë politike si ata që janë në qeverisje (BDI, PDSH dhe Besa e Afrim Gashit), edhe ata që janë në opozitë (ASH dhe Besa e Bilall Kasamit) e mbështesin referendumin që do të mbahet në vjeshtë. Pse? Sepse që të gjitha janë me hipoteka", thotë Gafurr Adili. Ai thekson më tej se shqiptarët tanimë kanë filluar të vetëdijesohen andaj dhe nuk do të mbahet në vjeshtë. Pse? Sepse, shqiptarët, sipas tij, nuk do ta pranojnë që të quhen severnomakedonci.

"Jam shume i bindur se referendumi do t'i thonë PO vetëm militantët e partive politike te "pozitës" dhe të "opozitës", por populli shqiptar që jeton në trojet e veta të Iliridës do t'i thotë JO, dhe pastaj, pas dështimit të referendumit, do të hapet një kapitull i ri, jo vetëm këtu në Iliridë, por edhe në Prishtinë dhe në Tiranë. Pse? Sepse, ashtu nga Tirana do të fillojë skërmoqja e mafies politike e trekëndëshit Tiranë-Shkup-Prishtinë", thotë Gafurr Adili. Ai mendon se pas dështimit të referendu-

mit, FYROM siç e quan Adili Maqedoninë do të jetë e detyruar të konfigurimet si shtet binacional, si Belgjika.

"Dhe, ashtu si në Preambulën e Kushtetutës së Belgjikës e zeza mbi të bardhe shkruan: "Belgjika është shtet i flamanëve dhe valonëve", edhe në Preambulën e Kushtetutës së FYROM-it do të shkruhet: "Republika e Maqedonisë është shtet i maqedonasve dhe shqiptarëve", konsideron Gafurr Adili.

MOBILIZIMI I MASËS JOPARTIAKE

Sipas publicistit Nijazi Muhamedi Referendumi për Marrëveshjen rreth emrit të Maqedonisë përbën një oportunitet (një rrethanë, një kontekst) që ndërgjegjes politike kolektive të shqiptarëve në Maqedoni i bën thirrje imperative për një mobilizim politik të esëlluar, të qartë dhe mbipartak për të evaluar, për ta rivlerësuar vullnetin politik shqiptar në përputhje me aspiratat e tyre për dinjitet të barabarte politiko-shtetëror në Maqedoni, duke iu kundërvënë manipulatorëve të deritashëm, "takbirëve" hutimbjellës që poshtnimit politik të shqiptarëve e shesin si "avancim" dhe "përmbyllje avancimi".

"Fushata për referendumin, pra, për anën kombëtare të shqiptarëve këtu përbën një oportunitet që t'i jepet fund sagës së zhagjitjes së rëndë kolektive afër tri dekadëshe nëpër baticat dhe zbatimat e tranzicionit demokratik të Maqedonisë, e cila, me "Marrëveshjen për emrin", poqe se mbaron pa një shtesë juridiko-kushtetuese për mbrojtjen dhe afirmimin e identitetit shqiptar, një shtesë e cila

duhet të jetë e njëkohshme me ndryshimet kushtetuese që i rekomandon "Marrëveshja", mund t'u japë një fund poshtnues dhe të "mbyllur për gjithmonë të drejtave të tyre legjitime për dinjitet të barabarte politik, social-ekonomik, kulturor dhe gjuhësor në tërësinë politiko-shtetërore të Maqedonisë", thotë Nijazi Muhamedi. Sipas Nijazi Muhamedit "Marrëveshja për emrin" në disa pika të saja, duke dalë si fryt i një hipokrizie konsensuale greko-maqedonase pretendon të imponohet dhe të legjitimohet me do mekanizma që do shërbejnë më tepër si rrënues të identitetit shqiptar në rrafshin e tij historiko-territorial, të historisë dhe të trashëgimisë historike e kulturo-civilizuese të shqiptarëve në dimensionin global të këtij identiteti. "Ato pika shpërfaqin "hipokrizinë" e negociuesve, që duke harruar kontestin mes tyre, kanë ngritur gardhe në lëmë të huaj si "zgjidhje" për kontestin". Mobilizimi i anës kombëtare shqiptare, thotë më tej Nijazi Muhamedi, pra i anës deri tash të heshtur dhe jopartiake, prandaj, duhet të jetë një imperativ demokratik kategorik, një mobilizim që do strukturohej përmes një Këshilli Kombëtar Shqiptar si përfaqësues moral i vullnetit shqiptar në Maqedoni. Kjo duhet të bëhet, vazhdon ai, për arsye se organizimi politik i shqiptarëve pikërisht në këtë kontekst ndodhet në fazën më të rëndë të kolapsit të tij dhe mbijetimin e kërkon në tuxharinë pa turp të vullnetit politik kolektiv për dobi të interesave të tyre turpërisht korruptive dhe nuk i bëhet vonë se votën shqiptare e vë në funksion të projekteve politike që i kundërvihen identitetit shqiptar.

"Së këndejmi, anës kombëtare shqiptare i bie për përgjegjësi historike që fushatën pro referendumit ta marrë në duart e veta për të marrë në mbrojtje legjitime votën shqiptare karshi manipulatorëve që atë votë, atë manifestim të vullnetit shqiptar do pretendojnë ta tjetërsojnë keqazi, si kanë bërë gjer me tani. Ana shqiptare duhet të jetë pro referendumit kategorikisht me kushtëzim që një Ligj kushtetues mbi identitetin shqiptar të jetë pjesë integrale e ndryshimeve kushtetuese përballë dhe si plotësim i brendshëm ndaj ndryshimeve kushtetuese që i rekomandon "Marrëveshja për emrin", thekson Nijazi Muhamedi.

Është thjeshtë kjo kohë dhe përkushtim i Qeverisë për të përmirësuar drejtë për drejt cilësitë e njerëzve për vende të reja të punës për standard më të lartë ekonomik, për ambient më të pastër, për shkolla më cilësore, për shëndetësi më cilësorë më të përafërt me njerëzit ku do që jetojnë

Zëvendës Kryetari i Qeverisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Bujar Osmani sot së bashku me Ministrin e Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Sadulla Duraku të shtunën vizituan Komunën e Dibrës Në Kuadër të vizitës në Komunën e Dibrës, realizuan takim me kryetarin e Komunës së Dibrës Ruzhdi Lata me të cilin diskutuan për projektet të cilat janë realizuar si dhe u këmbëmbendime rreth mundësisë për realizimin e projekteve përmes mjeteve nga IPA-t, thuhet në komunikatën e zyrës së z. Osmani.

“Sot edhe si Zëvendëskryeminstër i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për Çështje Evropiane por edhe si Negociatar Kryesor Politik i Qeverisë me BE, po nis nga Dibra karvanin e Evropianizimit të shtetit dhe të shoqëri-

OSMANI DHE DURAKU PËR VIZITË NË DIBËR



së. Duke pasur parasysh se procesi edhe i bisedimeve por edhe i ati i evropianizimit nuk do të thotë vetëm ligje, masa të cilët jemi mësuar me të cilat jemi mësuar, por do të thotë edhe përmirësim i jetës njerëzore dhe inkuadrimit të komunave në atë mënyrë evropiane të jetës së njerëzve prandaj jemi këtu sot me Ministrin e Ambientit Jetësor dhe me Zëvendësministrat e Shëndetësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të cilët kanë një obligim të veçantë në sektorët të rëndësishme të qyte-

tarëve këtu në Dibër dhe bashkë me Kryetarin e komunës do të dëgjojmë drejtpërdrejtë nga ata për nevojat e tyre për atë se çfarë mund të bëjmë ne si Qeveri për ta, deri ku jemi me projekte të cilët kemi nisur ose planifikojmë ti nisim për Dibrën dhe për qytetarët e Dibrës.

Është thjeshtë kjo kohë dhe përkushtim i Qeverisë për të përmirësuar drejtë për drejt cilësitë e njerëzve për vende të reja të punës për standard më të lartë ekonomik, për ambient më të pastër, për shkolla më cilësore, për

shëndetësi më cilësorë më të përafërt me njerëzit ku do që jetojnë, d.m.th. është kjo një grup operative e Qeverisë e cila do të vizitojë komunat që drejtpërdrejtë ballafaqohet me nevojat e tyre dhe me planet tona për të përmirësuar jetën e njerëzve”, theksoi zëvendëskryeministri Osmani në Dibër.

Përfaqësuesit e Qeverisë së bashku me ata lokale bënë inspektimin e punimeve për realizimin e disa projekteve, thuhet në komunikatën e zyrës së z. Osmani.

“NISMA 68”, AKTIVITETET NË MALËSINË E TETOVËS

PLLAKË PËRKUJTIMORE KUSHTUAR FADIL SULEJMANIT

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 22 korrik-Organizata Joqeveritare “Nisma 68”, ka vazhduar me aktivitetet për shënimin e 550 vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe 50 vjetorit të Demonstratave të Tetovës. Me këtë rast në fshatin Bozovcë, është bërë përmirësimi i pllakës përkujtimore të rektorit të Parë të Universitetit të Tetovës Profesor doktor Fadil Sulejmanit i cili lindi në këtë fshat. Në këtë përmirësim ka marrë pjesë biznesmeni i njohur nga Tetova Lazim Destani. “Propozoj që shkolla e fshatit të mer emrin e Fadil Sulejmanit dhe jo vetëm kaq por edhe Universiteti i Tetovës të mbajë emrin e rektorit të parë dhe themeluesit Fadil Sulejmanit” tha Destani. Ai më tej është shprehur se Fadil Sulejmani, asnjëherë nuk e harroi vendlindjen e tij dhe kontribuoi shumë për arsimimin e banorëve të kësaj ane. Lidhur me jetën dhe veprën e rektorit të parë të Universitetit të Tetovës ka folur profesor doktor Vebi Bexheti.

“Në zemrën e Sharrit sot u kthye buzëqeshja e sharrjanëve, u zhduk zymtësia e banorëve të kësaj ane të lënë në harrësë. Sot



Veshalla e Bozovca ishin bashkë për ta ndarë gëzimin, që moti ishte i panjohur për këta malësorë. Sot Sharri ishte më i buzëqeshur se kurdoherë më parë dhe ashu kryelartë herë e shikonte Tetovën e herë Prizrenin, qytete këto ndër më të vjetrit e kësaj pjese të hapësirës shqiptare që asnjëherë nuk u panë mes veti. Sharri i zavnave të Fishtës së madh, ashtu krenar dhe i pamposhtur, sot e hapi zemrën e madhe për të gjithë. Atje, në vendin e shqiponjave sot u përkujtua historia që na ndante, ajo histori e dhembjes dhe e malësorëve të pëvuajtur që ashtu, si ato të Migjenit, me nga një thes misër në krah kalonin nga Prizreni në Tetovë”, tha profesor Bexheti, duke lexuar më pas edhe biografinë kushtuar rektorit të parë të

UT-së Fadil Sulejmanit.

Pas këtij aktiviteti, më pas në fshatin Veshallë, është vendosur pllaka përkujtimore, simbol i rrugës Historike Tetovë-Prizren me mbishkrimin “Sharri nuk ndan, Sharri Bashkon Dukagjin e Pollog”.

Për simbolikën e kësaj pllake ka folur një organizatorët e aktivitetëve të Nismës 68, Xhemil Daci. “Nisma 68” këtë ditë ia kushtoi 50 vjetorit të ngjarjeve historike të vitit 1968 kur i tërë populli shqiptarë, u çua në demonstrata kundër shtypjes barbare sllave. Shaerjanët dhe veçmas mësuesit e shkollave të katundeve të Sharrit, ishin pjesë vitale e tyre si, Femi Rufati, Abdylselam Selami, Nexhmedin Neziri, Faik Mustafa etj që stoikisht i përballuan

burgosjet, papunësinë dhe dhunën”, tha Xhemil Daci. Në ndërkohë, në fshatin Veshallë krahas shumë veprimtarëve dhe pjesëmarrësve nga Tetova dhe rrethina, pjesëmarrës kanë qenë Mahmut Skenderi nga Veleshta e Strugës që ka përfaqësuar Shoqatën Shqiptaro-Amerikane dhe nga shoqata e të ish burgosurve dhe të përndjekurve politik Shpëtim Pollozhani.

Poashtu, me këtë rast janë ndarë edhe mirënjohje edhe për pjesëmarrësit e demonstratave të 68-ës, dhe për kontribuesit e çështjes kombëtare. Më pas është mbajtur edhe një manifestim kulturor, sportiv nga ana e nxënësve të shkollave fillore të fshatrave të Malësisë së Tetovës. Krahas kësaj, poashtu është mbajtur edhe olimpiada e lojrave të vjetra popullore ku më të suksesshëm në të gjitha disiplinat ishin nxënësit e shkollës fillore të fshatit Veshallë. Aktiviteti kryesor për shënimin e 550 vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe 50 vjetorit të Demonstratave të Tetovës pritet të mbahet më 28 nëntor në Tetovë për çka organizatorët do të japin deataje në të ardhmen.

LETËR E HAPUR E 40 INTELEKTUALËVE NGA EVROPA DHE SHBA-të



Kërkohet zbatimi i marrëveshjes me Greqinë

Në një letër të hapur për publikun, e publikuar nga gazeta britanike “The Guardian”, më shumë se 40 intelektual nga Evropa dhe ShBA-të kërkojnë që marrëveshja historike mes Maqedonisë dhe Greqisë ku zgjidhen dallimet rreth emrit, të zbatohet.

Në letrën e nënshkruar nga profesorë universitar nga Londra, Kalifornia, Bolonja, New Yorku, Varshava, Kembrixhi, anëtarë të Kuvendit Evropian, filozofë nga Strasburgu dhe Parizi e shprehin përkrahjen për marrëveshjen, duke theksuar se ai e respekton dinjitetin dhe të drejtën në vetëvendosje në të dyja vendet dhe e vërteton dëshirën e të dyja vendeve për bashkëjetesë paqësore.

Këta persona, potencojnë se marrëveshja i definon politikat, kufijtë historike dhe kulturore mes Maqedonisë klasike greke dhe -nga tash- Maqedonia Veriore, duke vënë në pah se identiteti maqedonas mund të ndahet mes njerëzve që e pranojnë, me kuptim të ndryshëm. Duke rikujtuar për shqetësimet kryesore, por edhe përfitimet për të dyja palët, në letrën theksohet se kur do të mbarojë, “kjo marrëveshje obligative juridike ndërkombëtare do ta zgjidh çështjen për kontestin politik të identitetit, dhe do të ofrojë model për zgjidhjen e konflikteve tjera disa vjeçare”.

Megjithatë, intelektualët evropian dhe amerikan thonë se në të dyja vendet ka ekstremistë dhe radikalë që janë kundër marrëveshjes. Ata thonë se pasqerisht në Maqedoninë Veriore të ardhshme është e nevojshme që të përmbushen të gjitha obligimet më qëllim që të kalojë referendumi, i planifikuar vještën e këtij viti.

“Në këto momente kritike, kur Evropa ballafaqohet me ekstremizmin e djathtë nacionalist, racizëm dhe revizionistët e rrezikshëm nga Ballkani dhe Evropa, të cilët i ndajnë njerëzit në “tradhtarë” dhe “patriotë”, më e rëndësishme se kurë është që të përkrahen ata që marrin iniciativa për pajtim. Ne e përkrahim këtë fer marrëveshje dhe i bëjmë thirrje të gjitha palave që ta plotësojnë pjesën e tyre të mbetur në marrëveshje”, thuhet në letrën e hapur nga intelektualët e ShBA-ve dhe Evropës.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit të ri për larje parash të gjithë klientët aktual dhe klientët e rinj obligohen të plotësojnë deklaratë me shkrim nëse janë bartës të funksioneve publike apo persona që kanë lidhje familjare me bartësit e funksioneve politike, dhe në bazë të kësaj deklarate bankat do të vendosin se do të vazhdojnë bashkëpunimin me këta persona apo jo

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 22 korrik – Edhe përkundër kërkesës së Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore që të shtyhet zbatimi i ligjit të ri për uljen e pagesave kesh nga 15.000 euro në 2000 euro, sepse ky ligj më tepër prek kompanitë por jo dhe kazinotë apo bastoret të cilët janë rreziku potencial për larje parash, bankat komerciale tani më kanë paralajmëruar klientët e tyre se nga 1 janari i vitit të ardhshëm nuk do të mund të bëjnë pagesa apo të pranojnë para kesh në vlerë më të lartë se 1000 euro kurse nga 1 korriku i vitit 2019 kjo pagesë do të ulet në 500 euro. Nga sektori bankar në Maqedoni shprehen se Ligji për parandalimin e larjeve të parave dhe financimin e terrorizmit është i mirë dhe se do t'ju mundëson bankave të

LIGJI PËR PARANDALIMIN E LARJEVE TË PARAVE

DO TË KONTROLLOHET KESHI I FUNKSIONARËVE PUBLIK



mos keqpërdoren nga qytetarët dhe personat fizik gjatë pagesave të kesh parave përmes bankave sepse pothuajse 70 për qind e sektorit bankar në Maqedoni është në pronësi të grupacioneve bankare me seli në vendet e BE-së.

"Ligji i ri për kufizimin e pagesave kesh përmes bankave në 1000 euro të cilin ne si bankë do ta zbatojmë nga 1 janari i vitit të ardhshëm do të jetë në nivelin e njëjtë apo i harmonizuar me rregullativat evropiane për parandalimin e larjeve të parave apo financimin e terrorizmit. Për klientët tanë kjo do të thotë relacione më të forta dhe ba-

shkëpunim të mirë me bankat me çka bankat do të kenë më shumë informacione gjatë definimit të profilit të tyre të rrezikshëm. Me miratimin e këtij ligji Sparkase Banka ka filluar me edukimin e personelit bankar se si duhet të zbatohet ligji. E gjithë kjo bëhet në kuadër të punës së përditshme të administratorëve të bankës dhe klientëve që në të ardhmen mos të ketë keqkuptime dhe se zbatimi i ligjit të shkon në at mënyrë që të mos prodhon efekte negative mes të punësuarve në bankë dhe klientëve", thotë Gligor Bishev, kryetar i Këshillit udhëheqës i Sparkase banka –

Shkup.

Edhe nga NLB banka – Shkup deklarohet se ligji i ri i cili hyn në fuqi vitin e ardhshëm nuk sjell ndonjë risi dhe nuk do të ndikonte aspak në punën e bankave me klientët sepse parashihen ndryshime që kanë për qëllim të sigurojnë mbrojtje juridike të klientëve nga larja e parave apo financimin e terrorizmit. "Ligji parashihet identifikim të detyrueshëm të personave që janë bartës të funksioneve publike në Maqedoni. Klientët të cilët i takojnë kësaj kategorie duhet patjetër gjatë pagesave kesh të identifikohen dhe të tregojnë se

çfarë funksioni shtetëror ushtrojnë. Këtë e bëjnë përmes plotësimit të një deklarate personale dhe banka në bazë të vlerësimit për rrezikshmërinë, vlerëson se mund apo nuk mundet të kryen transakcione apo të pranon para kesh në vlerë më të lartë se 1000 euro. Më pas banka duhet ta identifikon dhe verifikon pronarin e vërtet të personit juridik-kompanisë si kusht i domosdoshëm që banka të mund të vendos bashkëpunimin afarist me kompaninë që njëherit është praktikë në të gjitha vendet e Evropës.", thonë nga NLB banka nga Shkupi.

Ndryshe nga 1 janari i vitit 2019 hyn në fuqi ligji për parandalimin e larjeve të parave apo financimin të terrorizmit i cili parashihet që pagesa kesh përmes bankave të jetë vetëm 1000 euro ndërsa nga muaji korrik kjo pagesë zvogëlohet në 500 euro. Nga Ministria e Financave thonë ligji në fjalë ka për qëllim të parandalojë ekonominë joformale në Maqedoni sidomos në shënjestër do të jenë bartësit e funksioneve publike të cilët kryejnë apo pranojnë pagesa kesh përmes bankave.

Qytetarët apelojnë se duhet të rritet numri i gjinekologëve si dhe të bëhet shpërndarja përkatëse e rrjetit për të shmangur situata ku ka përqendrim të lartë të gjinekologëve në një zonë, përderisa mungojnë në zonë tjetër, apo më të vogël, si dhe stimulim plotësues i gjinekologëve që dëshirojnë të punojnë në zona vështirë të qasme dhe rurale

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 22 korrik - Sëmundjet malinje të qafës së mitrës janë ndër çrregullimet më të shpeshta të femrat. Në qoftë se bëhen kontrolle parandaluese gjinekologjike të rregullta dhe me kohë, kjo sëmundje mund të zbulohet në fazë të hershme, ku edhe mund të shërohet, thonë mjekët. Gjashtë vite më herët në Republikën e Maqedonisë filloi fushata për ekzaminimin e kancerit në grykën e mitrës, me të cilën parashikohej Testi PAP falas tek gjinekologu amë i përzgjedhur. Kjo fushatë, përveçse

TESTET PARAKANCEROZE

MUNGOJNË MATERIALET NË GJUHËN SHQIPE

kishte për qëllim parandalimin dhe diagnostikimin e her-shëm të sëmundjeve malinje gjinekologjike, ajo njëkohësisht ndikonte ndërgjegjësimin e grave mbi nevojën për përzgjedhje të gjinekologut amë.

Se sa gratë sot shfrytëzojnë shërbime shëndetësore, me vizita për kontroll të rregullt gjinekologjik dhe në testimet PAP, ky numër ka rënë dukshëm, veçmas në pjesët më të thella të vendit. Sidomos kur bëhet fjalë për rastet e evidentuara të lindjes, spontane ose lindjeve të qëllimshme tek vajzat e mitura, si dhe në numrin e rasteve të evidentuara të intervenimeve pas ndërprerjes joprofesionale të shtatzënisë.

Kryetari i shoqatës së mjekëve shqiptar në Maqedoni, dr.Nevzat Elezi, për gazetën KOHA, thotë se gjeneratat e reja për fat të mirë nuk kanë simptome. Të rejtat nuk bëjnë kontroll, pasi që bëhet fjalë për parandalim, dhe shumë pak janë të interesuara për bërjen e këtij testi. Ai thotë se tre vitet e fundit nuk ka fare interesim nga qytetarët dhe kjo si pasojë e mospromovi-



mit të mjekëve amë, ku shteti bente propagandë dikur. Gjithashtu ka mungesë të gjinekologëve amë, por është stërngarkim për ata gjinekologë qofshin ata që kanë ordinancë private ose që bëjnë punën në institucione shëndetësore publike, që janë të marra me koncesion. Popullata sipas tij është e mbuluar deri diku me gjinekolog amë, por ai është i angazhuar, sepse nuk ka kohë të mjaftueshme të merret edhe me prevencion. Dr.Elezi theksin e vë te mungesa e materialeve, gjegjësisht në gjuhën shqipe, si materiali propagandues, por mungojnë edhe aktivitetet nga njerëzit profesionist, veçmas të rinjtë që duhet të bëjnë kontroll. Ai shton se është përgjegjëse Mini-

stria e Shëndetësisë të furnizojë me materiale qytetarët edhe në gjuhën shqipe jo vetëm në gjuhën maqedonase. Dhe, sipas tij, aktivitetet si seminare ose forume duhet të jenë të fokusuar edhe te shoqëria shqiptare, e cila në këtë aspekt është më e tërhequr. Ku gratë të moshës 49-60 vjeçare që duhet t'u shpjegohet rëndësia e kontrollit edhe atë në gjuhën amë. Për pjesën rurale nga Shoqata e Mjekëve shqiptar edhe pse thonë se banorët janë të mbuluar me mjekun amë, aty mungojnë pajisjet dhe materialet udhëzuese. Për gjinekologun koha është e kufizuar për të shpjeguar faktorët e rrezikut, shenjat dhe simptomat e kancerit të mitrës, leksionet e mundshme

parakanceroze, prandaj duhen materiale.

Mjekët thonë se Pap Testi është test i shpejt për të kontrolluar shëndetin e qafës së mitrës. Ky test kryhet për të zbuluar ndryshimet parakanceroze të qafës së mitrës. Testi është pjesë e një ekzaminimi gjinekologjik të rregullt. Qëllimi i këtij procesi është parandalimi i sëmundjes, si dhe reduktimi i vdekjes tek gratë nga kanceri në grykën e mitrës, për të cilën nevojitet inkuadrimi i gjithë gjinekologëve amë në ekzaminimin dhe në detektimin e hershëm të kësaj sëmundjeje, si dhe ndërgjegjësimi i grave mbi rëndësinë e vizitave të rregullta gjinekologjike dhe PAP testeve.

Qytetarët apelojnë se duhet të rritet numri i gjinekologëve si dhe të bëhet shpërndarja përkatëse e rrjetit për të shmangur situata ku ka përqendrim të lartë të gjinekologëve në një zonë, përderisa mungojnë në zonë tjetër, apo më të vogël, si dhe stimulim plotësues i gjinekologëve që dëshirojnë të punojnë në zona vështirë të qasme dhe rurale.

SHËRBIMET ONLINE PËR QYTETARËT

MAQEDONIA E PARAFUNDIT NË RAJON

Qytetarët e Maqedonisë në raport me shtetet e tjera, akoma nuk mund ti shmangin radhët e gjata të pritjes për nxjerrjen e dokumenteve të ndryshme si dhe humbjen e pakuptimtë të kohës për tu pajisur për shembull me certifikata të ndryshme.



Koha Fisnik Pasholli

Shkup, 22 korrik—Maqedonia renditet e parafundit në rajon, lidhur me shërbimet publike të qytetarëve që mund të fitohen në mënyrë online apo elektronike.

Sipas raportit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "E-government Survey" 2018, apo analizës së zgjeruar për qeverisjen elektronike, Maqedonia renditet në vendin e 79-në botë.

Ky vend si shtet na pozicionon në vendin e parafundit në rajon, vetëm para Bosnje e Hercegovinës në vendin e 105-të. Para nesh janë edhe Shqipëria në vendin e 74-ët, Mali në vendin e 58-të, Kroacia në vendin e 55-të, Serbia në vendin e 49-të, Bullgaria në vendin e 47-të

BOTA E ZHVILLUAR VOTON PËRMES INTERNETIT

Cjatë këtyre 15 viteve të kaluara, shumë vende kanë prezantuar një mënyrë të re votimi, atë nëpërmjet internetit. Një mënyrë e tillë votimi përdoret në Britani, Austri, Estoni, Francë, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Australi etj. Në Estoni, qytetarëve u kushton vetëm pak minuta nga koha e tyre e çmuar për të votuar presidentin e tyre nga telefonët celular. Vlerësohet se kjo është një mënyrë mjaft e mirë votimi, për gjithë ata persona

që nuk kanë mundësi të shkojnë në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve. Për nga ana ekonomike, mund të thuhet se me kalimin e kohës kjo mënyrë votimi ul koston e përgjithshme të procesit elektoral. Autoriteteve nuk u duhet të shpenzojnë për ngritjen e qendrave të votimit, stafeve etj. Ndikon gjithashtu në numërimin e shpejtë të votave, e për pasojë edhe në dhënien e rezultatit të procesit elektoral.

dhe Sllovenia në vendin e 37-të.

Me fjalë të tjera, ky raport tregon se qytetarët e Maqedonisë në raport me shtetet e tjera, akoma nuk mund ti shmangin radhët e gjata të pritjes për nxjerrjen e dokumenteve të ndryshme si dhe humbjen e pakuptimtë të kohës

për tu pajisur për shembull me certifikata të ndryshme.

Nga Ministria e Shoqërisë informatike dhe administratës, thonë se nga muaji shtator pritet të fillojë me punë portali kombëtar, përmes së cilit qytetarët do të mund të realizojnë të drejtat e tyre dhe të

fitojnë më shumë shërbime përmes rrugës elektronike. Sipas paralajmërimeve, në të ardhmen do të mund të fitohen online afër 50 shërbime që do të zgjidhen, si më të rëndësishme për qytetarët. Pritet që përmes "sistemit një sportel kombëtar", apo në një vend të fi-

tohen më shumë shërbime të ndryshme nga administrata. Projekti është financuar nga fondet evropiane IPA, ndërsa për të janë angazhuar disa ministri dhe institucione shtetërore. Ato punojnë së bashku për të përcaktuar shërbimet prioritare që do tu ofrohen qytetarëve me qëllim të përzgjedhjes së shërbimeve më të rëndësishme që do të fitojnë qytetarët përmes rrugës elektronike.

Me funksionimin e paralajmëruar të sistemit të ri pritet që qytetarët të mos humbin më kohë duke parashtruar kërkesë me shkrim, dhe duke u kthyer sërish për të fituar vërtetimin e nevojshëm. Njëherazi pritet që të mos ketë nevojë të humbet kohë që kërkues i një shërbimi, të endet nëpër institucionet e tjera që të sigurohen dokumentet e nevojshme shtesë për nxjerrjen e dokumentit të kërkuar. Nga ana tjetër, edhe në institucione për shkak të thjeshtësisë së shërbimeve dhe automatizimit të tyre pritet të lehtësohet edhe ngarkesa e punës për administratën.

Ndryshe, raporti përfshin indeksin, ku analizohen 192 vendet anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në dhjetë vendet e para, të klasifikimit renditen Danimarka, Mbretëria e Bashkuar, Suedia, Finlanda, Franca, Gjermania, Holanda, Zvicra, Estonia dhe Spanja.

KUMANOVA NJË VIT PA APARAT PËR MAMOGRAFI

PACIENTËT DUHET TË SHKOJNË NË SHKUP

Mamografi i vjetër 34 vjet është prishur vitin e kaluar në tetor, dhe pacientët duhet patjetër të vijnë në Shkup ose të paguajnë kontrollim privat.

Koha Aida XHONI

Shkup, 22 korrik - Më shumë se dhjetë muaj nuk punon mamografi në Spitalin e përgjithshëm të Kumanovës. Aparati që është i vjetër 34 vjet, në vitin 1996 ishte sjell si donacion nga sektori për rentgenologji, ndërsa është prishur vitin e kaluar në tetor dhe prej atëherë pacientët të cilat duhet të kontrollohen ose kanë probleme me gjinj të kanë patjetër të kërkojnë



zgjidhje në Shkup ose të paguajnë privatisht. Derisa ka punuar aparati, për shkak se ishte i vjetër, arrinte të kontrollojë nga gjashtë pacientë në ditë.

Ministri i shëndetësisë Venko Filipçe, thotë se është shpallur tender për tre mamograf, të cilët janë paraparë për spitalin e Kuma-

novës, Shtëpinë e shëndetit në Kriva Pallankë dhe ambulancën në Shkup dhe se në tetor do ti marrin.

Spitali i Kumanovës është rajonal dhe mbulon 200 mijë pacientë.


"Pacientët janë shumë të revoltuar sepse ne kishim numër të madh të kontrollimeve tek ne.

Tani pacientët e kanë patjetër të shkojnë në Shkup, në Kratovë punon vetëm ndonjë program skri-ning nëpërmjet Ministrisë së shëndetësisë, në Kumanovë ka mamograf privat ku duhet të paguhet një shumë e madhe parash, por jo të gjithë pacientët kanë mundësi të paguajnë. Shpresojmë se në kohë sa më të shkurtër do të furnizohem me mamograf digjital", thotë doktor Dimitrija Subotiq, nga Sektori për rentgenologji-Kumanovë.

Mjekët thonë se është stresuese për pacientet të cilat janë të operuara nga kanceri në gji dhe që marrin hemoterapi, ndërsa detyrohen të caktojnë termin dhe të presin tju vi radha në Shkup.

Drejtoresha e Spitalit të përgjithshëm të Kumanovës, Dr Snezhana Zaharieva, thotë se mamografi është prishur pasi kishte filluar të rrezatojë pa kontroll, dhe paraqiste rrezik si për pacientët ashtu edhe për të punësuarit.

STATISTIKAT E VITIT 1943



Në Shkup, 77% shqiptarë

Në dokumentin e mëposhtëm, mund të shihen statistikat për Shkupin e vitit 1943. Nga 140 mijë banorë në atë kohë, 108 mijë ishin shqiptarë, pra mbi 77%, ndërsa pjesën tjetër e përbënin bullgarët, turqit, hebrenjtë, romët etj. Ky dokument dëshmon edhe njëherë se Maqedonia ka qenë e populluar me shqiptarë, ndërsa maqedonasit ishin vetëm një pakicë. Mirëpo, me kalimin e kohës, këto shifra kanë ndryshuar dhe tani maqedonasit mbizotërojnë në Maqedoni.

BIZNESMENI MË I PASUR NË SHQIPËRI, PO E BLEN FERRONIKELIN

Në Shqipëri, si edhe në gjithë rajonin, lidhjet e biznesit me politikën janë shumë evidente. Kjo ndodhë edhe në Kosovë, dhe blerja e Feronikelit, tregon se politika dhe biznesi, në shumicën e rasteve edhe me veprime korruptive, janë shumë më bashkëpunues për biznese personale, dhe fare pak për lidhje zyrtare konkrete ekonomike në mes të shteteve.

Biznesmeni më i famshëm dhe më i pasur i Shqipërisë, Saimir Mane, po shtrihet me biznese edhe në Kosovë. Siç merr vesh Metro, kompania e Manes që quhet 'Balfin Group' është në negociatë për të blerë Ferronikelin. Mane po e blen Ferronikelin nga kompania greke 'Cunico Resources', e cila ka më së shumti aksione në këtë kompani. Për këta të fundit u raportua se kanë probleme të mëdha financiare, madje edhe çuan në falimentim një kompani në Maqedoni.



Sidoqoftë, Ferronikeli ishte në një gjendje mjaft të vështirë financiare e cila nuk arriti të zgjidhet për vite të tëra.

Ndryshe, Samir Mane është sipërmarrësi më i pasur shqiptar. 51 vjeçari është miliarderi i parë Shqiptar. Ai është president dhe pronar i grupit BALFIN, i cili është grupi më i madh i investimeve private në Shqipëri dhe në Evropën Juglindore.

Kjo e bën Manen jo vetëm një nga biznesmenët më me ndikim në Ballkanin Perëndimor, por një histori suksesi për Shqipërinë. Balfin Group ka krijuar një reputacion të tij si Grupi më aktiv dhe inovator falë ideve të suksesshme të investimeve, të cilat kanë transformuar dhe revolucionari-

zuar jo vetëm tregun por edhe sjelljen e konsumatorëve. Sot, me zyrat qendrore në Tiranë, Grupi Balfin është prezent me aktivitetin e tij përtej kufijve të Shqipërisë, në Austri, Maqedoni, Mali i Zi, Dubai, Kosovë, Greqi, Itali, Hong-Kong dhe Amerikë.

Gazeta Metro ka provuar të kontaktojë me përfaqësuesit e Feronikelit, për të marrë informacione zyrtare për këtë, por ata nuk kanë kthyer përgjigje.

Kompania e Manes, e cila ka blerë Feronikelin, aktivitet me biznesin e xehes, ushtron edhe në Shqipëri, më saktësisht në minierën e Bulqizës, ku pushtetin lokal e ka LSI e cila udhëhiqet nga bashkëshortja e presidentit Ilir Meta.

Në mediat në Shqipëri, Meta

akuzohet se përmes lidhjeve të tij me kompaninë e Manes po e eksploaton pasurinë e zonës për të mbushur xhepat, ndërsa banorët nuk gëzojnë asnjë benifit, nga kromi i Bulqizës, që dikur ishte gjenerator i ekonomisë shqiptare.

Kompania greke që i ka shitur Feronikelin kompanisë shqiptare, ishte raportuar se kishte probleme financiare, madje e kishin çuar në falimentim një kompani në Maqedoni.

Sidoqoftë, Ferronikeli ishte në një gjendje mjaft të vështirë financiare e cila nuk arriti të zgjidhet për vite të tëra.

Në Shqipëri, si edhe në gjithë rajonin, lidhjet e biznesit me politikën janë shumë evidente. Kjo ndodhë edhe në Kosovë, dhe blerja e Feronikelit, tregon se politika dhe biznesi, në shumicën e rasteve edhe me veprime korruptive, janë shumë më bashkëpunues për biznese personale, dhe fare pak për lidhje zyrtare konkrete ekonomike në mes të shteteve.

Për vite të tëra, politika pengon bizneset e njërit vend dhe anasjelltas për të shtrirë veprimtarinë në shtetin përkatës, dhe krejt këtë duke vënë barriera për të mbrojtur bizneset personale dhe të klientelës së tyre.

Rreth një miliard euro nga diaspora hyjnë në Maqedoni

Maqedonia si shtet ka traditë të gjatë të shpërnguljes së popullsisë në vendet e ndryshme të botës, ku njerëzit migrojnë për arsye të ndryshme, por më së shumti për shkaqe ekonomike. Në shumë vende të botës jetojnë njerëz me origjinë nga Republika e Maqedonisë, të cilët lidhjet e tyre familjare, tradicionale dhe kulturore i mbajnë me vendin e tyre të origjinës. Edmond Ademi është ministër pa resor në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë përgjegjës për diasporën. Në një bisedë me Anadolu Agency (AA), ai foli për rëndësinë e diasporës, nevojat dhe problemet e tyre, por edhe për aktivitetet që ai si ministër dhe qeveria i zbatojnë për lidhjen e diasporës me vendin, jo vetëm në aspektin kulturor, por edhe në atë ekonomik. Siç theksoi ministri Ademi, nuk ka të dhëna konkrete statistikore se sa të shpërngulur nga Maqedonia gjenden në vende të caktuara, ka informacione të ndryshme, por, siç thotë ai, diaspora e Maqedonisë kryesisht jeton në disa vende evropiane, duke përfshirë Gjermaninë, Zvicrën, Italinë, Austrinë dhe Suedinë, ndërsa në vendet e tjera evropiane gjendet në numër më të vogël, kurse në kontinente të tjera, në Kanada, SHBA dhe Australi gjithashtu jeton numër i madh i personave me origjinë nga Maqedonia.



Një e treta e qytetarëve të Maqedonisë nuk mund të shkojnë në pushim

Maqedonia gjendet në fund të listës së shteteve ku qytetarët nuk mund t'ia mundësojnë vetes një javë pushim. Këtë e tregoi studimi i "Eurostat". Më shumë se një e treta e qytetarëve të Maqedonisë apo 65.3% nuk mund t'ia mundësojnë vetes një pushim. E njëjtë është gjendja në Serbi me 62.8%. Sipas studimit, një e treta e popullatës në BE apo 32.9% nuk mund t'ia mundësojnë vetes një pushim vjetor. Gjendje më të mirë e ka Norvegjia, ku vetëm 1% e qytetarëve nuk mund t'ia mundësojnë vetes pushim javor. Pas Norvegjisë gjendet Suedia me 8.2%, e më pastaj Zvicra me 8.9% në vitin 2016. Nga anëtarët e BE-së, gjendjen më të keqe e ka Rumania, ku dy e treta e popullatës nuk mund të mundësojë pushim vjetor, kurse pas Rumanisë vjen Kroacia me 61.2A%. Në Turqi është 71.5% (sipas të dhënave të vitit 2015) që qytetarët nuk kanë para për pushim vjetor.

Kupa e Botës, turistët shpenzuan 1.5 miliardë dollarë në Rusi

Të huajt kanë shpenzuar rreth 1.5 miliardë dollarë në Rusi gjatë Kampionatit Botëror 2018, thotë një hulumtim i bërë nga Sberbank, transmeton Anadolu Agency (AA).

Hulumtimi vuri në dukje se të huajt që kanë vitizuar Rusinë gjatë Botërorit kanë shpenzuar rreth 1.5 miliardë dollarë në këtë vend.

Ndërkohë në Kampionatin e



Konfederatave të luajtur në vitin 2017 të huajt kishin shpenzuar 700 milionë dollarë. Në hulumtim nuk marrin

pjesë biletat dhe shpenzimet në hotelet që kanë qëndruar në periudhën në fjalë. Numri i turistëve të huaj në qytetet ku janë luajtur ndeshjet e Botërorit 2018 Moskë, St. Petersburg, Soçi, Yekaterinburg, Saransk, Rostov, Kazan, Kaliningrad, Samara, Volgograd dhe Nizhni Novgorod ka shënuar rritje prej 15 për qind, ndërsa i atyre vendas 20 deri në 25 për qind

Qëndrim i përbashkët ndaj masave mbrojtëse të Kosovës

Ministrat e tregtisë, bujqësisë e ekonomisë nga katër shtete të Ballkanit, do të kenë mbledhje të mërkurën në Beograd, ku do të shqyrtohet gjendja e sapokrijuar, pasi që Kosova vendosi masa mbrojtëse për eksport për disa lloje të pemëve, perimeve dhe drithërave.



Nikoqiri i takimit do të jetë ministri serb, Rasim Ljajiç, njoftoi Tanjug. Në takimin do të marrin pjesë ministri i

Bujqësisë i Maqedonisë, Lupço Nikollovski, ministrja malazeze e Ekonomisë, Dragica Sekuliq dhe ministri i

Tregtisë dhe Marrëdhënieve Ekonomike i BeH-së, Mirko Sharoviç.

Pritet qëndrim i përbashkët për vendimin e ri të Kosovës, e cila para dy ditëve filloi të zbatojë doganë mbrojtëse prej 30 për qind të importit të disa llojeve të pemëve, perimeve dhe drithërave.

Ljajiç dje tha se do të kërkojë mbledhje urgjente me ministrat resorë të BeH-së dhe të Maqedonisë, si dhe seancë urgjente të CEFTA-s me rastin e vendimit të Prishtinës zyrtare.



KOMUNA E KARPOSHIT

Në bazë të nenit 2 paragrafi 1 pika 4 alineja 2, nenit 4, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 46, 47, 48 dhe nenit 49 të Ligjit për shfrytëzim dhe posedim me mjetet në pronësi të shtetit dhe me mjetet në pronësi të komunave ("Vendimi për shitje të mjeteve të tundshme – automjeteve në pronësi të Komunës së Karposhit përmes ankandit publik elektronik nr. 09-930/7,9,10 të datës 07.02.2018 të sjellë nga Këshilli i Komunës së Karposhit ("Fleta zyrtare e Komunës së Karposhit nr. 2/2018) Raportit për vlerësim të realizuar për përcaktim të vlerës së tregut të mjeteve transportuese nr. 25-5628/3 të datës 16.07.2018 të përpiluar nga "AM CERT SHPKNJ" Shkup, Komisioni për mjete të patundshme dhe të tundshme pronësi e Komunës së Karposhit publikon:

SHPALLJE nr. 1/2018

Për shitje të mjeteve të tundshme – automjeteve përmes ankandit publik elektronik (Shpallja e parë)

1. LËNDË E SHITJES PËRMES ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lëndë e kësaj shpallje përmes ankandit publik elektronik bëhet shitja e mjeteve të tundshme – automjeteve në pronësi të Komunës së Karposhit, të cilat shiten në pajtim me Vendimin për shitje të mjeteve të tundshme – automjeteve në pronësi të Komunës së Karposhit përmes ankandit publik elektronik nr. 09-930/7,9,10 të datës 07.02.2018 të sjellë nga Këshilli i Komunës së Karposhit ("Fleta zyrtare e Komunës së Karposhit" nr. 2/2018).

2. TË DHËNAT PËR AUTOMJETET TË CILAT JANË LËNDË E SHITJES, ÇMIMI FILLESTAR I AUTOMJETIT, GARANCIA BANKARE, HAPI MINIMAL, KOHA PËR FILLIMIN E ANKANDIT PUBLIK

Të dhënat për automjetin	Çmimi i vlerësuar fillestar	Garancia bankare	Hapi minimal	Ora / fillimi
1. Marka e automjetit AUDI Q7 - Tabelat e regjistrimit: SK 922 VN; - Regjistrimi i parë: 16.11.2011; - Viti i prodhimit: 2011; - Lloji i makinës: M1-UDHËTIMI; - Marka dhe lloji: AUDI Q7; - Numri i shasisë: WAUZZZ4L5CD009163; - Lloji dhe numri i motorit: CRC 016168; - Numri i ulëseve: 5 - Fuqia dhe kapaciteti i punës së motorit: 180KW/1967 cm3; - Ngjyra: MET.HIRI I ERRËT /7H.	1.437.221,00 denarë	28.744,42 denarë	Pa kufizime	Ora 10:00
2. Marka e automjetit FORD FIESTA - Tabelat e regjistrimit: SK-265-KL; - Regjistrimi i parë: 19.04.2001; - Viti i prodhimit: 2001; - Lloji i makinës: M1- UDHËTIMI; - Marka dhe lloji: FORD FIESTA BUD ; - Numri i shasisë: WF0AXXGAJA1J09266; - Lloji dhe numri i motorit: 1J09256 1J09256; - Numri i ulëseve: 5; - Fuqia dhe kapaciteti i punës së motorit: 44KW/1299cm3; - Ngjyra: KUQE / 75	18.893,00 denarë	377,86 denarë	Pa kufizime	Ora 10:30
3. Marka e automjetit ZASTAVA YUGO 45 - Tabelat e regjistrimit: SK-036-LV; - Regjistrimi i parë: 05.09.2002; - Viti i prodhimit: 2002; - Lloji i makinës: M1- UDHËTIMI; - Marka dhe lloji: ZASTAVA YUGO 45 ; - Numri i shasisë: VX1145A0001074309; - Lloji dhe numri i motorit: 11MA064 1570987; - Numri i ulëseve: 5; - Fuqia dhe kapaciteti i punës së motorit: 45KW/1116cm3; - Ngjyra: KUQE / 75	14.465,00 denarë	289,03 denarë	Pa kufizime	Ora 11:00

Çmimi fillestar i mjetit të tundshëm është shumë e vlerësuar i së njëjtë të theksuar në shfaqjen tabelore për secilin automjet.

Çmimi për shitje të mjeteve të tundshme është përcaktuar në pajtim Raportit për vlerësimin e realizuar për përcaktim të vlerës së tregut të mjeteve transportuese nr. nr. 25-5628/3 të datës 16.07.2018 të përpiluar nga "AM CERT SHPKNJ" Shkup

3. DATA E MBAJTJES SË ANKANDIT PUBLIK

Ankandi publik elektronik do të mbahet më datë 15.08.2018 (e mërkurë) me fillim në ora 10:00.

Ankandi publik elektronik do të mbahet në internet faqen në vijim www.e-stvari.mk.

4. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kanë të gjitha palët e interesuara të vendit dhe të huaj fizike dhe juridike që mund të kenë të drejtën e pronësisë së mjeteve të tundshme në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin dhe të cilët përbushin kushtet e dhëna në shpallje.

Subjektet e interesuara mund të marrin pjesë për një ose më shumë automjete me parashtrimin e Fletëparaqitjes për pjesëmarrje veç e veç për secilin automjet.

Kontroll të mjeteve të tundshme – automjeteve të cilat janë lëndë e ankandit publik elektronik palët e interesuara mund të bëjnë çdo ditë pune në afatin e caktuar në pikën 6 të shpalljes, në periudhën prej ora 09.00 deri në ora 13.00, personi për kontakt Aleksandar Simonovski 070/331-034

5. KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike në mënyrë elektronike parashtrorj Fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik, që duhet të përmbajë të gjitha të dhënat dhe dëshmitë të përcaktuara në shpallje. (Që të mund të parashtrorj fletëparaqitje për pjesëmarrje së bashku me dëshmitë e caktuara në shpallje secili subjekt fizik dhe juridik duhet paraprakisht të regjistrohet në faqen www.e-stvari.mk). Nëse ofertuesi vetëm se ka marrë pjesë në procedurat nga shpalljet e mëhershme dhe në ankandet e realizuara elektronike të realizuara përmes këtij sistemi për atë ende vlejnjë emri i përdoruesit dhe shifra që i janë dhënë atij më herët – nga pjesëmarrje në procedurë të cilën e ka realizuar cilado komunë).

Dëshmitë të cilat duhet të parashtrorhen së bashku me fletëparaqitjen për ankand publik elektronik, personi i regjistruar obligohet të bashkëngjisë në sistem në formë të kopjes së skanuar të origjinalit në format PDF, dhe atë:

1. Deklaratë për praninë të kushteve që janë dhënë në Shpallje;

2. Garanci bankare për seriozitet të ofertës në shumë prej 2 % të shumës së vlerësuar të mjetit të tundshëm, për pjesëmarrje në ankandin publik. Krahas formës elektronike, garancia bankare për seriozitet të ofertës duhet të që përmes formës me shkrim (në origjinal) të parashtrorhet në adresën – Komuna e Karposhit rr. "Radika" nr. 9 ose në Barakën 2 në Arkivin e Komunës së Karposhit deri në ora 15.30 për Komisionin për mjete të patundshme dhe të tundshme pronë e Komunës së Karposhit. Mos dorëzimi i garancisë bankare në formë me shkrim deri te komisioni e bënë fletëparaqitjen të papranueshme dhe e njëjta do të refuzohet.

3. Dëshmi për identitet për subjektet juridike;

- gjendja aktuale nga Regjistri qendror i RM – jo më e vjetër se gjashtë muaj (për subjektet juridike të vendit);

- certifikatë regjistrimi nga regjistri përkatës në shtetit prej nga vjen (për subjektet juridike të huaja);

4. Dëshmi për identitet të subjekteve fizike;

- kopje të letërnjoftimit ose dokumentit të udhëtimit;

5. E-mail adresë të parashtruesit të fletëparaqitjes, përmes së cilës bëhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, gjegjësisht do t'i dërgohen emri përdorues dhe shifra për qasje në faqen www.e-stvari.mk në të cilën do të realizohet ankandi publik elektronik.

Komisioni pas pranimit të fletëparaqitjeve përcakton nëse janë parashtruar në afatin e caktuar dhe nëse janë të kompletuara në pajtim me kushtet në shpallje pas çka informon parashtruesit e fletëparaqitjeve përmes formës elektronike.

6. AFATI PËR PARASHTRIMIN E FLETËPARAQITJEVE

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në ankandin publik është 18 (tetëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes, deri më 09.08.2018 (e enjte).

7. GARANCIA BANKARE

Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditë nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa garancia bankare ofertuesit më të volitshëm i kthehet në afat prej 15 ditëve nga dita e pagesës së shumës së përgjithshme të arritur në ankandin publik.

Garancia bankare duhet të jepet në valutë të Maqedonisë, nga banka e cila punon dhe bën aktivitetet bankare në Republikën e Maqedonisë, ndërsa kohëzgjatja e garancisë bankare duhet të jetë në afat deri më 09.09.2018.

8. PROCEDURA

Ankandi publik fillon me publikimin e çmimit të përgjithshëm fillestar të automjetit dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve.

Ankandi publik do të mbahet edhe në qoftë se Shpalljes i janë përgjigjur vetëm një pjesëmarrës i cili përbushë kushtet e dhëna në Shpallje dhe ofron çmimin fillestar.

Në pesë minutat e para pjesëmarrësit mund ta pranojnë gjegjësisht të rrisin çmimin e automjetit. Ankandi publik do të konsiderohet si i përfunduar në momentin e kalimit të kohës së caktuar në shpallje, gjatë së cilës nëse në kalimin e dy minutave të fundit të kohës së caktuar për kohëzgjatje të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve jepet ofertë, afati përfundimtar për përfundim të ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta ndërsa do të përfundojë kur për periudhën prej dy minutave të ardhshme nuk jepet ofertë e re. Ankandi publik vazhdon pa kufi, derisa në intervalin kohor prej dy minutave ka ofertë të re.

Nëse në pesë minutat e para pjesëmarrësit nuk është dhënë ofertë më e lartë nga pjesëmarrësi në ankandin publik, vlera e mjetit të tundshëm ulet për 2% nga shuma e vlerësuar pas çka pjesëmarrësit në ankandin publik serish kanë mundësi të pranojnë gjegjësisht të rrisin çmimin e automjetit pa mundësinë që pastaj të kufizohet hapi minimal i rritjes. Nëse në kalimin e dy minutave të fundit nga pesë minutat e dyta të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve pranohet oferta, gjegjësisht është dhënë ofertë më e lartë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhën prej dy minutave të ardhshme nuk është dhënë ofertë e re. Nëse në kohëzgjatje prej 5 minutave sërish nuk ka ofertë, vlera e mjetit të tundshëm sërish ulet për 2% nga shuma e vlerësuar paraprake.

Për ofertues më të volitshëm konsiderohet pjesëmarrësi në ankandin publik i cili ka ofruar çmimin e fundit që paraqet çmimin më të lartë për shitje të mjeteve të tundshme.

Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përpilon procesverbal për ankandin e realizuar publik i cili dorëzohet tek të gjithë pjesëmarrësit në ankandin publik.

Pjesëmarrësit kanë të drejtë për Apel vetëm në lidhje me procedurën për ankandin publik, në afat prej tri ditëve nga mbajtja e ankandit publik deri te Komisioni që vendosë në lidhje me apelin në afat prej 5 ditëve nga pranimi i apelit.

Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje obligohet që të paguajë mjetet në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar për automjetin në llogarinë e Komunës së Karposhit, ndërsa nëse nuk i paguan brenda këtij afati, nuk do të lidhet marrëveshje, garancia bankare do të aktivizohet, ndërsa ofertuesi në afat prej një viti nuk do të mund të marrë pjesë në secilin ankand të ardhshëm publik për mjetet e tundshme në fjalë.

Me ofertuesin më të volitshëm, në afat prej 15 ditëve të punës pas pagesës së realizuar të çmimit të automjeteve, lidhet Marrëveshje për shitje të mjeteve të tundshme. Marrëveshjen në afat prej 30 ditëve blerësi e parashtron në noter për vërtetimin e të njëjtë. Obligimi për shpenzimet për vërtetim të Marrëveshjes bie mbi barrë të blerësit.

Kjo shpallje do të publikohet në ueb faqen e Komunës së Karposhit.

Komisioni për mjetet e patundshme dhe të tundshme në pronësi të Komunës së Karposhit

ARKEOLOGË ZBULOJNË NË SHKODËR, QYTETIN DYMIJËVJEÇAR BASANIA

Nga gurët dolën më shumë informacione në lidhje me qytetin. Muret e gjera prej guri rrethojnë një zonë prej 200 000 metrash katrorë, që do të thotë se Basania ishte tre herë më e gjerë se Shkodra antike, që ishte 70 000 metra katrorë.



Ndonjëherë, gurët janë më shumë se sa thjesht copëza të shkërmoqura toke. Ndonjëherë ata japin detaje mbi të kaluarën apo të ardhmen e planetit tonë.

"Arkeologët e antikitetit të Qendrës së Kërkimit për Europën Juglindore në Universitetin e Varshavës, zbuluan se gurët në Shkodër ishin rrënojat e qytetit 2 000-vjeçar të Basanias", shkruan Christina Ayele Djossa në blogun "Atlas Obscura" që i dedikohet zbulimeve nëpër botë.

Në atë kohë, Bassania ishte një fortesë ushtarake dhe ekonomike,

pjesë e mbretërisë së Ilirisë, që ka ekzistuar nga viti 400 deri në 100 para Krishtit, shkruan ATSH.

Qyteti antik ka në përbërje shumë banesa dhe fortesa, një prej të cilave arkeologët arritën të zbulojnë.

Ajo që ata gjetën ishin gurë antikë të një fotese të ruajtur nga kulla të mëdha dhe mure prej guri dhe dyer të gjera afërsisht tre metra. Këto ndërtesa mbrojtëse, si-

pas profesorit Piotr Dyczek të Universitetit të Varshavës, i përkasin arkitekturës helenistike.

Ekipi konfirmoi epokën e rënojavë duke analizuar monedhat e gjetura aty rrotull dhe fragmente të enëve të qeramikës, që i përkasin epokës së mbretërisë Ilire.

Por, nga gurët dolën më shumë informacione në lidhje me qytetin. Muret e gjera prej guri rrethojnë një zonë prej 200 000

metrash katrorë, që do të thotë se Basania ishte tre herë më e gjerë se Shkodra antike, që ishte 70 000 metra katrorë.

Por, ky qytet dhe mbretëria Ilire, u pushtuan nga romakët në fillim të shekullit të parë. Kjo është edhe arsyeja përse arkeologëve iu deshë kaq shumë për të gjetur Basanian.

"Arsyeja mund të jetë se qyteti pushoi së ekzistuari për një kohë aq të gjatë sa që emri i tij u harrua", shkruan Dyczek.

"Arkeologët polakë dhe shqiptarë spekuluan gjithashtu se edhe infrastruktura gjeologjike e vendndodhjes ka lidhje me këtë harresë. Rrënojat janë gjetur në një kodër, që nga banorët e zonës quhet buzët e nepërkës, në fshatin Bushat, pak kilometra larg Shkodrës", thotë Dyczek.

Pas shumë vitesh erozion, gurët e mbetur dukeshin si pjesë e gurëve që përbëjnë kodrën. Kështu për një kalimtar, mund të dukej si një grumbull me gurë, jo një strukturë e përbërë nga njerëzit.

Tani që qyteti i zbuluar është i dukshëm, do të jetë e mundur që këto rrënojat të vizitohen.



Flaka Goranci, një Carmen shqiptare në Opera Viva, në Zvicër

Ndërsa Kosova po përjetonte ditët e saj më të vështira, pothuajse dy dekada më parë, Flaka Goranci, asokohe një pianiste dhe këngëtare e vogël me shumë dëshira për të ardhmen përpigje të besonte se ajo luftë nuk do të shënonte fundin. "Ndoshta kisha dëgjuar shumë përralla", shprehet Flaka. Në fakt, tek e shikon sot të interpretojë me Orkestrën simfonike të Hamburgut, me të cilën bashkëpunojnë emrat më në zë të skenës operistike dhe asaj klasike në botë, të vjen të mendosh se edhe historia e saj është e tillë. Sot e ftojnë të interpretojë në skenat botërore rolet kryesorë për një mezzosopranoje si Carmen, apo Charlotte nga opera "Werther", e megjithatë Goranci thekson se në këtë profesion nuk është e rëndësishme të të ftojë një herë, por të të riftojë. Dhe në fakt magjia e këngëtares lirike ka bërë që të rikërkohet për të performuar edhe në dy koncerte të tjera në Hamburg po me të njëjtën orkestrë. Flaka ka bërë të mundur që ne të kemi tanimë një Carmen shqiptare për të cilën flasin dhe mediet e huaja. Në 27 korrik këtë rol do ta interpretojë në një nga skenat më prestigjioze si "Opera Viva" në Zvicër dhe është duke bashkëpunuar me një nga regjisorët më të mirë të skenës gjermano-folëse, Andrea Zogg. Të interpretosh solot dhe duetet në dy role të mrekullueshme, siç janë Carmen nga opera me të njëjtën emër dhe Charlotte, nga opera "Werther", me orkestrën simfonike të Hamburgut ka qenë një ndër eksperiencat më të bukura për mua. Kjo është një orkestrë që luan me emrat më në zë të skenës operistike dhe asaj klasike në botë. Përpos që ishte një ftesë e bukur, kënaqësia pastaj që të jep përcjellja e një orkestre të tillë është thjeshtë e mrekullueshme. Aty ndien përparësinë që të jep një orkestrë profesioniste e një niveli të tillë. Jam shumë e lumtur që do të kthehem përsëri në vitin 2019 me të njëjtën orkestrë për të realizuar edhe dy koncerte të tjera në Hamburg", shprehet në një intervistë për gazetën Shekulli mezzosopranoja Flaka Goranci.

FESTIVALI PRIFEST 2018

"NJË TREGIM PRISHTINE" — FILM ME TEMË PREKËSE NGA REALITETI KOSOVAR

Një temë, fatkeqësisht aktuale në Kosovë, është ajo e nevojës për trajtim shëndetësor të fëmijëve jashtë vendit. "Një tregim Prishtine" rrëfen për jetën e një çifti të ri dhe ndryshimet që pësojnë pas diagnostikimit të vajzës së tyre me leukemi. Ky film është bërë me regji të Burbuqe Berishës. Skenarin e ka punuar Getoarë Mulliqi Bojaj



Në kuadër të festivalit PRIFEST 2018, në filmat e Ballkanit, të premtën në mbremje u dha premiera e filmit "Një tregim Prishtine", me regjisore Burbuqe Berisha, skenari nga Getoarë Mulliqi Bojaj, producent Agron Vula.

Ndërsa në kastën e aktorëve janë aktorët Teuta Krasniqi, Donat Qosja, Luran Ahmeti, Artiola Hamdijaj e të tjerë.

Filmi ka për tematikë një dramë familjare, 3 antarëshe, sfidat e së cilës fillojnë pas diagnostifikimit të vajzës me kancer. Ekipi realizues i filmit treguan se si erdh inspirimi për këtë film dhe ndanë përshtypjet e tyre pas premierës.

Regjisoria Burbuqe Berisha tha se idea ka ardhur nga kohët sa ishte duke punuar në Teatrin Kombëtar, ku rrugës ishte ballafaquar me kërkesa për ndihmë për fëmijët e sëmurë.

"Takimi i pare ka qenë me Getën dhe Teutën edhe i kam thënë se kjo është idea, ndërsa Getës i kam thënë se këto janë konturat se çka po du me ba. Edhe e kam pa se krejt njerëzit që i kam thirrë në takimin e parë e

kanë përqafuar idenë. Ky po mendoj se ka qenë filmi me buxhetin më të ulët që e ka pasur ndonjëherë qendra kinomategrafike e Kosovës", tha regjisoria Berisha.

Skenaristja Getoarë Mulliqi Bojaj tha se skenarë të tilla shkruhen siç u shpreh ajo, me një frymë, por që tërë kohën është konsultuar me regjisoren Berisha.

"Me skenar jemi marrë intensivisht deri në nëntor të vitit 2016. Kështu që është një periudhë prej gati 3 vitesh", tha ajo.

E producenti Agron Vula u shpreh i bindun se ky është filmi i parë i realizuar i tëri në Kosovë.

"Le të shënohet në historinë e filmiologjisë se ky është filmi i parë që është realizuar qind për qind në Kosovë, krejt artistët janë shqiptarë dhe prej fremit të parë deri te i fundit krejt autorët që kanë punu janë prej Kosovës", tha ai.

Aktorët kryesor Teuta Krasniqi dhe Donat Qosja u shprehën shumë të kënaqur që ishin

pjesë e këtij filmi, dhe thane se ky film i ka përmbyshur shumë shpirtërisht.

Duke treguar rreth audicioneve për fëmijë dhe mënyrës se si ishin përzgjedhur ata, regjisoria krejt në fund tregoi se komunikimi është ai që e bën një punë të mirë, dhe se pikërisht komunikimi ishte ai që e shtyri ta zgjedh vajzën Artiola Hamdiu për personazh kryesor.

Çfarë nuk shkon me tolerancën fetare?

Nga

Simon RABINOVITCH



Qëllimi i tolerancës fetare, ka qenë gjithmonë dhe mbetet, ruajtja e fuqisë dhe pastërtisë së fesë dominante në një shtet të caktuar. Shumica e feve mbizotëruese në shumicën e shteteve, deklarohen sot tolerante, por gjithashtu duket se ndihen veçanërisht të kërcënuara. Lëvizjet nacionaliste fetare në Shtetet e Bashkuara, Europë, Indi, Turqi dhe Izraeli, duan të forcojnë marrëdhëniet midis identitetit shtetëror dhe fesë dominante. Në secilin rast, zgjedhjet demokratike kanë forcuar rëndësinë e fesë së shumicës në kuptimin e shtetit dhe kombit, duke rritur fuqinë e asaj feje.

Ne mund të shohim një shovinizëm në rritje, në përzjerjen e katolicizmit dhe politikës në Europën Lindore, që i portretizon si armiq liberalët dhe komunistët. Edhe pse nacionalizmi fetar po fiton forcë, pretendimet për përkatësi në "Perëndim", shtrihen pjesërisht tek një përdorim politik i tolerancës fetare. Toleranca ka qenë historikisht një kornizë për njerëzit, që janë thellësisht të ndryshëm nga njëri-tjetri, për të jetuar në paqe së bashku. Çka është pikërisht arsyeja, pse është koha që toleranca të pushojë njëherë e mirë, së qeni një model për marrëdhëniet midis grupeve.

Skepticizmi mbi tolerancën ka një histori të gjatë, që nga shkrimtari gjerman Johan Volfang Gëte, i cili tha se "të tolerosh, do të thotë të fyesh". Ajo u përball me një kritikë të qëndrueshme pas Luftës së Dytë Botërore, nga filozofë dhe teoricienë politikë si Karl Popper, Herbert Markyze dhe shumë të tjerë, që e panë tolerancën liberale si fajtorë për miratimin pasiv të rritjes së fashizmit në gjysmën e parë të shekullit XX-të. Aty ku Popper pa një shoqëri liberale, që kërkonte shtypjen e disa pikëpamjeve jo tolerante për vetë-ruajtje, Markyze e pa tolerancën e liberalizmit ndaj pa-

drejtësisë, si vetë problemin. Pas Markyze, në vitet 1960, e Majta e Reshtroi pyetjen nëse ideja e tolerancës - veçanërisht e fjalës dhe diversitetit politik - shërbente vetëm për të mbrojtur qeveritë, korporatat dhe elitën, në politikën e vazhdueshme të shtypjes ekonomike dhe racore.

Kohët e fundit, një rrymë mendimi në marrëdhëniet ndërkombëtare, po thekson se si politika e jashtme që drejton qeveritë perëndimore, po ndan tani botën midis tolerancës dhe jo tolerancës, në të njëjtën mënyrë siç ka dalluar dikur qytetërimi (të bardhët) nga barbarët (të gjithë të tjerët). Toleranca është thellësisht e rrënjësuar në morinë e idealeve të

dukshme moderne: si një e mirë e natyrshme, një etikë e nevojshme individuale, një shtyllë e civilizimit perëndimor dhe dëshmi e superioritetit të saj.

Megjithatë, toleranca, si një ide dhe një etikë, anashkalon ndërveprimin midis individëve dhe grupeve, në përditshmëri dhe gjatë një periudhe afatgjatë; shkëmbimin e ndërsjellë kulturor dhe ideor ndërmjet grupeve në një shoqëri. Grupet nuk bashkëveprojnë në izolim, ato ndajnë reciprocisht, nganjëherë qëllimisht, dhe ndonjëherë pa dashje. Nëse është e vërtetë që ekziston një shoqëri globale, ajo që mishëron sot pjesën më të

Si e tillë, toleranca mbetet një marrëdhënie vetme ndërmjet tolerimit dhe tolerancës, që me qëllim ose jo, e mban të toleruarit jashtë anëtarësimit të plotë në grupin dominues. Në dallim nga toleranca, reciprociteti njeh që shoqëritë e forta dhe dinamike, janë të bazuara në shkëmbimin social dhe kulturor




mirë nuk është toleranca, por reciprociteti, marrëdhënia jetike dhe dinamike e shkëmbimit të ndërsjellë. që ndodh çdo ditë ndërmjet individëve dhe grupeve brenda një shoqërie.

Islami, Budizmi, Konfucianizmi, Sikhizmi dhe shumë qytetërimi të tjera kanë ruajtur historikisht traditat e tyre të tolerancës fetare. Nga ana tjetër, Reformacioni në Europë, e zgjeroi intolerancën. Reformacioni i bëri gjyqet kundër herezisë, një simbol të përkushtimit fetar. Para se të arriheshin kompromiset që të krishterët e ndryshëm të jetonin me njëri-tjetrin, luftërat e dhunshme fetare e rrënuan Europën për 100 vjet e ca vjet. Një refuzim i krishterë për të toleruar devijime të rëndësishme nga ortodoksia doktrinale - hebre apo mysliman, "paganë" dhe "egërsirat" me të cilët evropianët po ndesheshin më së pari në Epokën e Zbulimit të tyre - ishte shenjë e shenjtërisë dhe pastërtisë, gatishmërinë për të vënë çështjet shpirtërore, mbi shqetësimet tokësore.

U deshën shumë vite, me uljengritje dramatike, që ideja e tolerancës të shndërrohej në një vlerë pozitive të vlerësuar në shoqërinë evropiane. Për teoricienët e parë të tolerancës angleze si Xhon Lok, toleranca ishte e nevojshme para së

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazelë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - nr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 22 korrik | Numri i parë i gazetës do të 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

gjithash për të mbrojtur krishterimin dhe shpirtat e të krishterëve. Vetëm në shekullin XVII-të, ideja e tolerancës filloi të hedhë rrënjë në Evropë si një parim në përputhje me qeverisjen e mirë dhe efektive. Iluminizmi, rritja e shteteve kombëtare, dy luftërat botërore dhe dekolonizimi evropian i pasluftës, e transformuan tolerancën nga një koncept ligjor që rregullonte privilegjet dhe aftësitë e kufizuara të feve që janë pakicë, në një ideal filozofik dhe etik. Me ngritjen e korpusit ligjor ndërkombëtar të të drejtave të njeriut pas Luftës së Dytë Botërore, shtetet ndaluan artikullimin e mbrojtjes së pakicave në dekrete të tolerances, apo garanci të të drejtave të pakicave. Në fakt, tolerance, nuk i ka shpëtuar kurrë origjinës së saj si një mjet i shumicës për të zgjidhur problemet e pakicës.

Si e tillë, toleranca mbetet një marrëdhënie e vetme ndërmjet tolerimit dhe tolerancës, që me qëllim ose jo, e mban të toleruarit jashtë anëtarësisë së plotë në grupin dominues. Në dallim nga toleranca, reciprociteti njeh që shoqëritë e forta dhe dinamike, janë të bazuara në shkëmbimin social dhe kulturor. Reciprociteti është një filozofi, një etikë shoqërore, një mënyrë për të parë botën dhe një psikologji. Ai mund të shërbejë si një përshkrim i asaj që lidh individët dhe grupet brenda një shoqërie, dhe shkëmbimi i ndërsjellë i kulturës shërben si një jetë e gjallë e të gjitha shoqërive të begata.

Për të zhvilluar konceptin e reciprocitetit si një etikë politike individuale dhe kolektive, ne mund ta mësojmë, ta studiojmë dhe të shkruajmë për të. Ne gjithashtu mund të pranojmë përgjegjësitë tona qytetare, shoqërinë tonë dhe njëri-tjetrit, ndërsa respektojmë kontributet e të tjerëve. Kushtetuta e Republikës së Dytë Franceze, e miratuar gjatë valës së revolucioneve demokratike të njohura si Pranvera e Popujve, që përfshiu Evropën më 1848, përfshin një nen të thjeshtë që nuk i jep asnjë të drejtë apo fuqi as shtetit dhe as popullit. Neni VI thotë vetëm: "Detyrat reciproke, i bëjnë qytetarët të kenë detyrime ndaj Republikës, dhe Republika të ketë detyrime ndaj qytetarëve". Reciprociteti e bën këtë pretendim, por shkon më tej: sa më shumë që pranojmë atë që lidhet reciprokisht çdo grup me shoqërinë dhe shoqërinë për secilin grup, aq më mirë do të jemi të gjithë.

(Simon Rabinovitch, është profesor historie në Universitetin e Bostonit në SHBA. Ai është autor i librit "Rite hebraike, rite Kombëtare: Nacionalizmi dhe autonomia në Rusinë e vjetër perandorake dhe revolucionare" 2014)

Ukraina, viktima e parë e Trumpit. Dhe s'do të jetë e fundit

Nga

Natalia ANTONOVA



Që samiti Trump-Putin në Helsinki, ishte një katastrofë diplomatike për Shtetet e Bashkuara kjo është e padiskutueshme, pavarësisht shpjegimeve dredhuese se si president Donald Trump hodhi "aksidentalisht" poshtë komunitetin e vet të inteligjencës, nën favor të Rusisë. Megjithatë, humbësja më e madh e menjëhershme e këtij takimi mund të jetë Ukraina - një vend që mediat perëndimore e kanë braktisur gjerësisht, edhe pse ushtarët e saj vazhdojnë të vdesin në një konflikt gati "të ngrirë", në një betejë pa krye kundër Rusisë, dhe forcave të mbështetura prej Moskës në lindje të vendit.

"Djemtë tanë të vranë nuk janë asgjë për Trump". Është një refren i zakonshëm që e kam dëgjuar nga njerëzit në Ukrainë, që pas Helsinkit. Pavarësisht nëse zgjedhim ta pranojmë apo jo, Ukraina kullon ende gjak që nga konflikti në Donbas - dhe SHBA-ja supozohet t'i bashkojë ukrainasve kundër kërcënimit të Vladimir Putin. Megjithatë, administrata Trump ka qenë prej fillimit e paqëndrueshme në marrëdhëniet e saj me Rusinë, dhe akuzat se Moska ka ndërhyrë në zgjedhjet që përfundimisht e ngjiten Trumpin në pushtet, luajnë një rol të madh në këtë sjellje.

Sipas shumë të dhënave, Trump nuk pritej të fitonte në vitin 2016, dhe tashmë ka frikë se mos duket një president i paligjshëm. Kjo është arsyeja, se përse Putin ka deklaruar me qetësi për mediat e tij shtetërore, se ai dhe Trump diskutuan se si mund gjejnë zgjedhjen më të mirë për t'i dhënë fund konfliktit në Ukrainë. Putin nuk do të zbulonte aq shumë, në rast se nuk do të ishte mjaftueshëm i bindur, se gjithçka që thuhej do të ishte e dobishme për Rusinë në një plan afatgjatë. Sepse Trump dëshiron të luajë butë, të paktën për momentin. Ndryshe nga shumica e amerikanëve, ukrainasit përdoren për dredhi të po-

shtër politike - kjo është ajo që ata kanë pësuar vazhdimisht si një komb. Dhe përfshin edhe tradhtinë nga elita e vet paturpësisht e korruptuar politike, përveç dhunës dhe mashtrimit që vjen nga Kremli. Edhe pse shoqëria civile ukrainase ka lulëzuar në epokën e re post-Euromaidan, pavarësisht nga një kërcënim ekzistencial nga ana e Moskës, struktura politike lokale ka mbetur e zhytur në skandale, dhe ndaj saj ka shumë pakënaqësi.

Pasi pashë reagimet tronditëse në samit, gjithçka që dëshiroja t'u tregoja amerikanëve të tjerë ishte diçka që do të ishte e qartë edhe për shumicën e ukrainasve: Presidenti Trump interesohet më shumë për markën e tij personale, dhe reputacionin si një "marrëveshje-bërës", sesa për sigurinë kombëtare dhe imazhin e kombit të tij. Për shumicën e amerikanëve, ky është një zbulim i neveritshëm dhe zhgënjyes. Për shumicën e ukrainasve, kjo është thjesht politikë. Njëkohësisht, do të ishte e mençur të kujtojmë se Trump është jashtëzakonisht jo koherent mbi shumicën e çështjeve, e lëre më pas mbi politikën e jashtme. Putin, i cili tani ka pranuar në thelb se donte fitoren e Trump, edhe pse refuzon të pranojë ndërhyrjen në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016, duket se e mban këtë në mendje. Kjo është një nga arsyet pse ai është optimist dhe ende i rezervuar ndaj Trump.

Ndërsa Putin në veçanti ka qenë në pushtet për aq gjatë, sa që instinktet e tij janë duke u zhdukur, një kthesë e papritur nga ana e Trump në lidhje me ndërhyrjen e zgjedhjeve ruse, është e detyruar të ndodhë dhe mund të jetë në kartat e lojës. Dhe Putini, ka të ngjarë ta shohë atë të përdoret shumë shpejt. Për të gjithë gabimet e veta, qeveria e Ukrainës e kupton edhe këtë. Kjo është arsyeja pse ne nuk kemi parë një reagim të zëshëm nga Kievi pas takimit të Hel-

Dëmi që Trump po i shkakton institucioneve amerikane dhe pozitës globale të Amerikës, do të jetë i vështirë të zhbëhet - dhe ka të ngjarë që ai të marrë forma shumë të shëmtuara para fundit. Pas-goditjet do të ndihen në Shtetet e Bashkuara, por gjithashtu shumë më larg. Problemi me Ukrainën, mund të jetë vetëm fillimi



sinkit. Nga njëra anë, Ukraina është thjesht një peng i lojës më të madhe, ose më mirë, kaosit më të madh, që po ndodh në skenën botërore. Nga ana tjetër, dëshira e Trumpit për t'u menduar si planprishës politik, do të thotë që Ukraina mund të përfitonte shumë mirë kur presidenti amerikan të vendosë që ai duhet për shembull, të duket më heroik, ose kurdo që mund të ndodhë një përplasje me Putinin.

Udhëzimet për të braktisur çdo lloj shprese, u shkruan shkëlqyeshëm mbi portën hyrëse të Ferrit të Dantes. Për ata që duan të hyjnë në ferrin e sotëm politik, braktisja e të gjitha arsyeve ka më shumë kuptim. Nga pakujdesia e Trump në Helsinki, tek përpjekjet e tij për të zbutur më pas situatën, ka një panoramë e njohur për ata prej nesh që i kushtojnë vëmendje të Shtëpisë së Bardhë: askush nuk e nis dot këtë "avion", nëse nuk llogarisni egon e Trump - dhe duket qartazi se këshilltarët e Trump nuk e llogarisin fare këtë. Për ata prej nesh në Kiev ose për këtë çështje edhe në Londër, është mirë që të rezistojnë, dhe të presin që stuhia të zbutet. Për ata prej nesh në Uashington, është më mirë të rezistojmë sa më shumë që të mundemi ndaj status kuosë së çuditshme dhe gërryese. Një tjetër mësim i vlefshëm që ukrainasit na kanë kaluar neve është ky: autoriteti moral dhe etik i shtetit, është tmerrësisht i lehtë për t'u minuar, dhe në fund të fundit për t'u shkatërruar. Dëmi që Trump po i shkakton institucioneve amerikane dhe pozitës globale të Amerikës, do të jetë i vështirë të zhbëhet - dhe ka të ngjarë që ai të marrë forma shumë të shëmtuara para fundit. Pas-goditjet do të ndihen në Shtetet e Bashkuara, por gjithashtu shumë më larg. Problemi me Ukrainën, mund të jetë vetëm fillimi. (The Guardian)

(Natalia Antonova është gazetare dhe dramaturge ukrainase-amerikane me banim në Nju Jork)



Për Hazardin nuk ka asnjë pazar

Drejtuessit e Çellsit kanë bërë me dije se do të bëjnë gjithçka është e mundur për të mbajtur në skuadër sulmuesin belg Eden Hazard dhe se nuk do të bëjnë pazar me Real Madridin për ta lënë të lirë lojtarin me një çmim qesharak. Edhe pse skuadra "merengues" ka ofruar 170 milionë sterlina, "blutë" e Londrës kanë qenë kategorikë në përgjigjen e tyre: JO. Sipas londinezëve kjo shumë është shumë e ulët krahasuar me vlerën reale të lojtarit, ndaj kanë refuzuar kërkesën. Hazard ka ende edhe dy vite kontratë me Çellsin, çka i favorizon në transferimin e belgut, pasi u jep kohë "bluve" që të bisedojnë me lojtarin për rinovimin e kontratës. Gjithsesi, në rast se oferta rritet situata mund të ndryshojë.



Berisha me valixhe, por luan titullar ndaj Hertës!

Ka qenë një e shtunë miqësore për shumë shqiptarë, ku mes tyre bie në sy fitorja 3-2 e Atalantës ndaj Hertës së Berlinit. Në një stadium të mbushur si në ditët më të bukura, në Bergamo, bluzinjtë kanë qenë spektakolare, teksa ka shënuar talenti Barrou, Mançini dhe Josip Iličić. Por, ka lënë për të dëshiruar reparti defensiv, ku Berisha që ishte titullar, pësoi dy gola nga skuadra gjermane. Ai u zëvendësua në pjesën e dytë duke i lënë vendin Golinit. Ndërkohë, vazhdojnë zërat për transferimin e tij te Lilë në Francë, edhe pse Atalanta do jo më pak se 5 milionë euro, duke qenë se aq pagoi te Lacio për shqiptarin.

Renova barazon edhe me Struga Trim Lumin

Shkup, 22 korrik – Skuadra e Renovës ka zhvilluar një tjetër ndeshje miqësore në kuadër të përgatitjeve parasezonale në Ohër. Kundërshtari i bardhekaltërve ka qenë anëtari i Ligës së dytë, Struga Trim Lum. Ndeshja nuk pati fitues, pasi e njëjta përfundoi baras 1-1. Të parët në epërsi kaluan djemtë e trajnerit Jeton Beqiri me anë të Fatjon Jusufit, ndërsa në pjesën e dytë rezultatin për skuadrën nga Struga e shënoi Valentin Koçoski. Ndryshe, vlen të përmendim se pas rezultati 1-0 në të mirë të Renovës, kapiteni i "gjipspunuesve" Fisnik Nuhiu nuk realizoi nga pika e bardhë. Cekim, javën e kaluar Renova luajti 0-0 ndaj Skënderbeut, ndërsa para se të udhëtojë për në Ohër ka luajtur edhe me Goblelin nga Kumanova ku fitoi me rezultatin 2-1 si dhe me skuadrën e "New York" duke fituar me rezultatin e thellë 9-0. Gjithashtu vlen të përmendim se trajneri i ri i kësaj skuadre është Jeton Beqiri.



GLEDI MICI FLET PËR PËRSHTYPJET E PARA SI FUTBOLLIST I KUQEZINJVE

DUA TË BËJ HISTORI ME SHKËNDIJËN

Menjëherë pasi ka firmosur kontratën, Mici është prezantuar në fanellën e tij të re, atë kuqezi, ndërsa pas gjithë kësaj ai për kanalin zyrtar të klubit tetovar ka treguar përshtypjet e para duke thënë se mezi pret të paraqitet me klubin e ri

Shkup, 22 korrik - KF Shkëndija të shtunën ka zyrtarizuar përforcimin më të ri, (i katërti gjithsejtë) mbrojtësin e majtë Gledi Mici, i cili vjen nga radhët e Skënderbeut të Korçës. 27-të vjeçari i është bashkuar skuadrës së Qatip Osmanit, ndërsa ka nënshkruar kontratë dy vjeçare. Mici paraprakisht kompletoi dy sezona të shkëlqyeshme me Skënderbeun e Korçës me të cilët fitoi kampionatin, Kupën dhe Super Kupën Shqipërisë, derisa ka luajtur edhe në grupet e Liga Evropës. Menjëherë pasi ka firmosur kontratën, Mici është prezantuar në fanellën e tij të re, atë kuqezi, ndërsa pas gjithë kësaj ai për kanalin zyrtar të klubit tetovar ka treguar përshtypjet e para duke thënë se mezi pret të paraqitet me klubin e ri. "Së pari dua të them se jam shumë i lumtur që firmosa me Shkëndijën e Tetovës pasi dihet se është një klub i madh, mjaft korrekt dhe që ka bërë histori edhe në arenën ndërkombëtare evropiane", shprehet Mici pas zyrtarizimit të marrëveshjes me Shkëndijën. "Impresionet e mia janë shumë pozitive, çdo gjë këtu më duket profesionale. I vet-

mi problem i imi është që të angazhohem sa më shpejtë me grupin dhe të filloj stërvitjet", shtoi më tej 27 vjeçari. Ndryshe, Mici fton mbështetësit e klubit për përkrahje në drejtim të arritjes së objektivave madhorë në skenën vendore dhe ndërkombëtare. "Ftoj të gjithë tifozët dhe 'Ballistët' që të na përkrahin që të arrijmë objektiva madhore qoftë në kampionatin maqedonas ku tashmë Shkëndija është ekipi kampion dhe dihet se çfarë duhet të arrijë, por qoftë edhe në arenën ndërkombëtare në Evropë të bëjmë historinë dhe minimumi të kapim grupet e Europa Ligën", përfundoi mbrojtësi i majtë, Gledi Mici, i cili me prejardhje është nga Tirana, kurse gjatë karrierës së tij ka luajtur me sukses për Kukësin, Flamurtarin e Vlorës, Kamzën dhe Apoloninë dhe së fundmi Skënderbeun. Ndërkohë, nga klubi tetovar njoftojnë se për shkaqe dokumentacioni Mici të drejtë loje nuk do të ketë në duelet me Sheriff Tiraspolin, ndërsa do të jetë në dispozicion të stafit teknik në rast të kualifikimit në raundin e tretë të Ligës së kampionëve.



Angellovski me probleme para startit të Ligës së Kombeve

Shkup, 22 korrik - Së paku 5-6 lojtar titullar të përfaqësueses së Maqedonisë po ballafaqohen me probleme bën të ditur portali sportiv "sportmedia", transmeton gazeta KOHA. Radeski dhe Zajkov duhet të nënshtrohen ndërhyrjes kirurgjike, derisa pas një muaj e gjysmë fillon Liga e Kombeve. E gjithë kjo paraqet kokë dhimbje për seleksionuesin Igor Angellovski. Ndryshe, pos Radeskit dhe Zajkov, mbrojtësi Darko Vellkovski pas transferimit te Rjeka – nuk po stërvitet, Ferhan Hasani edhe më tej nuk ka gjetur klub pas largimit nga Shkëndija dhe është jashtë formës së tij. Këtyre futbollistëve ju ba-



shkëngjiten edhe Kire Ristevski, i cili po stërvitet me skuadrën e Vashash, por është në kërkim të një klubi të ri, derisa diçka e ngjashme është situata edhe me Ilija Nestorovskin dhe Aleksandar Trajkovski, të cilët së fundmi u regjistruan në listën e golashënuesve për Palermon ndaj Sapada. Kur jemi te ndryshimi i klubeve, këtë

verë atë pritet ta bëjnë edhe Dimitrievski dhe Arijan Ademi. Nëse është diçka e mirë, ai është Elif Elmas te skuadra e Fenerbahçes, i cili është titullar në ndeshjet kontroluese. Ai të shtunën ka arsyetuar besimin e trajnerit holandez, Filip Koku, duke shënuar gol për skuadrën turke. Kjo donë të thotë se ylli i ri mund të jetë në plan të parë te Angellovski në muajin shtator. Ndërkohë, nuk duhet harruar edhe formën e mirë në të cilën po kalon Enis Bardhi te skuadra e Levantes. Aktualisht futbollisti shqiptar po realizon fazën përgatitore me skuadrën e tij për fillimin e sezonit të ri në Primera Divizion.

NGA BURGUT E LIDHJET ME BERLUSKONIN

E KALUARA E ERRËT E SKARONIT

Me një diplomë në ekonomi, të marrë në universitetin Boçoni, Skaroni ka bërë edhe një master në "Columbia University" të Nju Jorkut, para se të punonte në ndërmarrje si MekKinsej, Shevron, Saint Gobain dhe Teçint. Si administrator i deleguar i kësaj të fundit, është përfshirë në hetimin "Duar të Pastra" të 1992-it: më 14 korrik të të njëjtit vit është arrestuar me akuzën se i ka paguar ryshfet partive për të siguruar tenderë nga Enel (Ndërmarrja Shtetërore e Energjisë Elektrike)



Pasi është mbyllur kapitulli Jonghong Li, Milani i ri i Elliot ka vendosur të riniset nga Paolo Skaroni. Është ai njeriu i përzgjedhur si presidenti i ri i kuqezinjve. "Një nder i madh, jam milanist dhe shumë i lumtur që jam këtu", kanë qenë fjalët e para pas emërimit.

NGA BURGUT E VICENZA

Me një diplomë në ekonomi, të marrë në universitetin Boçoni, Skaroni ka bërë edhe një master në "Columbia University" të Nju Jorkut, para se të punonte në ndërmarrje si MekKinsej, Shevron, Saint Gobain dhe Teçint. Si administrator i deleguar i kësaj të fundit, është përfshirë në hetimin "Duar të Pastra" të 1992-it: më 14 korrik të të njëjtit vit është arrestuar me akuzën se i ka paguar ryshfet partive për të siguruar tenderë nga Enel (Ndërmarrja Shtetërore e Energjisë Elektrike). Në vitin 1996 ka rënë dakord me prokurorinë për të shlyer një vit e katër muaj burg. Duke komentuar këtë ngjarje për "Financial Times" në 2002-in, ai ka thënë: "Në një vend ku punët e shtetit ishin shumë të ndërthurura, ku institucionet kontrolloheshin nga politikanët, a ishte e mundur të kishe një qëndrim të ndryshëm? Përgjigja e thjeshtë është: jo, nuk ishte e mundur". mes fundit të viteve '90

ELLIOTT: FASSONE TRADHTOI MILANIN

Klubi kuqezi vendosi të ndërpresë bashkëpunimin me Marko Fassonen, i akuzuar për tradhti, bashkë me presidentin Li Jonghong, ashtu si administratorët kinezë. Ky ka qenë vullneti i fondit "Elliott" që u zbatua në ditën e Asamblesë së Aksionarëve. Arseja e shkarkimit të administratorit të deleguar Fassone ishte: "Kompromentim i

raportit financiar për mënyrën si ka administruar fondet dhe metodikën e zhvillimit të merkatos në Evropë dhe Azi. Vetëm në ditët e fundit kemi zbuluar gabimet e bëra prej tij dhe "Rossoneri Sport Investment Lux" vendosi ta largojë për të mirën e klubit, si domosdoshmëri". Frazë e cila nënkupton tradhtinë dhe lë të hapur hapësirën për një seancë gjyqësore.

dhe fillimit të 2000-it, ai është transferuar në Londër, por nga 1997-a e deri në 1999-ën, ka mbuluar detyrën e presidentit të Viçencas, klubi i vendlindjes së tij.

LIDHJA ME BERLUSKONIN

Në 2002-in është kthyer në Itali, për të mbuluar detyrën e administratorit të deleguar të Enel, i emëruar nga qeveria e dytë e Silvio Berluskonit. Në 2005-ën, më pas, ka

ardhur kalimi tek Eni (Ndërmarrja Kombëtare e Hidrokarbureve), ku ka qëndruar deri në 2014-ën, para se të bëhej zëvendës-president i bankës tregtare Rothschild. Para se të binte Milani i Jonghong Li, vetë Berslukoni i ka besuar Skaronit një paketë të aksioneve të klubit, duke u bërë pjesë e këshillit administrativ më 14 prill të 2017-ës dhe tani është bërë presidenti i 27-të i historisë kuqezi dhe administratori i deleguar i përkohshëm.



70 mln euro për qendërmbrojtësin e Anglisë

Hoze Murinjo ka shfaqur haptazi interesimin për mbrojtësin e Leicester Siti, Harry Maguire dhe po mendon të ofrojë 70 milionë euro për të. Trajneri portugez dëshiron një qendërmbrojtës të nivelit më të lartë për t'ia shtuar Markos Rojo, Erik Bailly dhe Kris Smalling. Leicester është gati ta çojë deri në 90 mijë euro në javë pagën e Maguires, për ta mbajtur edhe një sezon, por "dhelprat" e dinë se nëse oferta e Junajted zyrtarizohet, atëherë ai do të largohet. Klod Puel po mendon edhe për zëvendësuesin e Maguire dhe Yerry Mina i Barcelonës dhe Gei Kejhili i Çellsit janë alternativat. Maguire u ble nga Hull, për 20 milionë euro në verën e kaluar, për çmimi i tij është trefishuar si pasojë e paraqitjes me Anglinë në Kupën e Botës. Ai do të zërë vendin e Fil Xhons ose Smalling te formacioni i Murinjos, ashtu si bëri në "Rusi 2018". Problemi i vetëm mund të jetë fakti se me 9 gusht mbyllet merkato në Premier Ligë dhe Maguire do të jetë ende me pushime.

Dy klube angleze pas turkut Under

Mes surprizave të sezonit të kaluar në Serie A nuk mund të mos përmendet emri i Xhengiz Under, i ardhur te Roma në verën e kaluar dhe që "shpërtheu" sapo mbaroi periudhën e ambientimit me futbollin dhe gjuhën italiane. Paraqitjet e turkut të lindur në vitin 1997 ka rënë në sytë e disa prej klubeve më të mëdha të Evropës, me në krye Mançester Sinit dhe Totenhemin. Siti donte ta merrte që para se të shkonte te Roma, kësaj po vazhdon monitorimin e tij duke pritur momentin e duhur për ta sjellë në "Etihad". Ndërkohë, gazeta turke "Hurriyet" ka shkruar se Pokettino ka kërkuar nga drejtuesit e Totenhemit të punojnë për blerjen e Under, edhe pse te londinezët, pas shpinës së Kin, ka futbollistë të tillë si Lukas Moura, Eriksen, Dele Alli, Lamela dhe Son. Sivjet, Under do të qëndrojë te Roma, por sirenat angleze janë shtuar dhe kanë filluar të kumbojnë, verën e ardhshme do të nisë një "telenovelë".



SportFLESH

Hart në vend të Kurtoas

Xhoe Hart është emri i ri që ka nisur të qarkullojë në klubin e Çellsit për të zëvendësuar Thibaut Kurtoa. "Blutë" përgatiten të shpenzojnë rreth 5 milionë euro për portierin që nuk bën pjesë në planet e Mançester Siti dhe në dy sezonet e fundit ka qenë i huazuar te Torino dhe Uest Hem. Duke parë çmimin e tij, trajneri i ri i Çellsit, Sarri, i ka dhënë drejtuesve idenë ta marrin Hartin në ekip dhe më pas rrugës të vendoset nëse do të jetë apo jo titullari i "bluve", duke zëvendësuar Kurtoa, gjithnjë e më parë Real Madridit. Hart aktualisht ka udhëtuar me Sinit për në SHBA, por do të pranonte me kënaqësi kalimin te Çellsit, ku 31-vjeçari do të ndihej sërish i rëndësishëm, ndryshe nga ajo që po ndodh aktualisht me trajnerin Pep Guardiola. Ai ka edhe 12 muaj kontratë me Sinit prandaj nuk kush-ton më shumë se 5 milionë euro.

Ofron Shurrlen për Zahan

Vilfried Zaha kërkon të largohet nga Kristal Pallas dhe dy janë klubet e interesuara për të Evertoni dhe Dortmundi, që i ka treguar derën Andre Shurrles. Gjigantët e Bundesliës po bëjnë të pamundurën që ta shesin Shurrlen në Premier Ligë dhe marrëveshja mund të arrihet javën e ardhshme. Pallas kërkon të paktën 60 milionë euro për Zahan, që më pas të investojë rreth 30 milionë euro për të marrë Mikail Antonio nga Uest Hemi. 27-vjeçari Shurrlë nuk bën më pjesë në planet e Borussias dhe këtë e tregon fakti se nuk u aktivizua asnjë minutë në miqësoren e fituar 1-0 kundër Sinit në Çikagos. Dortmundi synon ta çojë te Pallace për të ulur çmimin e Zahas.

Tuçel kërkon Boatengun dhe Veiglin

Trajneri Tomas Tuçel i kampionëve francezë Paris Sen-Zhermen gjatë kërkimeve të përforsimeve të reja në prag të sezonit thuhet të ketë piketuar Zherome Boateng nga FC Bjyern dhe Julian Veigl nga Borussia Dortmundi. Këtë e raporton francezja e mirënjohur "L'Equipe". Por shuma që kërkon Bajerni për qendërmbrojtësin gjerman është rreth 80 milionë euro. Alternativa mbetet Leonardo Bonuçi i Milanit, i cili kushton sa gjysma e Boateng. Edhe interesi për blerjen e Veigl të BVB është i madh. 22-vjeçari është trajnuar nga Tuçel kur ishin te 1860 Munih, gjithashtu edhe te Borussia. Gjithsesi, për talentin thuhet të jetë interesuar edhe FC Barcelona. Ai do të kushton-te minimalja 50 milionë euro. Kontrata e lojtarit skadon më 2021.

Aston Villa mendon për Henrin

Tierry Henri mund të marrë drejtimin e Aston Villas në Premier Ligë. Miliarderi egjiptian, Nassef Saviris, i cili pak kohë më parë ka marrë në pronësi mazhorancën e aksioneve të klubit, po përgatitet t'i bëjë një ofertë joshëse francezit për të pasuar në krye të bankinës Stiv Brus. Henri u vlerësua për punën e tij në rolin ndihmësit të Roberto Martinezit, që e çoi Belgjikën deri në gjysmëfinale të Botërorit.



KOMUNA E MANASTIRIT
SHPALLJE 1/2018
nr. 12-57/2018
20.07.2018

Për tjetërsim të tokës ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë përmes ankandit publik elektronik për ndërtimin e objekteve për qëllim:

- Banim në ndërtesa banesore - A2, në pajtim me PDU për "ARM Çereku 1, ARM Çereku 2 dhe ARM Çereku 3" - Manastir
- Banim në shtëpi banesore - A1, në pajtim me PDU për ndryshime dhe plotësime të lagjes "Ushici pjesa 1 – pjesa e re e paraparë" – Manastir
- Veprimtari komerciale dhe afariste, njësi të mëdha tregtare, njësi të mëdha hotelerike dhe superstrukturë komunale – B2, B3, E2, Prodhim, distribuim dhe shërbime G2,3,4 në pajtim me Ndryshimet dhe plotësimet e Planit urbanistik jashtë vendbanimit "Zona jugore industriale Zhabeni" Komuna e Manastirit

LËNDË E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lëndë e ankandit publik elektronik është tokë e pandërtuar ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë e paraparë për ndërtim të objekteve të dedikuara për banim në ndërtesa banesore A2 me qëllime kompatible, në pajtim me PDU për "ARM Çereku 1, ARM Çereku 2 dhe ARM Çereku 3" - Manastir të sjellë me vendim të Këshillit të Komunës së Manastirit nr. 07-1791/3 të datës 06.09.2010, tokë e pandërtuar ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë e paraparë për ndërtim të objekteve të dedikuara për banim në shtëpi banesore A1 në pajtim me PDU për ndryshime dhe plotësime të lagjes "Ushici pjesa 1 – pjesa e re e paraparë" – Manastir të sjellë me vendim të Këshillit të Komunës së Manastirit nr. 07-2387/7 të datës 29.03.2000, tokë e pandërtuar ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë e paraparë për ndërtim të objekteve me qëllim për prodhim, distribuim dhe shërbime G2,3,4 në pajtim me Ndryshimet dhe plotësimet e Planit urbanistik jashtë vendbanimit "Zona jugore industriale Zhabeni", të sjellë me Vendimin e Këshillit të Komunës së Manastirit nr. 07-2177/33 të datës 28.09.2011, në pajtim me Pasqyrën tabelore në të cilin janë dhënë të dhënat e parcelës ndërtimore dhe, numri i parcelës ndërtimore, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës ndërtimore, qëllimi i tokës (klasa fillestare), qëllimi i tokës (përshkrimi), sipërfaqja e ndërtimit, bruto sipërfaqja e zhvilluar, përqindja e ndërtimit, koeficienti i shfrytëzimit të tokës, lartësia e lejuar maksimale, katet, çmimi fillestar i caktuar për metër katror, çmimi i përgjithshëm fillestar i caktuar dhe garancia bankare për seriozitet të ofertës.

Pasqyra tabelore:

A. Parcelat ndërtimore që do të jenë lëndë e tjetërsimit përmes ankandit publik në pajtim me PDU për "ARM Çereku 1, ARM Çereku 2 dhe ARM Çereku 3" Manastir

Numri i parcelës ndërtimore	Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës ndërtimore	Qëllimi i tokës (klasa fillestare)	Qëllimi i tokës (përshkrim)	Sipërfaqja për ndërtim	Bruto sipërfaqja e zhvilluar	Përqindja e ndërtimit	Koeficienti i shfrytëzimit të tokës	Nulta Kota	Katet	Çmimi Fillestar/i caktuar për metër katror	Çmimi i përgjithshëm/fillestar i përcaktuar	Garancia bankare për seriozitet të ofertës
	M2			M2	M2	%		M1		denarë	denarë	denarë
2.4	2595	A2	Banim në ndërtesa banesore qëllime kompatible B1,B2,,V4,V3,V4,V5, D3-40%	1519	9144	59%	3.5	1.20	P+5	2.570,00	6.669.150,00	6.669.150,00
3.1	778	A2	Banim në ndërtesa banesore qëllime kompatible B1,B2,,V4,V3,V4,V5, D3-40%	364	2184	47%	2.8	1.2	P+5	2.570,00	1.999.460,00	1.999.460,00

B. Parcelat ndërtimore që do të jenë lëndë e tjetërsimit përmes ankandit publik në pajtim me PDU për ndryshime dhe plotësime të lagjes Ushici pjesa 1 – pjesa e re e paraparë – Manastir

Numri i parcelës ndërtimore	Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës ndërtimore	Qëllimi i tokës (klasa fillestare)	Qëllimi i tokës (përshkrim)	Sipërfaqja për ndërtim	Bruto sipërfaqja e zhvilluar	Përqindja e ndërtimit	Koeficienti i shfrytëzimit të tokës	Nulta Kota	Katet	Çmimi Fillestar/i caktuar për metër katror	Çmimi i përgjithshëm/fillestar i përcaktuar	Garancia bankare për seriozitet të ofertës
	M2			M2	M2	%		M1		denarë	denarë	denarë
48	573	A1	Banim në shtëpi banesore A1	140	/	/	/	/	S+P+1+PK	61,00	34.953,00	34.953,00
49	603	A1	Banim në shtëpi banesore A1	140	/	/	/	/	S+P+1+PK	61,00	36.783,00	36.783,00

C. Parcelat ndërtimore që do të jenë lëndë e tjetërsimit përmes ankandit publik në pajtim me NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E PLANIT URBANISTIK JASHTË VENDBANIMIT "ZONA JUGORE INDUSTRIALE ZHABENI" Komuna e Manastirit

Numri i parcelës ndërtimore	Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës ndërtimore	Qëllimi i tokës (klasa fillestare)	Qëllimi i tokës (përshkrim)	Sipërfaqja për ndërtim	Bruto sipërfaqja e zhvilluar	Përqindja e ndërtimit	Koeficienti i shfrytëzimit të tokës	Nulta Kota	Katet	Çmimi Fillestar/i caktuar për metër katror	Çmimi i përgjithshëm/fillestar i përcaktuar	Garancia bankare për seriozitet të ofertës
	M2			M2	M2	%		M1		denarë	denarë	denarë
13	11905	G2,3,4	Prodhim, distribuim dhe shërbime	8324	26283	70%	2.21	1,20	P+2	61,00	726.205,00	726.205,00
68	8066	G2,3,4	Prodhim, distribuim dhe shërbime	5652	17571	70%	2.18	1,20	P+2	61,00	492.026,00	492.026,00
71	4080	G2,3,4	Prodhim, distribuim dhe shërbime	2623	7869	64%	1.93	1,20	P+2	61,00	248.880,00	248.880,00
5	4807	B2, B3, E2	Veprimtari komerciale dhe afariste, njësi të mëdha tregtare, njësi të mëdha hotelerike dhe superstrukturë komunale	2107	6321	44%	1.31	1,20	P+2	900,00	4.326.300,00	4.326.300,00

TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kanë:

Të gjitha palët e interesuara të vendit dhe të huaj fizik dhe juridik të cilët mund të marrin pronësi të tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin të cilët i përmblin kushtet të dhëna në shpallje gjegjësisht:

1. Personat fizik: shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD si dhe shtetas të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD ndërsa me kusht të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.
2. Personat juridik: person juridik lokal, person juridik në pronësi të përzier, person juridik të themeluar nga personi fizik dhe juridik i huaj, të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, persona juridik të huaj rezidentë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD, si dhe persona të huaj juridik rezidentë të shteteve që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD ndërsa të cilët me kusht të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të tokës ndërtimore në territor të Republikës së Maqedonisë.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

Personat e interesuar lokal dhe të huaj fizik dhe juridik të dorëzojnë Fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik në mënyrë elektronike përmes sistemit informatik të vendosur në internet faqen www.gradenzo-zemjiste.mk me plotësimin e formularit elektronik që e nënshkruan me certifikatë valide digjitale të dhëna nga dhënësit të autorizuar për secilin parcelë ndërtimore veç e veç, në të cilën është theksuar se për cilën parcelë ka të bëjë vetë fletëparaqitja dhe cilat dokumente janë pjesë përbërëse e fletëparaqitjes, e kompletuar me dëshmitë në vijim (të dorëzuara në formë elektronike, të skanuara):

1. Fletëparaqitje nga parashtruesi, në të cilën janë theksuar të dhëna për cilën parcelë ndërtimore ka të bëjë e njëjta dhe për parashtruesin e fletëparaqitjes, si dhe cilat dokumente janë parashtruar si shtojcë të fletëparaqitjes, të nënshkruar në mënyrë digjitale
2. Garanci bankare për seriozitet të ofertës që për secilin parcelë ndërtimore është përcaktuar në pajtim me pasqyrën tabelore të dhëna në këtë shpallje, në afat valid deri më 31.01.2019, me të cilin blerësi do të garantojë se nëse merr status të ofertuesit më të volitshëm do të paguajë çmimin e aritur përfundimtar për tjetërsim të tokës ndërtimore në ankandin publik elektronik në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm
3. Për personat fizik certifikatë të shtetësisë;
4. Për personat juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik nga regjistri përkatës (jo më të vjetër se gjashtë muaj);
5. Autorizim të rregulluar për të autorizuarin që e përfaqëson personin juridik, gjegjësisht dëshmi për cilësinë person përgjegjës i autorizuar i personit juridik;
6. e-mail adresë të dërguesit të fletëparaqitjes, përmes të cilit do të kryhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, gjegjësisht do t'i dërgohen emri përdorues dhe fjalëkalim për qasje në internet faqen në të cilën do të realizohet ankandi publik elektronik
7. Deklaratë për pranimin e kushteve në shpallje të nënshkruar me nënshkrim digjital Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik për çka dërguesit e fletëparaqitjeve të pakompletuara do të informohen në mënyrë elektronike.

Parashtruesit e fletëparaqitjeve duhet të kenë certifikatë elektronike digjitale (nënshkrim) që të mund të parashtrorin fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik.

Nëse pjesëmarrësi është i interesuar për më shumë se një parcelë ndërtimore, plotësohet fletëparaqitje e veçantë për secilin parcelë ndërtimore, për çka parashtrorhet edhe garanci e posaçme bankare për seriozitet të ofertës.

ÇMIMI FILLESTAR

Çmimi fillestar i ankandit publik elektronik për parcelat ndërtimore të theksuara në Pasqyrën tabelore me qëllim për banim në ndërtesa banesore A2 është 2.570,00 denarë për metër katror, për parcelat ndërtimore të theksuara në pasqyrën tabelore me qëllim të banimit në shtëpi banesore A1 është 61,00 denarë për metër katror dhe për parcelat ndërtimore në Pasqyrën tabelore me qëllim prodhim, distribuim dhe shërbime G2,3,4 është 61,00 denarë për metër katror dhe për parcelat ndërtimore të theksuara në pasqyrën tabelore me qëllim veprimtari komerciale dhe afariste, njësi të mëdha tregtare, njësi të mëdha hotelerike dhe superstrukturë komunale B2, B3, E2 është 900,00 denarë për metër katror.

GARANCIA BANKARE

Garancia bankare për seriozitet të ofertës për secilin parcelë ndërtimore është përcaktuar në pajtim me Pasqyrën tabelore dhe është 100% nga çmimi i përgjithshëm fillestar për secilin parcelë ndërtimore veç e veç.

AFATET

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të dorëzohen deri më 21.08.2018 në mënyrë elektronike, përmes sistemit të informimit në internet adresën në vijim www.gradenzo-zemjiste.mk

Ankandi publik do të mbahet në mënyrë elektronike në internet adresën në vijim www.gradenzo-zemjiste.mk

ANKANDI PUBLIK

Ankandi publik do të fillojë më 23.08.2018 dhe i njëjti do të zgjasë 15 (pesëmbëdhjetë) minuta si në vijim:

- Në ora 10,00 me kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) minutave PN nr. 2.4 me qëllim banim në ndërtesa banesore A2
- Në ora 10,30 me kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) minutave PN nr. 3.1 me qëllim banim në ndërtesa banesore A2
- Në ora 11,00 me kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) minutave PN nr. 48 i GP 69.49 me qëllim banim në shtëpi banesore A1.
- Në ora 11,30 me kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) minutave PN nr. 13, PN nr. 68, PN nr. 71 me qëllim prodhim, distribuim dhe shërbime G2,3,4
- Në ora 12,00 me kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) minutave PN nr. 5 me qëllim veprimtari komerciale dhe afariste, njësi të mëdha tregtare, njësi të mëdha hotelerike dhe superstrukturë komunale B2,B3,E2

PROCEDURA

1. Komisioni i lajmëron parashtruesit e fletëparaqitjeve për kompletimin e po të njëjtave në mënyrë elektronike, në afat prej 24 orëve pas përfundimit të afatit për parashtrim të së njëjtës, gjatë së cilës parashtruesit e fletëparaqitjeve që kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar, ju kanë dorëzuar emër i përdoruesit dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, ndërsa parashtruesit të fletëparaqitjeve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar ju dorëzojnë lajmërim me arsyetim se të njëjtët nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.
2. Ankandi publik elektronik mund të fillojë me së paku një pjesëmarrës në ankandin publik, për çdonjërin nga parcela ndërtimore veç e veç.
3. Ankandin elektronik publik, e ndjek Komisioni, i formuar nga Kryetari i Komunës së Manastirit.
4. Ankandi publik elektronik fillon me publikimin e çmimit fillestar të tokës për metër katror, dhe realizohet përmes ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve.
5. Ankandi realizohet "hap pas hapi" me rritjen e vlerës me secilin "hap" jo më pak se 257,00 denarë për parcelat ndërtimore me qëllim të banimit në ndërtesa banesore A2 dhe jo më pak se 10,00 denarë për parcelat ndërtimore me qëllim banim në shtëpi banesore A1, jo më pak se 10,00 denarë për parcelat ndërtimore me qëllim prodhim, distribuim dhe shërbime G2,3,4 dhe jo më pak se 90,00 denarë për parcelat ndërtimore me qëllim veprimtari komerciale dhe afariste, njësi të mëdha tregtare, njësi të mëdha hotelerike dhe superstrukturë komunale.
6. Ankandi elektronik publik konsiderohet si i mbaruar në momentin e kalimit të afatit të përcaktuar pas kësaj shpallje, gjatë së cilës nëse në dy minutat e fundit nga ana e pjesëmarrësve është dhënë ofertë, afat i fundit për mbarim të ankandit publik, vazhdonet për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur për periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk do të ketë ofertë të re të dhëna. Ankandi publik vazhdon pandërprerë derisa në intervalin kohor prej 2 minutave ka ofertë të re.
7. Pjesëmarrësi i ankandit publik që ka ofruar çmim më të lartë, fiton statusin ofertues më i përshatshëm.
8. Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përgatit procesverbal për zbatimin e ankandit publik dhe në mënyrë elektronike i dorëzon deri të gjithë pjesëmarrësve në ankandin publik.
9. Pjesëmarrësit e pakënaqur në ankandin publik mund të parashtrorin ankesë deri tek Komisioni në afat prej 3 ditëve nga mbajtja e ankandit publik elektronik. Komisioni është i obliguar në afat prej 5 ditëve nga pranimi i të njëjtës, nga pranimi i të njëjtës. Kundër vendimit të sjellë nga ana e Komisionit me të cilin vendoset në lidhje me ankesën e parashtruar, pala ka të drejtë të parashtrorë ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit deri tek Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.
10. Pas përfundimit të procedurës së ankandit publik Komisioni është i obliguar që në afat prej 3 ditë pune të dorëzojë kërkesë për mendim deri tek Avokati shtetëror i Republikës së Maqedonisë për propozim-tekst të kontratës për tjetërsim. Avokati shtetëror dorëzon mendim për propozim-tekstin për kontratën në afat prej 30 ditë nga marrja e kërkesës për mendim. Pas marrjes së mendimit pozitiv nga Avokati shtetëror i Republikës së Maqedonisë, komisioni në afat prej 3 ditë pune deri të ofertuesit më të volitshëm dorëzon lajmërim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm.
11. Ofertuesi më i volitshëm ka për obligim të paguajë mjetet në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje dhe deri tek Komisioni të dorëzojë dëshmi për pagesën e realizuar me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshme për pjesëmarrje në ankandin publik, në të kundërtën nuk do të lidhet marrëveshje, ndërsa garancia e dorëzuar bankare për seriozitet të ofertës të ofertuesit më të volitshëm do të aktivizohet dhe i njëjti nuk do të mund të marrë pjesë në çdo ankand të ardhshëm publik për parcelën ndërtimore në fjalë.
12. Në afat prej 5 ditëve të punës pas dorëzimit të dëshmitë për pagesën e realizuar dhe dorëzimit të dokumentacionit të tërësishëm të nevojshëm për pjesëmarrje në ankandin publik, Kryetari i Komunës së Manastirit do të lidhë marrëveshje për tjetërsim të tokës ndërtimore.

13. Pas lidhjes së marrëveshjes komuna e Manastirit në afat prej 1 dite, në mënyrë elektronike dorëzon marrëveshjen në departamentin për çështje financiare për përcaktimin e tatimit të qarkullimit të patundshmërive. Blerësi është i obliguar në afat prej 15 ditëve nga marrja e vendimit për përcaktimin e tatimit të qarkullimit të patundshmërive të paguajë tatimin dhe të dorëzojë dëshminë për pagesën e realizuar.

14. Mospërbushja e obligimeve nga pikat 11 dhe 12 të kësaj shpallje me faj të blerësit paraqet bazë të njëanshme për anulim të marrëveshjes gjatë së cilës 80% e shumës së përgjithshme nga tjetërsimi nuk i kthehet blerësit.

15. Së bashku me marrëveshjen ofertuesi më i volitshëm (blerësi) obligohet në afat prej 30 ditëve nga nënshkrimi i të njëjtës ta dorëzojë në mënyrë elektronike tek Noteri për shkak të solemnitizimit.

16. Pas lidhjes së marrëveshjes, me kërkesë të blerësit, e njëjta futet në pronësi me procesverbal nga ana e Komisionit tre anëtarësh të formuar nga kryetari i komunës, me pjesëmarrje të personit profesional gjeodezik i regjistruar si tregtar individual, gjeodet i autorizuar ose shoqëri tregtare për punë gjeodezike, i cili në bazë të elaboratit gjeodezik do të bëjë shënimin e të njëjtës. Shpenzimet për futje në pronësi, përveç shpenzimeve të punës së Komisionit, bien në barrë të blerësit.

17. Me marrëveshje ofertuesi më i volitshëm obligohet që në afat prej 9 muajve nga solemnitizimi i realizuar i marrëveshjes për parcelën ndërtimore e cila është me sipërfaqe deri në 5.000 m², gjegjësisht në afat prej 12 muaj nga solemnitizimi i realizuar i marrëveshjes për parcelën ndërtimore që është me sipërfaqe mbi 5.000 m² të sigurojë leje për ndërtim të objekteve të parapara në pajtim me planin urbanistik për çka është tjetërsuar toka dhe të ndërtojë objektet në pajtim me planin urbanistik për çka është tjetërsuar toka, në afat prej 2 (dy) viteve pas marrjes së lejes së plotfuqishme për ndërtim me bruto sipërfaqe të ndërtimit deri më 1000 m², në pajtim lejen e marrë për ndërtim, gjegjësisht në afat prej 4 (katër) viteve nga marrja e lejes së plotfuqishme për ndërtim me bruto sipërfaqe të ndërtimit mbi 1000 m², në pajtim me lejen e marrë për ndërtim.

18. Përqindja minimale që duhet të ndërtohet nga sipërfaqja e përgjithshme e zhvilluar për ndërtim e paraparë me planin urbanistik për parcelën ndërtimore në fjalë nuk guxon të jetë më e vogël se 30%.

19. Nëse në afatin e caktuar nuk sigurohet leje për ndërtim ose objekti nuk ndërtohet me faj të blerësit, i njëjti ka obligim të paguajë gjatë të mosrespektimit të afatit në shumë prej 1,5 % nga shuma totale e aritur në ankandin publik të lëndës për tokën për çdo muaj të kaluar në vitin e parë pas kalimit të afatit, gjegjësisht 3 % nga gjithsej çmimi i aritur në ankandin publik për trullin në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e dytë pas kalimit të afatit, gjegjësisht 4,5 % nga gjithsej çmimi i aritur i ankandit publik për trullin në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e tretë dhe vitin e ardhshëm pas kalimit të afatit. Mospotësimi i këtyre obligimeve, gjegjësisht pas rënies së blerësit në vonesën me plotësimin e këtyre obligimeve 3 (tre) muaj një pas një, paraqet bazë tjetërsuesi, pas tre hirëve të njëpasnjëshme mujore për realizim, si kreditor me deklaratë për mospotësim të obligimeve të marrëveshjes të kërkojë vërtetim për realizim të marrëveshjes, gjegjësisht të kërkojë pagesë të dënimt të kontraktuar që paraqet dhe bazë për ndërprerje të njëanshme të kontratës, ku 80% e çmimit të përgjithshëm të tjetërsimit nuk i kthehen blerësit.

20. Blerësi është i obliguar që të paguajë tatimin e qarkullimit që do të dalë si obligim i lidhjes së marrëveshjes për tjetërsim të tokës ndërtimore.

21. Në çmimin e tokës ndërtimore nuk është përfshirë kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore. Shpenzimet për procedurën noteriale dhe futjen në evidencë të patundshmërive në Agjencinë për kadastrë të patundshmërive bien në barrë të blerësit të tokës ndërtimore.

23. Pronari i tokës ndërtimore të fituar në procedurën për tjetërsim nëpërmjet ankandit publik nuk guxon të njëjtën ta bartë tek personat e tretë, para plotësimit të obligimeve nga kontrata për tjetërsim të njëjtës. Ndërsa për bartjen në persona të tretë shënohet në librin publik për regjistrim të të drejtave të patundshmërisë.

24. Shpenzimet e posaçme të procedurës për tjetërsim të tokës ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë përmes ankandit publik janë:

- shpenzime për sigurim të dëshmitë për tokë ndërtimore lëndë e ankandit publik,
- shpenzimet për publikim në media dhe vendet për shpallje publike
- shpenzimet për kontroll në vend të ngjarjes dhe përcaktim të gjendjes faktike dhe futje në pronësi të tokës ndërtimore.

Shuma e shpenzimeve është 10 % e vlerës së garancisë bankare për seriozitet të ofertës.

Kjo shpallje do të publikohet në UEB faqen e Komunës së Manastirit.

www.bitola.gov.mk

FEMRA “VAMPIRE” KONFIRMON NGJARJEN QË SKANDALIZOI MEKSIKËN

Aimee Alvarez, “vampira natural”, siç e ka përshkruar veten në profilin e saj në “Instagram”, ka konfirmuar nëpërmjet “Twitter”-it se ka qenë një nga 30 vajzat që ka marrë pjesë në atë festë, por duke saktësuar se ajo që ka qenë një “escort” (shoqëruese)



E mbani mend zhurmën e madhe mediatike të krijuar rreth Meksikës një javë para fillimit të Botërorit? Festa e famshme “hot”, në të cilën kanë thuhet se kanë marrë pjesë 8 lojtarë të kombëtares dhe 30 vajza, ka zbuluar një nga protagonistët. Është Aimee Alvarez, një nga femrat e shumta që kanë marrë pjesë në atë takim të nxehtë, që ka skandalizuar një komb të tërë, duke e përçarë. Një pjesë ka kërkuar largimin e lojtarëve, pjesa tjetër ka dalë në mbrojtje të tyre. Aimee Alvarez, “vampira natural”, siç e ka përshkruar veten në profilin e saj në “Instagram”, ka konfirmuar nëpërmjet “Twitter”-it se ka qenë një nga 30 vajzat që ka marrë pjesë në atë festë, por duke saktësuar se ajo që ka qenë një “escort” (shoqëruese). Gjithsesi, flitet për një ngjarje që ka bërë shumë bujë në

vendin e Amerikës Qendrore, deri në atë pikë sa federata ka qenë e detyruar të bëjë një deklaratë për shtyp për të sqaruar pozicionin e saj në lidhje me natën e kaluar nga tetë futbollistët e “Tricolor”. Për të mos folur për faktin se Herrera, një nga liderët e skuadrës, ka bërë sherr me gruan e tij pasi gazetaret kanë publikuar lajmin.

Pavarësisht gjithçka, Federata Meksikane e Futbollit nuk ka marrë asnjë masë, përkundrazi, ka folur për liri personale të lojtarëve. Nuk mund të ndëshkoheshin, sepse nuk kanë munguar në stërvitje, as në mbledhjet teknike, dhe as kanë punuar keq. Kundër prova ka ardhur me paraqitjen e bërë në Rusi 2018, me kualifikimin (e zakonshëm) në 1/8-at, për t’u eliminuar më pas nga Brazili i Nejmar.

Duke parë zhvillimin e ngjarjeve, duket se federata ka pasur të drejtë: “vampira” dhe koleget e saj nuk i kanë harxhuar shumë energji Meksikës, që në ndeshjen e parë të Kupës së Botës ka mundur Gjermaninë. Dhe, në përgjithësi, Botërori i Meksikës ka shkuar siç pritej. “Tricolor” është konfirmuar mes 16 më të mirave të botës dhe është larguar pa shumë pengje nga Rusia. Por pyetja është: kush janë 29 vajzat e tjera që kanë tronditur Meksikën? Aimee është vetëm e para që ka bërë publike pjesëmarrjen e saj. Po të tjerat? Do të ruajnë anonimitetin? Apo, me kalimin e kohës, do të zbulohet formacioni i rreshtuar kundër tetë lojtarëve të Meksikës në atë festë të famshme?

SportFLESH

Leicester transferon portierin Vard

Leicester Siti ka nënshkruar me portierin e Liverpoolit, Danny Vard për 15 milionë euro. Vard largohet nga “Anfield” pas blerjes rekord të Alisson Beker për 73 milionë euro. Vard, 25 vjeç, i cili ka bërë katër paraqitje për Uellsin por, vetëm tre për Liverpoolin, ka nënshkruar një kontratë katërvjeçare me “dheprat”. “Kam ardhur këtu të zhvillohem dhe shpresoj të sjell më shumë suksese për klubin”, shprehet portieri. Ai ka kaluar sezonin e kaluar te Huddersfield në formë huazimi por nuk luajti asnjë ndeshje. Vard është blerja e katërt e Leicester, pas Pereira, Evans dhe Maddison.

Koman mund të shkojë te Arsenali

Unai Emery raportohet të jetë interesuar për të transferuar yllin e Bajern Muniht, Kingslej Koman përpara startit të sezonit, megjithëse ka bërë pesë blerje deri tani. “BeIN Sports” pretendon se Emery është gati të paguajë 50 milionë euro për lojtarin e Bundesligas. Robbie Lyte, ai që merret me faqen e mirënjohur të tifozëve të Arsenalit, ka zbuluar për ndjekësit e tij në mediat sociale se ai mund të jetë pro këtij transferimi. Në një post diskutimi, ai po diskutonte se cilin lojtar duhet të blinte Arsenali dhe Roobi përgjigjet për Koman. Një përgjigje që i ka pëlqyer edhe vetë lojtarit bavarez, i cili i ka bërë ‘like’ komentit.

Shoku i ekipit zbulon të ardhmen e Golovin

Aleksandr Golovin mesa duket do të shkojë te Çellsit, të paktën sipas shokut të tij të ekipit te CSKA e Moskës, Sergej Çepçugov. Lojtari i përfaqësueses ruse është përfolur për një kalim në disa klube të mëdha evropiane pas një paraqitjeje fantastike në Kupën e Botës. 22-vjeçari thuhet se do t’i bashkohet Çellsit të Maurizio Sarrit, i cili që tani ka filluar të përforcojë mesin e fushës me blerjen e Zhorginjios. Dhe mesa duket edhe Golovin është drejt “Stamford Bridge”, me Çepçugov që i ka uruar fat të mbarë mikut të tij në mediat sociale. Portieri ka uruar Golovin, por nuk dihet nëse duhet të merret për bazë postimi i tij në rrjetet sociale, teksa “Tuttosport” ka deklaruar se edhe Monaco është interesuar për fantazistin.

Reali kërkon mbrojtësin e Tottenhamit

Real Madridi po mendon të bëjë pazar në Premier Ligë. Sipas “The Sun” klubi i Florentino Perez do të synojë blerjen e mbrojtësit të djathtë të Tottenhamit, Kieran Tripper, i cili spikati me fanellën e Anglisë në Kupën e Botës 2018, përfshi golin me goditje dënimi në gjysmëfinalen ndaj Kroacisë. Tottenhami pretendon të paktën 50 milionë euro për futbollistin e lindur në vitin 1990 dhe kjo shifër ka trembur disi Realin, që sapo ka shpenzuar 30 milionë euro për të marrë mbrojtësin e djathtë Alvaro Odriozola, teksa në atë pozicion është edhe Dani Karvahal.

Zbulohet pasardhësi i numrin të fanellës së Ronaldos



Me Kristiano Ronaldon që është transferuar tek Juventusi, numri 7-të i tij i famshëm është i lirë dhe në pritje të një pronari të ri. Ai është një numër legjendar dhe shumë i rëndësishëm për Real Madridin. E kishte Ronaldo, para tij Raul. Gjithsesi, tani mbetet pyetja: kush do ta trashëgojë 7-ën e famshme? “Diario Gol” pretendon se e ka përgjigjen. Gazeta spanjolle raporton se Sergio Ramos ka zbuluar pasardhësin. Ai do të jetë Marko Asensio, talenti spanjoll i destinuar për t’u

bërë një legjendë e Los Blancos. Nuk është sekret se 22-vjeçari është një nga talentet më premtues të Real Madridi. Gjithsesi, për shkak të kompeticionit të madh te Reali, ai sezonin e kaluar është aktivizuar shumicën e rasteve si një zëvendësues nga Zinedin Zidan. Tani që Ronaldo është larguar, Asensio mund të gjejë më tepër minuta, gjithashtu, mendohet se Lopetegui është një mbështetës i lojtarit.

JURGEN KLOPP PRANON GABIMIN

Ku e dija unë që bota do të ndryshonte kaq shumë



Kur Manchester Junajtedi shpenzoi 108 milionë euro për të blerë Pol Pogban nga Juventusi, Jurgen Klopp nuk e fshehu mendimin e tij. “Nëse blen një lojtar për 108 milionë euro dhe ai vritet, atëherë çdo gjë shkon dëm. Ditën kur futbollit të jetë kështu, nuk është më një punë, pasi loja nuk luhet vetëm. Klubet e tjera mund të shpenzojnë shuma të mëdha parash për të

mbledhur lojtarë të mirë. Unë dua ta bëj ndryshe. Do ta bëja ndryshe edhe nëse do të shpenzoja ato para”, tha Klopp pas transferimit të Pogbas te Junajted. Por, mesa duket ai ka ndryshuar mendim, pas blerjeve të Van Dijk për 80 milionë euro dhe Alisson për 73 milionë euro në një hark kohor prej gjashtë muajsh. “A kam ndryshuar mendim? Po. Është më mirë të ndryshosh mendim sesa mos të kesh fare. Nuk e imagjinoja që bota do të ndryshonte në këtë mënyrë. 100 milionë euro ka qenë një shifër e çmendur, por bota ka ndryshuar. Të përmirësosh një skuadër të tillë duhen para. Deri tani kemi marrë lojtarët e duhur. Ashtu siç Manchester Junajtedit nuk i intereson se çfarë thashë unë para dy vitesh, as mua nuk më intereson se çfarë thonë të tjerët”, deklaroi trajneri i Liverpoolit.



Kovaç lavdëron Sançesin

Trajneri i Bajern Muniht, Niko Kovaç, ka përgëzuar Renato Sançesin për paraqitjen e tij me kampionët e Gjermanisë në fitoren 3-1 me përmbysje ndaj Paris Sen-Zhermenin në miqësore. Sançes ka vuajtur shumë në gjetjen e formës gjatë dy sezoneve që kartoni i tij ka qenë pronë e Bajernit, që pas paraqitjes së shkëlqyer në “Euro 2016”. “Jam shumë i kënaqur për Renaton, që nuk ka kaluar një periudhë të mirë këto në Muniht, – tha Kovaç. “Por unë e pashë që nga dita e parë e punës. Ai është një futbollist shumë cilësor dhe po shkrin akullin ku ndodhej. Pak e nga pak po tregon vlerat e tij. Nuk është më i ngrirë. Nëse ai ka besimin e mjaftueshëm në vete, unë mendoj se ai mund të tregojë atë që është në gjendje të bëjë. Çdo futbollist ka nevojë për besim. Goli i tij ndaj Parisit ishte diçka që e kisha parë disa herë në stërvitje këto ditë”, deklaroi Kovaç, që la të nënkuptohet se sivjet mesfushori portugez nuk do të huazohet.

Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi tha se Policia e Kosovës nuk ka kontroll të kufirit me Serbinë në fshatin Karaçevë për shkak të një urdhërese të komandantit të KFOR-it të vitit 2014. Ai tha se KFOR-it mendon se pjesa kufitare në fshatin Karaçevë të Kamenicës është ende nën juridiksionin e Serbisë

SHQETËSIM I BANORËVE TË KARAÇEVËS

KFOR-i LË NË SERBI PRONAT



Banorët e fshatit Karaçevë në Komunën e Kamenicës janë ankuar lidhur me shënjimtimet e vijës kufitare nga ana e KFOR-it. Përmes një shkrimi në Facebook, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi ka shprehur shqetësimin lidhur me pronat e qytetarëve.

“Sot në Karaçevë të komunës së Dardanës banorët po ankohen se KFOR-i ka vendosur arbitrarisht vijë kufitare duke i lënë në Serbi pronat e tyre. Banorët e Karaçevës protestojnë që prej vitit 1999, kur KFOR-i e vendosi atë kufi të padrejtë. Është koha që ankesat e tyre të dëgjohen seriozisht dhe të merren masa”, shkroi Kurteshi.

Ai këtë ngjarje e krahasoi me situatën në demarkacionin me Malin e Zi dhe me Mitrovicën.

“Pikërisht sot, kur u mbushën

katër muaj nga demarkacioni i padrejtë me Malin e Zi, dhe kur po ndërtohet muri që po ndan Mitrovicën. Ku janë qeveritarët e Kosovës kur duhet me i mbrojt tokat tona dhe kufirin? Ia kanë rritë rrogat vetes, po merren me tendera, po lëshojnë pe në negociata me Serbinë, por kur vjen puna për ta ndihmuar popullin dhe për ta mbrojtur atdheun, qeveritarët fshihen dhe nuk guxojnë as të flasin”, shtoi ai.

Ai tha se “nëse vazhdojnë kështu, duke e falë territorin e Kosovës në Rugovë, në veri, e tash edhe në lindje, në Karaçevë, vërtet do të na detyrojnë të bashkohemi me popullin në demonstrata”.

Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi tha se Policia e Kosovës nuk ka kontroll të kufirit me Serbinë në fshatin Karaçevë për shkak të një urdhërese të komandantit të KFOR-it të vitit 2014. Ai tha se KFOR-it mendon se pjesa kufitare në fshatin Karaçevë të Kamenicës është ende nën juridiksionin e Serbisë.

“Kjo çështje Lidhet ngushtë me sovranitetin e Republikës së Kosovës. Kjo mbetet e pazgjidhur dhe këtë e kam trashëguar. Kjo çështje do të marrë përkushtimin tim të veçantë për zgjidhjen e saj. Përgjegjësia për mbikëqyrjen është ende nën mandatin e KFOR-it që nuk e ka dorëzuar këtë tek

policia e Kosovës, siç e ka dorëzuar tek pjesët e tjera të kufirit me Shqipërinë, Malin e Zi. KFOR mendon që vija kufitare tek fshati Karaçevë është nën juridiksionin e Serbisë. Pavarësisht kësaj Policia e Kosovës është e pranishme në atë pjesë dhe kontrollon kufirin. Vetëm tek tri fshatra që është Karaçevë nuk mund të jenë të pranishme për shkak të urdhëresës së komandantit të KFORIT të vitit 2014”.

Këto komente Gashi i bëri në një nga seancat e fundit të Kuvendit të Kosovës lidhur me pyetjen e Avdullah Hotit ku parashtrori shqetësimet e qytetarëve të kësaj ane.



Serbia po kërkon demarkacionin me Kosovën

Ministri serb i Mbrojtjes, Aleksandar Vulin, ka thënë se për Serbinë një zgjidhje kompromisi me Kosovën është “demarkacioni dhe ndalimi i shtrirjes së Shqipërisë së Madhe”. Vulin, në një intervistë për mediumin kontrovers serb “Kurir”, ka thënë se pret që Kosova t’i vazhdojë provokimet dhe përpjekjet për të stopuar dialogun. “Ata e dinë se negociatat me [Aleksandar] Vuçiqin nuk janë të mira për ta, dhe këtë e pranojnë me vështirësi”, ka thënë Vulin, transmeton Koha.net. Në lidhje me vrasjen e politikanit serb në Kosovë, Oliver Ivanović, ai tha se “Prishtinës dhe një pjesë të madhe të komunitetit ndërkombëtar po u konvenon që të mos arrihet deri tek zgjidhja” e rastit.

Avni Mazrreku, profesor i të Drejtës Evropiane, thotë se Serbia do ta ketë vështirë që të bisedojë për kufirin me Kosovën, ngase vijën kufitare e njeh si një vijë kufitare administrative, përdërisa për Kosovën ky është kufi ndërshtetëror.

“E para çka duhet me u zgjidh midis dy vendeve, Serbisë dhe Kosovës, është pozicionimi i qartë se si kualifikohet kjo vijë kufitare. Pavarësisht që ka pasur një marrëveshje të ndërmjetësuar nga ana e Bashkimit Evropian për menaxhimin e integruar të kufirit, kjo më tepër ka shkuar në një kontekst të themi teknik të organizimit të qarkullimit të ndërsjellë të njerëzve dhe mallrave midis këtyre dy shteteve dhe nuk e ka zgjidhur këtë problem politik, të hapur midis këtyre dy shteteve”, tha Mazrreku në një intervistë për Ekonomia Online.

Punojnë në institucione, edhe marrin ndihma sociale!

Të punësuarit në Kosovë nuk mjaftohen vetëm me punën e tyre, por ata po presin edhe në radhët e të varfërve vetëm që të përfitojnë ndihma sociale nga shteti. 788 persona në marrëdhënie pune kanë përfituar kundërligjshëm ndihma sociale në vlerën e 71 mijë e 977 eurove nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) vitin e kaluar, shkruan gazeta “Zëri”.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është në dijeni se e ka dëmtuar buxhetin e shtetit mijëra euro, duke paguar

kundërligjshëm ndihma sociale për personat e punësuar.

Por, në këtë institucion nuk posedojnë shifra konkrete të personave që i kanë larguar nga listat e përfitimit, ashtu siç janë bërë publike dëmet mijëra euroshë të buxhetit nga pagesat e gabuara.

Kjo ministri nuk ka treguar për numrin e personave të cilët janë larguar nga listat e shfrytëzimit të ndihmave sociale.

Në përgjigjen me shkrim të MPMS-së thuhet se çdo muaj listat e përfituesve nga



skemat e ndryshme që paguhen nga shteti krahasohen me të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Trustit.

AKSION NË KULMIN E SEZONIT TURISTIK

BLLOKOHEN 11 HOTELE NË JUG TË SHQIPËRISË

Drejtorja e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor është duke ushtruar kontrolle të detajuara verifikimi, në subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Sarandë, Ksamil, Himarë, Dhërmi etj., me qëllim reduktimin e informalitetit dhe garantimin e mbarëvajtjes së sezonit turistik. Gjatë prezencës së këtyre strukturave hetimore është konstatuar se ka ende tatimpagues, të cilët ushtrojnë aktivitet të peregjistruar apo që nuk lëshojnë kupon tatimor për çdo shitje.

Referuar të dhënave të kësaj drejtorie, si rezultat i kontrolleve të ushtruara, u morën masat si më poshtë vijojnë:

Për subjektin Hirakli Marku, me vendndodhje Ksamil, penalizim për moslëshimin e kuponit tatimor për herë të dytë dhe bllokim i ushtrimit të aktivitetit për 30 ditë kalendarike. Për subjektin Mikelo Ahmeti, me vendndodhje Ksamil, hotel i peregjistruar në organet tatimore, bllokim deri në regjistrimin si subjekt me TVSH. Për subjektin Shelege Veliaj, me vendndodhje Sarandë, penalizim për moslëshimin e kuponit tatimor për herë të dytë dhe bllokim i ushtrimit të aktivitetit për 30 ditë kalendarike. Për subjektin Enver Fataj, me vendndodhje Ksamil, hotel i peregjistruar në organet tati-

more, bllokim deri në regjistrimin si subjekt me TVSH. Për subjektin Xhimi Sakaj, me vendndodhje Ksamil, hotel i peregjistruar në organet tatimore, bllokim deri në regjistrimin si subjekt me TVSH. Për subjektin Panajot Beleri, me vendndodhje Himarë, hotel i peregjistruar në organet tatimore, bllokim deri në regjistrimin si subjekt me TVSH. Për subjektin Fatmir Kodhelaj, me vendndodhje Ksamil, hotel i peregjistruar në organet tatimore, bllokim deri në regjistrimin si subjekt me TVSH. Për subjektin Rolando Dhima, vendndodhja Himarë, hotel i peregjistruar në organet tatimore, bl-



lokim deri në regjistrimin si subjekt me TVSH. Për subjektin Marie Kokaveshi, vendndodhja Potam, hotel i peregjistruar në organet tatimore, bllokim deri në regjistrimin si subjekt me TVSH. Për subjektin Spiridhula Dhimaleksi, vendndodhja Himarë, hotel i peregjistruar në organet tatimore, bllokim deri në regjistrimin si subjekt me TVSH. Për subjektin

Roland Braho, vendndodhja Sarandë, hotel i peregjistruar në organet tatimore, bllokim deri në regjistrimin si subjekt me TVSH.

Drejtorja e Hetimit Tatimor në DPT, tërheq vëmendjen e tatimpaguesve që operojnë në zonat turistike të respektojnë detyrimet ligjore, për të siguruar një ecure pozitive të sezonit veror, si për turistët vendas, ashtu edhe për ata të huaj.

Këshilltari i madh i diplomacisë amerikane flet për Putinin, rendin e ri botëror—dhe domethënia e Trump. Artikull i Edward Luce, i përmbledhur

HENRY KISSINGER: GJENDEMI NË NJË SITUATË SHUMË, SHUMË TË KEQE



Nuk është vështirë të bindësh Henry Kissinger'in për t'u takuar për drekë. Edhe pse është 95 vjeçar, dhe lëviz ngadalë, këshilltari i madh i diplomacisë amerikane do të flas. Ai ndërrohet aeroplanët për t'u takuar me liderët si Vladimir Putin dhe Xi Jinping të Kinës me po aq zell si kur luante lojën globale të shahut si maestro i Richard Nixon. Ai ka qejf të jetë para gjërave.

Ta bindësh që të thotë çfarë mendon në të vërtetë është një çështje tjetër. Për qartësinë gjeopolitike, Henry Kissinger është ajo çfarë Alan Greenspan ishte për komunikimin monetar—një orakull thellësia e të cilit krahasohet vetëm me jodeshifrueshmërinë e tij. Është misioni im ta shpallë jashtë zonës së komfortit. Dua të di se çfarë mendon ai për Donald Trump'in.

Koha është perfekte. Ne po drekojmë pasi Trump takoi Putin'in në Helsinki—një samit për të cilin establishmenti amerikan mendon se do të kujtohet si turp i diplomacisë amerikane. Trump bëri të pa-

menduarën duke përqaftuar protestimet e pafajësisë së Putin'it mbi sabotimin elektoral e duke mos i besuar fjalës së Inteligjencës amerikane. Sot më vonë, Trump në mënyrë jo të bindshme do të përpiqet të çbëjë atë që tha në Helsinki duke insistuar se kishte dashur të thotë "wouldn't" në vend të "would". Por është shumë vonë për këtë. New York Daily News ka lajmin bombastik: "Tradhëti e hapur" afër një karikature të Trump duke qëlluar xhaxhin Sam në kokë derisa mban dorën e Putin'it. Nuk ka mundur të ketë moment më të mirë për të ngacmuar Kissinger'in.

Unë arrij pas 100 minutave. Kissinger veç është ulur. "Kërkoj falje nëse nuk zgjohem", thotë Kissinger në dialektin e ashpër gjerman. Ndodhemi në Jubilee, një restorant francez të shtrenjtë, në qosh të apartamentit të Kissinger. Qëllimi im i vetëm është një drekë e mirë. Kur porisisim, Kissinger kontrollon nëse është mysafiri im.

Gjeopolitika rëndon shumë mbi Kissinger'in. Si bashkë-arkitekt i ririmit me Kinën dhe uljes së tensioneve me Bashkimin Sovjetik, Kis-

singer tani sheh një botë në të cilën Kina dhe Rusia janë duke sfiduar rendin botëror të SHBA'së, shpesh në valle me njëra-tjetrën.

Por i madh i diplomacisë së luftës së ftohtë është po aq i interesuar për të ardhmen sa edhe për të kaluarën. Këtë vit Kissinger shkroi një artikull tmerrues në 'The Atlantic Monthly', ku krahasoi njerëzimin sot me Incas para arritjes së lisë dhe spanjollëve. Ai bëri thirrje për krijimin e një komisioni presidencial mbi Inteligjencën artificiale. "Nëse nuk fillojmë këtë përpjekje shpejtë, do të shohim se kemi filluar vonë, konkludoi ai.

Çfarë mendoi Kissinger për Samitin e Helsinkit?

"Ishte një takim që duhet të ndodhte. E kam promovuar për shumë vite. Është zhytur nga çështjet e brendshme amerikane. Sigurisht është një mundësi e humbur. Por them se njëri duhet të kthehet te diçka. Shiko Sirinë dhe Ukrainën. Është karakteristike unike e Rusisë që trazirat në çdo vend të botës e afektojnë atë, i jep një mundësi dhe gjithashtu perceptohet si kërcënim nga ajo. Ato trazi-

ra do të vazhdojnë. Kam frikë përshkallëzohen."

Kissinger fillon me një diskutim për tolerancën "gati mistike" për vuajtjen. Poenta e tij kryesore është se në vitet para se Putin të aneksonte Krimenë, Perëndimi supozoi gabimisht se Rusia do të adoptojë rregullat e Perëndimit. NATO keqlexoi nevojën e madhe të Rusisë për respekt. "Gabimi që ka bërë NATO është të mendojë se ka një lloj evolucioni historik që do të marshojë nëpër Euroazi dhe nuk e ka kuptuar se diku në atë marsh do të has në diçka shumë ndryshe nga një enitet Ëestphalian (ideja perëndimore për shtetin). Dhe për Rusinë kjo është një sfidë për identitetin e saj." A do të thuash se kemi provokuar Putin'in, e pyes.

"Nuk mendoj se Putin është një karakter si Hitleri" përgjigjet Kissinger. "Ai del nga Dostoyevski."

Në lidhje me Trumpin:

"Nuk dua të flas për Trump'in sepse dikur duhet ta bëj në një mënyrë më koherente." Por ju jeni koherent, protestoj unë. Ju lutem mos ndaloni. "Mendoj se Trump mund të jetë nga ato figurat në hi-

stori që paraqitet kohë pas kohe për të shënuar fundin e një epoke dhe që ta detyrojë atë të heq dorë nga shtirjet e vjetra. Jodomsdoshmërisht do të thotë se ai e di këtë, ose se po konsideron ndonjë alternativë të madhe. Mund të jetë thjesht aksident."

Kissinger gjithashtu paralajmëron se një Atlantik i ndarë do ta shndërronte Europën në shtojcë të Euroazisë që do të ishte nën mëshirën e Kinës që do të rikthejë rolin e saj historik si Mbretëria e Mesme dhe të jetë "këshilluesje kryesore e njerëzimit". Amerika në anën tjetër, do të shndërrohet në një ishull gjeopolitik, e rrethuar nga dy oqeanë gjigande dhe pa rend të bazuar në rregulla që të mbahet.

"Mendoj se jemi në një situatë shumë, shumë të keqe", thotë Kissinger [Igazetametro.net](http://gazetametro.net)

Publicitet



KOMUNA E KARPOSHIT
SEKTORI PËR VEPRIMTARI ME INTERES PUBLIK
DEPARTAMENTI PËR KULTURË DHE SPORT



Në bazë të nenit 22, paragrafi 1 pika 6 e Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/2002), kreu II Aktivitetet projektuese, pika 8 mbështetje financiare për projekte sportive rekreative dhe shëndetësore për subjektet fizike dhe juridike nga Komuna e Karposhit ("Fleta zyrtare e Komunës së Karposhit nr. 18/2017 dhe 06/2018), ndërsa në lidhje me nenin 2 të Vendimit për publikim të shpalljes për mbështetje financiare të projekteve sportive rekreative dhe shëndetësore për subjektet fizike dhe juridike të Komunës së Karposhit nr. 09-5838/4 të datës 12.07.2018 ("Fleta zyrtare e Komunës së Karposhit" nr. 07/2018), Komuna e Karposhit publikon

SHPALLJE

Për mbështetje financiare për projekte sportive rekreative dhe shëndetësore për subjektet fizike dhe juridike nga Komuna e Karposhit

I. Të drejtë për paraqitje

Të drejtë për paraqitje kanë të gjitha subjektet e interesuara fizike dhe juridike (me kryerje të veprimtarisë sport, ndërsa të mos jenë klube sportive) nga rajoni i Komunës së Karposhit, të cilat do të parashtrajnë projekte sportive rekreative dhe shëndetësore, ndërsa të cilët me aktualitetin, atraktivitetin, rëndësinë dhe kualitetin e tyre kontribuojnë për promovim të komunës.

dhe subjektet juridike të regjistruara në Komunën e Karposhit për veprimtari që përfshijnë veprimtarinë e kulturës në të gjitha sferat së paku 3 (tre) vjet, ndërsa të cilët me programet dhe aktivitetet e tyre kontribuojnë në zhvillimin e kulturës në komunë dhe më gjerë.

Konkursi për projekte nga sferat: veprimtari botuese, folklor, veprimtari muzikore-skenike dhe veprimtari të ekspozitave të artit figurativ.

Subjektet fizike dhe juridike obligohen në kërkesë të theksojnë shkaqet, arsyet, rezultatet e pritshme dhe qëllimin se për çka i kërkojnë mjetet.

II. Kriteret për ndarje të mbështetjes financiare për projektet

Kriteret e përgjithshme

- Kualiteti dhe rëndësia e projektit
- Popullarizimi
- Promovimi
- Masiviteti
- Afirmimi dhe edukimi i të rinjve për sport dhe shëndet

Kriteret e posaçme

- Manifestimi të jetë me interes të posaçëm për Komunën e Karposhit
- Qëllimi i manifestimit të jetë zhvillimi i edukimit sportiv edukativ arsimor dhe shëndet,
- Projektet të kontribuojnë në zhvillimin e të rinjve për tu marr me sport për të gjithë
- Projekti të sigurojë nxitje të manifestimeve sportive për personat me nevojë të posaçme.

III. Dokumentet e nevojshme dhe kushtet për pjesëmarrje

Subjektet fizike:

- Letërnjoftim,
- Projekt i përpunuar dhe
- Plani financiar i projektit.

Subjektet juridike:

- Projekti i përpunuar,
- Plani financiar i projektit
- Gjendja aktuale e dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj.

IV. Shuma e mbështetjes financiare

Varësisht nga dokumentet e parashtruara, Komuna e Karposhit shumën e mbështetjes financiare do ta ndajë në kuadër të mundësive të saj.

V. Mënyra e paraqitjes

Dokumentet mund të parashtrihen përmes postës në rr. Radika nr. 9 – Shkup ose në Arkivin e Komunës së Karposhit, baraka nr. 2 me shenjë "Mos hap" dhe me shenjë "Mbështetje financiare për projekte sportive rekreative dhe shëndetësore për subjektet fizike dhe juridike të Komunës së Karposhit", për Komisionin për sport pranë Këshillit të Komunës së Karposhit.

VI. Afati për parashtrimin të dokumenteve

Shpallja nuk është e kufizuar në aspekt kohor dhe vlen deri në harxhimin e mjeteve financiare, por projektet të realizohen më së voni deri më 31.12.2018.

Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

KOMUNA E KARPOSHIT
DEPARTAMENTI PËR KULTURË DHE SPORT
Patrik Popovski



Kur rusët nuk e kuptuan se po pushtoheshin

Nga arkivat e Moskës kanë dalë dokumentet origjinale të cilat përligjin atë që historianët e dyshonin prej kohësh: sulmi i Hitlerit i zuri rusët në befasi sepse deri në fund, ata menduan se ishte i gjithi një bluf! Në orët vendimtare përpara mësymjes gjermane të 22 qershorit 1941, të njohur ndryshe si operacioni Barbarosa, komanda e lartë sovjetike i kishte dërguar trupave mesazhe kontradiktore.

Ushtarët urdhëroheshin të qëndronin në gatishmëri, por të mos i përgjigjeshin provokimeve. Edhe kur tre milionë gjermanë sulmuan në 04:00 të mëngjesit përgjatë gjithë vijës së frontit perëndimor me 3500 autobllinda dhe 600.000 makina të tjera, rusët nuk reagoan nga frika se kështu mund të kundërshtonin vullnetin e Stalinit.

Kundërsulmi do të niste vetëm në 07:15, pra mbi tre orë me vonë, çka u kishte lejuar nazistëve të fitonin ndjeshëm epërsi. Dokumentet u publikuan në 77-vjetorin e këtyre ngjarjeve. Ato tregojnë se edhe kur ishte dhënë urdhri i goditjes, trupave u kërkohej të hidheshin mbi armikun dhe ta shkatërronin, por pa e kaluar kufirin.

Deri në ato momente rusët kishin marrë sakaq goditje të forta, me 1200 avionë të shkatërruar përpara se të ngriheshin në fluturim. Stalini deri në çastet e fundit duket kishte qenë i bindur se ky ishte një lloj provokimi i Gjermanisë për të hapur negociatën me të.

SI I MORËN ARMËT E SKËNDERBEUT AUSTRIAKËT



Në vitin 1605, kështjella "Ambrar" u ble nga perandori i Austrisë dhe armët iu lanë atij. Në vitin 1806, reliket u mbartën në Vjenë dhe në vitin 1888 u kaluan në ndërtesën e re të Muzeumit të Vjenës, ku ndodhen edhe sot

Ato janë të vetmet objekte origjinale të heroit tonë kombëtar, që ruhen deri më sot dhe ato ruhen në Austri në Muzenë e Vjenës. Historia e tyre lidhet me jehonën e emrit dhe famës së Skënderbeut në Evropë në atë kohë e më pas. Në vitin 1567, djali i dytë i perandorit të Austrisë Ferdinandi rindërtoi kështjellën "Ambrar" në kryeqytetin e Tirolit, Innsbruck dhe u mor me mbledhjen e sendeve artistike me vlerë e të relikeve.

Sekretari i tij Shrenke mblodhi kryesisht armë dhe i

ruajti në kështjellën "Ambrar". Ai u shkroi letër personalitetëve të shquara të kohës dhe trashëgimtarëve të atyre që kishin vdekur, që t'i dërgonin veshje luftarake, armë, mjete luftarake, piktura e biografi, sepse do t'i ekspozonte në armëtoren e tij në Kështjellën "Ambrar".

Objektet e grumbulluara, Shrenkeja i sistemoi dhe i inventarizoi gjatë viteve 1585, 1593, 1596 dhe në vitin 1601 botoi në latinisht veprën: "Figura krejt të vërteta të perandorëve august, të mbretërve e shumë të ndriturve arqidukë, princa-

ve gjithashtu të kontëve, baronëve, fisnikëve dhe përshkrimet të bëmave të tyre, armët e të cilëve ndodhen në armëtoren e kështjellës "Ambrar". Kjo veper bëri të mundur që të njihet përkatësia e armëve dhe historia e çuarjes së tyre atje. Në vitin 1605, kështjella "Ambrar" u ble nga perandori i Austrisë dhe armët iu lanë atij. Në vitin 1806, reliket u mbartën në Vjenë dhe në vitin 1888 u kaluan në ndërtesën e re të Muzeumit të Vjenës, ku ndodhen edhe sot.

Armët e Skënderbeut i janë

dorëzuar Ferdinandit ndërmjet viteve 1588-1593 me anën e Dukës së Urbinjos dhe atij të Areskotit. Në inventarin e vitit 1596 të Shrenker, me numër 71 është shënuar përkrenarja dhe me numër 92 dhe 345 dy shpatat. Në veprën e Shrenken të botuar në vitin 1601, paraqitet dhe një gravurë e Skënderbeut në pozicion në këmbë, duke mbajtur në dorën e djathtë shpatën (nr 345) dhe pranë këmbëve përkrenaren. Armët e vizatuara të gravurës ngjasojnë me ato origjinale të Muzeumit të Vjenës.

URDHRI I NAZISTËVE NË 1943

PËR ÇDO GJERMAN TË VRARË, TË VAREN 10 SHQIPTARË

Sipas këtij urdhri të divizionit I alpin, për çdo ushtar gjerman të vrarë apo plagosur duhej të pushtoheshin ose vareshin 10 shqiptarë. Një urdhër i komandës gjermane që tregon qartë natyrën e pushtimit si edhe masat që duheshin marrë kundër popullsisë shqiptare, nëse partizanët sulmonin ushtrinë gjermane. Urdhri daton 17 shtator 1943. Po ashtu, në çdo kamion ushtarak, me të cilin transportoheshin furnizimet e ushtrisë, duhej të merreshin edhe 3-4 shqiptarë, të cilët duhet të ekzekutoheshin menjëherë në vendin e pritës ndaj kamionit. Duhet të nënvizohet fakti që, ky urdhër është lë-



shuar vetëm 8 ditë pas pushtimit. Më poshtë përkthimi i plotë i dokumentit, që është nxjerrë nga

arkivi ushtarak gjerman në Freiburg:

"Divizioni I alpin

IC (oficeri i shtabit për zbulimin)

Vendkomanda e divizionit,

me 17.9.1943

Drejtuar: kapitenit Von Eyb, Korçë

Gjenerali Stettner ka urdhëruar: për çdo ushtar gjerman të vrarë ose plagosur në ndonjë pritë të organizuar nga banditët; të pushtohen ose varen në vendin e pritës 10 civilë. Në çdo kamion me furnizime duhet të transportohen edhe 3-4 civilë, të cilët duhet të pushtohen menjëherë nëse kamioni sulmohet. Përvoja të kësaj natyre duhet të raportohen në vazhdimësi të IC i divizionit.

Për komandantin e divizionit Oficeri i parë i shtabit Toger dhe IC.

KOMANDANTI I LUFTËRAVE TË HUMBURA

Duke hequr dorë nga funksionet e tij në Kubë, Che-ja kishte qëllim që të ndizte "dy, tri Vietname" në Botën e Tretë. Aventura kongolozë ju shndërrua në makth, ajo në Bolivi përfundoi me vdekjen e tij

Më 14 mars 1965, Ernesto Guevara, i mbiquajtur Che, zbriti nga avioni që e sjell në Kubë nga Praga, pas një misioni të gjatë diplomatik nëpër botë, i mbyllur me një bisedë me Fidel Castro për rreth 40 orë në Cojimar, në afërsitë e Havanës. Qysh nga ai moment Che-ja nuk do të shihet më në publik. Fillojnë të qarkullojnë zëra të çuditshëm. Është arratisur? Është eliminuar? Është shtruar në një spital për të padëshiruarit? Grindjet e tij me burokratët kubanezë janë të shpeshta: thekson se një ekonomi socialiste duhet të jetë e privuar nga kritere përfitimi. Veç të tjerash, diskutimi që ka mbajtur në Algjer më 24 shkurt është një akuzë e vërtetë ndaj sovjetikëve, të cilët i akuzon se po "tregtojnë mbështetjen e tyre ndaj revolucioneve popullore në favor të një politike të jashtme egoiste, larg nga objektivat e mëdha të klasës punëtore". Vetëm dy vite më pas do të hidhet dritë mbi zhdukjen e tij. Në fakt, Fidel nuk e ka shtypur fizikisht kompaneron e tij, thjesht i ka besuar, do të thotë vite më pas, "misioni të tjera që duhej të pasuronin përvojën e tij guerilase". Por Che Guevara është nisur vullnetarisht apo është sakrifikuar për motive politike? Po sikur të ketë qenë viktimë armiqësishë personale? Askush nuk ushqen dyshime lidhur me faktin se prania e tij e bezdis aq shumë Fidelin, sa që nga viti 1959 e ka bërë ambasadorin e tij në të gjithë kontinentet. Letra e Che-së, e lexuar në publik në tetorin e 1965, e liron aq shumë lider maximo nga çdo përgjegjësi sa që disa nuk hezitojnë të mendojnë akoma se tërheqja brutale e Guevara nga jeta politike kubaneze ka ardhur pikërisht nga Fidel.

Fakti është Che-ja, admirues i madh i Maos dhe i të ndjerit Stalin ("Ai që nuk ka lexuar 14 vëllimet e shkruara nga Stalini nuk mund ta deklarojë veten krejtësisht komunist", deklaroi ai), nuk është kënaqur me teorinë e "bashkekzistencës paqësore". Disa vite më parë kishte botuar një traktat, Lufta guerilase, në të cilën premonte të eksporton-



te përvojën e revolucionit kubanez si metotë të marrjes së pushtetit në Botën e Tretë. Ai uronte krijimin e ushtrive popullore në çdo pikë të nxehtë të globit, me qëllim që të shumëfishoheshin frontet për mundjen e imperializmit yankee dhe "të ndizeshin, dy, tre, disa Vietname". Njeri i aksionit më shumë se pushtetit (një "luftëtar i vogël", siç ka qejf ta quajmë), padyshim që e ka kapur fluturimthi rastin që i është ofruar. E gjitha kjo për t'u hedhur në një aventurë që i mundëson të vërë në praktikë teorinë e tij për luftën e armatosur dhe në të njëjtën kohë t'i bëjë një shërbim Fidel Castro, duke e zgjeruar influencën e Kubës në Botën e Tretë. Më 22 maj 1965, Guevara ndahet nga bashkëpunëtorët e tij të Ministrisë së Industrisë. Në fillim të prillit, me mjekrën e rruar, i trokuar nga shërbimet sekrete kubaneze, imbakohet inkonjito për Dar es Salaam, në Tanzani. Objektivi i tij është që t'i bashkëngjitet Ushtrisë Çlirimtare të Kongos për të përmbysur pushtetin "imperialist" që dominon vendin. Më 11 dhjetor të 1964, në një diskutim përpara Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, kishte deklaruar se "të gjithë njerëzit e lirë të botës duhet të përgatiten të hakmerren për krimin e Kongos", domethënë vrasjen e Kryeministrit Patrice Lumumba në janarin e 1961. Sipas Allen Dulles, Drejtorit të Përgjithshëm të CIA-s, Lumumba ishte "një Castro tjetër".

E pavarur nga qershori i 1960, Kongoja po kalonte një periudhë jashtëzakonisht të trazuar. Me ndihmën e Shteteve të Bashkuara, kryeministri i ri Moïse Ciombé donte ta shtypte rebelimin, që i frymëzuar nga lëvizje progresiste dhe komuniste, kishte ndezur vendin. Che-ja mendonte për një Sierra Maestra të re që duke filluar nga Kongo të arrinte të ndizte zjarr të gjithë Afrikën. Në vend ju bashkua një grup luftëtarësh kubanezë: të gjithë me lëkurë të errët, për të sensibilizuar popullsinë ndaj kauzës. Besnik ndaj parimeve të tij, Guevara zgjodhi që të përzihej në mjedisin lokal. I armatosur me një fjalor të gjuhës swahili, mori emrin Tatu, që do të thotë "tre" (për faktin se ai është numri 3 i hierarkisë pas dy zekëve). Një grup i vogël i parë, në të cilin bën pjesë Tatu, lë Dar es Salaam drejt Kongos. Më 22 prill arrin në Kigoma, afër liqenit Tanganica, të cilin e kalojnë me një farë vështresie për të arritur Kibamba, vend i zgjedhur si bazë. Më pas vijën edhe nja 100 guerrillas kubanezë. Guevara ndeshet menjëherë me realitetin kongolez. Ushqimi është i pakët, moçalishitet dhe sëmundjet veneriane, të marra në shtëpitë e mbyllura të Kigoma, u shkaktojnë jo pak probleme njerëzve të tij. Goditja më e rëndë është e natyrës kulturore: animizmi, poligamia, supersticionet janë pjesë e kulturës së këtyre popullsive. Atëherë kur kupton se kongolezët pinë dawa, një

"pije magjike" e konsideruar në gjendje që të bëjë të paprekshëm ndaj plumbave dhe se ushtarët refuzojnë prej supersticionit që të futen në llogore, Guevara mëson se vizioni i tij për botën është shumë larg nga ai i vendasve.

Ai zbulon se ekzistojnë edhe kontraste të shumta midis guerilasve. Midis ruandezëve dhe kongolezëve në radhë të parë, fakt që e bën të vështirë luftën e përbashkët: rivalitetet etnike maskojnë raportet e forcës. Ekzistojnë shumë mosmarrëveshje midis luftëtarëve kongolezë të frontit dhe drejtuesve të tyre që qëndrojnë prapa. Për më tepër, mosmarrëveshjet në gjirin e shtabit të përgjithshëm të rebelimit kongolez bëhen çdo ditë e më të qarta. Pas një muaji e gjysmë, Che-ja e quan ushtrinë çlirimtare një "ushtri parazitësh", e pamundur për t'u stërvitur dhe e paaftë që të punojë. Mungesa e disiplinës është totale. Luftimet e rralla rezultojnë në fund në mospasë të bujshme. Guevara dhe komandanti ruandez Mundandi studiojnë një plan sulmi kundër hidrocentralit të Benders, i ndodhur në lumin Kimbi. Bilanci: 22 të vdekur, prej të cilëve 4 kubanezë, të vrarë në një breshëri artilerie. Sulmi i parashikuar në të njëjtën kohë kundër kazermës së Katenga përfundon me një dështim. Disa kubanezë të demoralizuar tentojnë që të dezertojnë. Një sjellje që nuk ndihmon të hiqet dyshimi i ushqyer nga kongolezët për ta.

Kësaj i shtohet edhe fati i keq: shefi i shtabit të përgjithshëm, Mitu-didi, sapo ka arritur që ta riorganizojë kampin kryesor për të vazhduar aksionin kur mbytet duke kaluar liqenin. Më 7 korrik, pas disa javësh mëdyshjeje, Laurent Desiré Kabila, një prej krerëve të gueriljes, në atë kohë 27 vjeçar, i shoqëruar nga Masengho, arrin në Kibamba dhe takohet me Che-në. Ky i shpreh dëshirën për ta çuar në front, gjë që nuk i është lejuar akoma nga kongolezët. Por Kabila nisët 5 ditë më vonë për Tanzani pa një vendim dhe baza e Che-së gjendet sërish në një gjendje gjysmë letargjie. Tashmë Tatu është i lodhur. Ndjehet "më shumë në rolin e një student që ka fituar një bursë studimi sesa si luftëtar". Aksioni i vetëm i rëndësishëm ndodh më 11 shtator, kur merr pjesë me një automatik në dorë në sulmin kundër një karvani kundërshtar. Ama, edhe kësaj radhe, një ruandez nuk i respekton urdhrat e marra dhe nga kjo lind një rrëmujë e cila përfundon në dështim.

Tre muajt e fundit të qëndrimit përfundojnë në një rënie të ngadaltë. Në shtator, presidenti tanzanian Julius Nyerere, pavarësisht se aleat i Kubës, e braktis Che-në, duke i pezulluar autorizimin për të kaluar armët nëpër vendin e tij. Nga fundi i muajit, qeveria kongoleze nis një kundërofensivë, duke u premtuar faljen e jetës të gjithë atyre guerilasve që i dorëzohen asaj. Pasi Moïse Ciombé është dorëhequr nga funksionet e tij, për shumë kongolezë mungojnë arsytet që justifikonin luftën. Shpërbërja e Ushtrisë Çlirimtare të Kongos ka filluar. Guevara e sheh veten të detyruar që të nisë evakuimin e kubanezëve, të cilët nisen mëngjesin e 21 nëntorit për Kigoma. Është "një spektakël i dhimbshëm, i dhimbshëm dhe pa lavdi", shkruan ai. Importimi i modelit Sierra Maestra në Kongo ka qenë një gabim tragjik. Che Guevara kalon 4 muaj fshehurazi në Dar es Salaam, në ambasadën e Kubës. Tenton që të kuptojë dështimin e tij: "Kam kërkuar që t'u imponoj njerëzve të mi të njëjtën pikëpamje

personale të situatës dhe kam dëshuar". Përpara se të kthehet fshehurazi në Kubë, në korrikun e 1966 kalon 4 muaj në Pragë. Dhe është pikërisht në kryeqytetin çekoslovak që nis të ëndërrojë Bolivinë. Dëshiron të krijojë një qendër formimi guerilasish. Pse Bolivinë? Padyshim pse është limitrofe ndaj 5 "fuqish baruti" të mira, të trazura nga lëvizje të ndryshme revolucionare: Perù, Kili, Paraguaj, Brazil dhe Argjentinë. Për më tepër, situatë në Bolivi, në drejtimin e së cilës ndodhet junta e Gjeneralit Barrientos (demokratikisht e zgjedhur), është e shënuar nga pabarazi të mëdha shoqërore: shtresa të mëdha të popullsisë jetojnë në varfëri. Së fundi, Bolivia numëron 5 milion banorë të grupuar në 1/10 e territorit të vendit. Teorikisht, pika ideale për të tronditur kontinentin latinoamerikan.

Praktikisht, edhe në këtë rast, asgjë nuk do të shkojë sipas planifikimit. Tullac, i rruar dhe me një palë syze të mëdha, Guevara, alias Ramon Benitez, e lë Havanën drejt Moskës më 23 tetor 1966. Në Pragë merr një tren për Vjenë, kalon më pas në Paris, përpara se të imbarkohet për Brazil. Arrin në La Paz, kryeqyteti i Bolivisë, më 3 nëntor me një pasaportë uruguaiane në emër të Adolfo Mena Gonzales. Kështu ribëhet "Ramon". Në një fermë të humbur në brigjet e Rio Nanchahuazù, në juglindje të vendit, ngre kampingun stërvitor. Me të janë 17 kubanezë, të shtuar pak e nga pak nga një grusht bolivianësh e peruanësh: gjithsej 50 njerëz. Si gjithmonë, një optimizëm i madh e kaplon grupin, edhe pse Che-ja vlerëson se do t'u duhen jo më pak se "10 vjet përpara se të përfundojë faza rebeluese". Por problemet nuk mungojnë. Duhet përbaluar klima e xhunglës boliviane, i duhet përshatur një gjeografie armiqësore, të përballohen sëmundje dhe insekte. Grupi i vogël nuk është përshatur me këto kushte ekstreme. Por Che-së i duhet të përballet me probleme politike. Për shkak të një reforme agrare të kohëve të fundit, fshatarët janë më pak të prirur që të ngrihen për shkak të guerilasve. Mosbesues ndaj të huajve, në pjesën më të madhe të rasteve fshatarët qëndrojnë indiferentë. Duhet shtuar edhe se rajoni i zgjedhur është pak i banuar, fakt që e bën të vështirë çdo mbështetje popullore.

Midis "aleatëve", e njëjta muzikë. Guevara përfiton fillimisht mbështetjen e Mario Monje, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste Boliviane (PCB), që i premtion furnizime dhe ndihma. Por, gjithçka përmbysët. Më 31 dhjetor, pas një takimi të zjarrtë me Che-në, Monje i jep fund bashkëpunimit dhe kërkon që të pushtohet lufta. Mbështetja më e rëndësishme i kthen krahët! Praktikisht, Moska nuk ka nevojë për revolucion në Amerikën Latine. Internacionalizmi proletar nuk është më ai i dikurshmi. Kur Jorge Kollé, Sekretar i Dytë i PCB-së, dhe Simon Reyes, drejtues i minatorëve, kthehen nga Havana të



gatshëm që të diskutojnë me Che-në për kushtet e luftës në Bolivi, guerilja rurale tashmë është e shkëputur nga çdo lidhje me qytetin; nisja e luftimeve e bën të pamundur takimin. Përfundimisht, duhet bërë revolucioni pa ilaçe (Che-ja është azmatik), pa furnizime (guerilasit janë detyruar të ushqehen me kafshët e tyre të transportit), pa harta të sakta dhe pa komunikacion, pasi radioja është e paafte që të dërgojë çdo lloj mesazhi. Komunikatat e gueriljes nuk kanë kështu asnjë lloj efekti: Che-ja është i detyruar që t'u drejtohet fshatarëve të rastit.

Aksionet e para në terren nisin në fillimet e 1967. Në shkurt një 20 njerëz nisen për rikonjicion në rajonin veriore, drejt Rio Grande. Aty qëndrojnë dyfishin e kohës së parashikuar, domethënë 48 ditë, duke shkaktuar dyshime dhe lodhje në grup. Mosë Guevara, pa asnjë lidhje me Che-në, ish anëtar i PCB-së, ka arritur gueriljen me 8 rekrutë, por gjërat në vend që të përmirësohen, do të keqësohen. Më 11 mars dy njerëz dezertojnë dhe njëri prej tyre, i burgosur, "shet" shokët e tij. Një i tretë do të ndjekë të njëjtën rrugë dhe do t'i konfirmojë të gjitha informacionet. Më 23 mars, luftimi i parë i vërtetë me një patrullë ushtarake shkakton 7 të vdekur dhe 14 të burgosur në radhët e ushtrisë boliviane. Por gëzimi i Che-së është jetëshkurtër. Ardhja e një grupi prej tre "internacionalistësh", i përbërë nga intelektual i francez Regis Debray, alias Danton, nga argjentina-si Ciro Bustos dhe nga gjermano-argjentina-sja Tamara Bunke, alias Tania, do ta komplikojë më tej detyrën e tij. Xhipsi i gruaz zbulohet me dokumente komprometuese. Pastaj nevojiten të evakohen Regis Debray - që, prej vetë pranimi të tij, nuk ndjehet "i gatshëm për vdekjen" - dhe Ciro Bustos. Rezultati: guerilja ndahet në dy grupe: atë të Joaquín (i identifikuar nga disa si Juan Vitalo Acuna) dhe atë të Che-së, që nuk do ta takohen më kurrë. Debray dhe Bustos arrestohen në shoqërinë e gazetares angleze Roth, e cila kërkon të bëjë scoop. Ndërsa Debray burgoset, Bustos jep emrat e guerillasve, duke denoncuar pranimin e Che-së. Ushtria boliviane pu-

shton kampingun qendror. Edhe pse humbet disa njerëz gjatë pritave, guerilas të ndryshëm vriten gjatë luftimeve, në mënyrë të veçantë Eliseo Reyes, "njeriu më i mirë i gueriljes", sipas Ramon. Për të luftuar gueriljen, ushtria boliviane ka mbledhur 5000 njerëz. Përkrah Che-së, që tani quhet Fernando - kanë mbetur 25 njerëz. Tashmë të shpartalluar, guerilasit spostohen midis maleve në të gjitha drejtimet, në kërkim të ujtit të furnizimeve. Do të përshkojnë rreth 600 kilometra në 6 muaj!

Për një moment duket se po hapet një front i ri: distriktet minerare pagëzohen "Territore të Lira" nga punëtorët, por është thjesht një flakë kashte. Ndërsa punëtorët vendosin që ta mbështesin gueriljen, ushtria pushton instalimet. Më 7 qershor, qeveria boliviane dekreton gjendjen e jashtëzakonshme. Më 24 ndodh "Masakra e San Giovanni": dhjetëra minatorë vriten, 200 dërgohen në kampe pune. Në fillim të korrikut, Ushtria Çlirimtare e Bolivisë (ky është emri i trupës rebele) pushton lokalitetin Samapaita (1700 banorë) dhe momentalisht fiton energji. Por është çështje vetëm e pak ditëve: një dezertor e çon ushtrinë e rregullt në një vendstrehim dhe shumë njerëz vriten në luftime. Më 31 gusht, gjatë një prite në vaun e Puerto Mauricio, kolona Joaquín asgjësohet. Në shtator, qeveria boliviane paraqet foto të gjetura në Nanchahuazù, midis të cilave pasaportat false uruguaiane të Che-së. autoritetet e dinë tani se është ai që drejton operacionet. Guevara mëson nga radio për masakrën e Joaquín. Të shkatërruar, njerëzit e tij janë katandisur deri në atë pikë sa të pinë urinën e tyre. Të gjithë sëmurën. Che-ja vendos të niset drejt veriut, ku përkëdhel idenë e hapjes së një "fronti të dytë". Në fund të shtatorit, pararoja bie në një pritë, që i shkaktonte 9 viktimitë. Revolucionari ka tashmë intuitën se fundi është i afërt. Më 8 tetor, si për ironi të fatit, guerilasit denoncohen nga një fshatar, Pedro Pena, që është frikësuar kur i ka parë. Të ndjekur në kanionin Churo, rrethohen nga 300 ushtarë, të inkuadruar nga "këshilltarë" amerikanë.

Guevara shënon: "Nëqoftëse luftimi ndodh pas orës 15:00 dhe në interesin tonë sa më vonë të jetë e mundur, shanset mund të jenë të mëdha pasi nata është aleati natyral i guerillasve". Por luftimi nis në orën 13 00. Për t'u shpëtuar rejnshërsve të Regjimentit "Manchego", Che-ja ndan grupin. Plagoset dhe merr malin i mbështetur nga një prej shokëve të tij, "Willy". Të dy bien në duart e ushtrisë dhe dërgohen në La Higuera, në fshat dy kilometra larg, ku mbyllen në një shkollë. Më 9 tetor, nga mesdita, Guevara vritet me një breshëri automatiku të qëlluar nga ushtari Mario Teran. Trupi i tij, në të cilin identifikohen 9 shenja plumbash, ekspozohet në dhomën mortore e improvizuar në Vallegrande.

Kësaj radhe Che-ja nuk ka mundësi që të investigojë lidhur me humbjen e re. përgatitjet e gueriljes boliviane qenë akoma edhe më të ngutura se ato të aventurës afrikane; pavarësisht një stërvitjeje të ethshme në provincën Pinar, në të cilën Castro kishte asistuar personalisht, nuk ishte zhvilluar asnjë rrjet lidhesh dhe asnjë verifikim serioz nuk ishte bërë në vend. Che-ja i kishte besuar intuititës së tij, ndonjë lidhjeve në vend dhe njerëzve të zakonshëm që e rrethonin. Takticien i mirë, por strateg i keq, ai kishte anashkalluar situatën ndërkombëtare, duke besuar se ndoshta Moska do ta mbështeste, ndërkohë që e kishte braktisur tashmë një herë në Kongo. Pastaj, kishte gjykuar keq situatën lokale, duke mos arritur t'i sensibilizojë banorët. Rebelët nuk kishin arritur të mishëronin pritshtëritë e popullsisë rurale (qenë minatorët dhe jo fshatarët ata që u simpatizuan më shumë me rebelët) dhe ta transformonin gueriljen në luftë masive. Sipas terminologjisë marksiste-leniniste, nuk ekzistonin kushtet për "shpërthimin e revolucionit". Entuziast dhe i paduruar deri sa të kundërshtonte disa prej vetë thënieve të tij, Guevara kishte besuar se një vatër rebelimi mund të shkaktonte revolucionin, në ngjashmëri me sa kishte ndodhur në Kubë (me Castro), në Kinë (me Maon) dhe në Vietnam



Arratia përpara në vitet e fundit mund të shtyjë që të mendohet për një lloj vetëvrasjeje të vetëdijshme. Një vetëvrasje që do t'i përgjigjej dëshirës për të shkatërruar shoqërinë kapitaliste deri në themele. Praktikisht, në mesazhin e tij të fundit të prillit 1967, luftëtari shkruan: "Duhet bërë lufta deri ku e bën armiku: në shtëpinë e tij, në vendet e dëfrimit; duhet bërë totalisht"



Më 22 prill arrin në Kigoma, afër liqenit Tanganica, të cilin e kalojnë me një farë vështirësie për të arritur Kibamba, vend i zgjedhur si bazë. Më pas vijnë edhe nja 100 guerilas kubanezë. Guevara ndeshet menjëherë me realitetin kongolez. Ushqimi është i pakët, moçalishtet dhe sëmundjet veneriane, të marra në shtëpitë e mbyllura të Kigoma, u shkaktojnë jo pak probleme njerëzve të tij. Goditja më e rëndësishme e natyrës kulturore: animizmi, poligamia, supersticionet janë pjesë e kulturës së këtyre popullsisë

(me Gjeneralin Giap). Por as në Kongo, as në Bolivi ai nuk arriti që të qeverisë as zonën më minimale rurale, nga ku të nisej pastaj për të pushtuar qytetet.

Mbetet për t'u kuptuar nëse Guevara synonte që t'i "fitonte" vërtet këto luftëra apo ambicia maksimale e tij ishte thjesht vetëm në bërjen e tyre. Ideologjia e tij personale e kishte shtyrë që të hipotezonte lindjen e "një njeriu të ri" i aftë që të sakrifikohej për kauzën dhe tërheqja pakashumë e detyruar nga çështjet kubaneze sigurisht që e kishte çuar ta pranonte idenë e vdekjes. Arratia përpara në vitet e fundit mund të shtyjë që të mendohet për një lloj vetëvrasjeje të vetëdijshme. Një vetëvrasje që do t'i përgjigjej dëshirës për të shkatërruar shoqërinë kapitaliste deri në themele. Praktikisht, në mesazhin e tij të fundit të prillit 1967, luftëtari shkruan: "Duhet bërë lufta deri ku e bën armiku: në shtëpinë e tij, në vendet e dëfrimit; duhet bërë totalisht". Fjalë që në ditët e sotme rezultojnë mallkueshmërisht aktuale midis fanatikëve të terrorizmit islamik. (bota.al)

Trajtimet deri më tani kanë përfshirë kremra antihistamine dhe steroide, ndërsa në rastet serioze, antibiotikë me spektër më të gjerë. Por me rezistencën në rritje mund të jetë shumë e vështirë për të gjetur trajtimin e duhur për të luftuar infeksionet

PICKIMI NGA MIZA E KALIT MUND TË REZULTOJË VDEKJEPRURËS



Edhe pse jemi në vitin 2018 është ende e mundur që të vdesim nga kafshimi i insekteve dhe jo vetëm në vendet me klimë të nxehtë, por kudo. "Ne nuk kemi investuar në ato antibiotikë që kemi nevojë për të luftuar infeksionet bakteriale, të cilat ndryshojnë gjithmonë", tha profesori Colin Garner.

Efektet e pickimit të mizës së kalit mund të përfshijnë ënjtje dhe skuqje të fortë të lëkurës, marra-

mendje, vështirësi në frymëmarrje, gjymtyrë të dobët dhe të fryrë. Rreziqet janë më të mëdha për personat me një sistem të dobët imunitar, pasi nëse medikamentet nuk funksionojnë, atëherë edhe gërvishtjet e vogla mund të bëhen shumë shpejt serioze.

Trajtimet deri më tani kanë përfshirë kremra antihistamine dhe steroide, ndërsa në rastet serioze, antibiotikë me spektër më të gjerë. Por me rezistencën në

rritje mund të jetë shumë e vështirë për të gjetur trajtimin e duhur për të luftuar infeksionet.

Profesori Garner shtoi: "Ja pse kemi nevojë për të zhvilluar medikamente të reja dhe të shpejta për t'ia dalë me klimën tonë të ndryshueshme dhe situatave të papritura, si epidemia e kafshimit nga miza e kalit. Ne kemi paralajmëruar prej kohësh që antibiotikët tanë nuk kanë efekt dhe se do të arrijmë në situatën ku njerë-

zit do të vdesin sërish nga gërvishtja ose pickimi i kësaj mize".

Ai tregoi se është pickuar së fundmi nga miza e kalit dhe se po vetë-mjekohet me krem dhe një tabletë atihistamine, në mënyrë që vendi i kafshimit të mos infektet. Shërbimi Kombëtar Shëndetësor këshillon vizitë te mjeku nëse pickimi i insekteve rezulton me simptoma të infeksionit, si qelb, skuqje, enjtje apo dhimbje e shtuar.



Dëmet e mëdha të yndyrave

Një regjim ushqimor i pasur me yndyra dhe kolesterol të lartë është tepër i dëmshëm për organizmin e njeriut, por në veçanti, problemet më të mëdha lidhen me prostatën. Mjekët urologë në Itali kanë marrë në shqyrtim statistikat shëndetësore dhe ushqimore të 36 mijë meshkujve të moshës nga 40-99 vjeç, të cilët janë ndjekur për 14 vjet. Rezultatet se ata që kishin kolesterol të lartë dhe konsumonin ushqime të pasura me yndyra, kishin 25% deri në 37% më tepër rrezik që të prekeshin nga tumori në prostatë. Mjekët urologë këshillojnë që strategjia e nevojshme është korrektimi i dietës, duke reduktuar kështu nivelin e yndyrave të dëmshme dhe përmirësimi i mënyrës së të ngrënit. Studimet e kryera janë publikuar në revistat shkencore Prostate dhe Oncotarget.

Vetmia si sëmundje gjenetike!

Të jesh vetmitar apo social varret nga genet. Kështu sugjeron një studim i Universitetit të Cambridge pas një analize që ka marrë në shqyrtim 500 mijë vullnetarë në Britaninë e Madhe. Rezultatet janë publikuar në revistën Nature Communications.

Sipas studiuesve, është edhe faktori biologjik në bazë të vetmisë patologjike që disa persona i bllokon për të hyrë në kontakt me të tjerët edhe kur e dëshirojnë në gjë të tillë. Janë identifikuar 15 variante gjenetike që lidhen ngushtë me izolimin shoqëror, ndër-

sa të tjera që gjenden në ata njerëz që janë më të hapur dhe frekuentues të ambienteve të ndryshme sociale. Sipas kërkuesve, kjo është ndoshta edhe një ndër arsyt përse disa medikamente antidepresive nuk janë efikase njësoj në të gjithë

pacientët. Në këtë studim është vënë re gjithashtu edhe një lidhje mes vetmisë, simptomave depressive dhe mbipeshës. Rezultatet do të ndihmojnë në rrugën e një psikiatrie më precizion me të lartë dhe të shoqëruar me terapi të individualizuara.



A shkaktojnë alergjitë çrregullime mendore?

Duket e pamundur që shëndeti mendor dhe alergjitë të jenë të lidhura në ndonjë mënyrë. Sekretionet në hundë dhe lëkura e irrituar duket se nuk funksionojnë paralelisht me nxitjet mendore. Megjithatë, një studim i ri ka arritur në përfundim se personat me astmë, ekzemë dhe alergji nga bari kanë një rrezik në rritje për të zhvilluar çrregullime të shëndetit mendor.

Studimi bazohet në punën e mëparshme dhe forcon kërkimet e mëhershme, gjithashtu mund të udhëzojë mjekët në mënyrën se si duhet të trajtohen pacientët me këtë alergji. Astma, riniti alergjik (alergjia nga bari) dhe dermatiti atopik (ekzemë), janë disa nga alergjitë më të zakonshme dhe

quhen tre "A-të". Studimi i botuar në revistën "Frontiers in Psychiatry", zbuloi lidhjet midis shëndetit mendor dhe tre A-ve. Dr Nian-Sheng Tzeng, nga spitali Tri-Service General në Tajvan dhe autori kryesor i studimit, vuri re diçka të papritur në lidhje me pacientët që vuanin nga këto alergji specifike.

Sipas Dr. Tzeng, "si një klinik, vura re se disa pacientë me tre A-të kishin shfaqur luhajtje të shëndetit mendor. Prandaj, dëshiroja të sqaroja nëse këto sëmundje alergjike janë të lidhura me çrregullime psikiatrike". Pavarësisht studimit të mëparshëm mbi lidhjen mes shëndetit mendor dhe alergjive, nuk kishte pasur studime mbi lidhjen midis tre A-ve dhe rrezikut të zhvillimit të çrregullimeve

psikiatrike.

Në studimin aktual, 10.8% e subjekteve zhvilluan çrregullime psikiatrike krahasuar me 6.7% të grupit të kontrollit. Nga tre A-të, ekzema kishte rrezikun më të vogël. Studimi gjithashtu tregoi se përdorimi i barnave të caktuara kundër astmës uli rrezikun e zhvillimit të një çrregullimi psikiatrik. Studimi nuk ka shqyrtuar shkakun e mundshëm të kësaj lidhjeje të çuditshme duhet të bëhen kërkime të mëtejshme për të kuptuar përse ndodh ky fenomen. Megjithatë, duke ditur që ekziston një lidhje mes alergjive të caktuara dhe çrregullimeve mendore kjo gjë mund të ndihmojë mjekët në trajtimin dhe kujdesin ndaj pacientëve të tyre.



DASHI 21. mars - 20. prill
Përsa i përket punës jetë ju këshillojnë të tregoheni më të shkathët në qoftë se doni që të ardhurat tuaja të rriten. Kini besim te forca juaja e brendshme, te kuraja për të përballuar pengesat të ndryshme. Duhet të keni parasysh që çdo pengesë që mund të kaloni do ju shërbejë si një eksperiencë e mirë jete.

DEMI 21. prill - 21. maj
Shumica e planetëve janë në favorin tuaj duhet të tregoheni elastikë në gjëra pa vlerë dhe të vendosur në ato më të rëndësishmet. Situata më të gjalla do të paraqiten për ata që punojnë në sektorin artistik. Do të kaloni një mbrëmje romantike me partnerin.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Për të mbajtur një humor të qëndrueshëm dhe për të mos humbur energjitë e grumbulluara këto ditë, mundohuni të largoni çdo lloj stresi dhe të reflektoni në qetësi çdo situatë. Në dashuri do të vlerësoni shumë dedikimin e partnerit ndaj jush.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Marsi kthehet në shenjën tuaj duke ju dhuruar më shumë energji dhe duke i dhënë gjallëri marrëdhënieve me personat që ju rrethojnë. Hëna sot është e favorshme për të kontrolluar më mirë llogaritë tuaja bankare. Takime interesante me persona që i përkasin shenjës së Demit, Virgjërshës dhe Akrepit.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Kjo e diel do ju gjejë mjaft produktiv dhe të dobishëm. Edhe në dashuri do të rigjeni forcën që keni kërkuar prej kohësh dhe do të rezultoni mjaft tërheqës.

VIJGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Do që të merrni më shumë rezultate dhe konfirmime nga ana e partnerit/ës, sidomos nëse gjatë ditëve të fundit jeni ndërjerë të lënë pas dore. Kjo e diel është mjaft e favorshme për të qenë strategjik dhe për të çuar përpara projekte në vendin e punës.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Ky është një moment shumë i mirë për të vlerësuar disa situata profesionale, të cilat ju kanë përhumbur dhe tensionuar kohëve të fundit. Do të nisni të vlerësoni disa propozime të cilat mund ti japin një kthesë të rëndësishme karrierës suaj.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Do të jeni gati të lodheni më shumë, vetëm që të ndihmoni kolegët në vështirësi dhe kjo gatishmëri e juaja do ju lejojë që të merrni një rol më të shumë përgjegjësi. Në dashuri do të jeni në kërkim të aventurave të reja romantike.


SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Duhet të jeni më të drejtpërdrejt në raport me kolegët tuaj, sidomos nëse ka çështje që kanë mbetur pezull dhe që mund t'iu pengojnë. Në dashuri ky është një moment shumë i mirë për të shprehur hapur ndjenjat tuaja.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Në investime nuk duhet të jeni shumë impulsiv, pasi në këtë moment duhet të përqendroheni në organizimin e rezervave që keni, me qëllim vënien në zbatim të një projekti të ri. Sa i takon dashurisë, parashikohen takime mjaft të favorshme.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Duhet të jeni më të gatshëm për një ballafaqim me një familjar apo partner/e. Së fundmi keni përjetuar jo pak tensione, por tani do të keni mundësi që të hapeni për dialog dhe të gjeni zgjidhje të frytshme. Në vendin e punës duhet të përkushtoheni më shumë, në mënyrë që të shpërbleheni.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Kjo e diel është mjaft e favorshme për të rizgjuar pasionin dhe për të rigjetur bashkëpunimin e humbur me partnerin/en. Edhe ata që janë vetëm do të rezultojnë më joshës dhe mund të bëjnë për vete persona interesantë. Biznesi është mjaft i favorshëm.

Mensur Mamuti	ATLETI AMERIKANË NË FOTO	FRUT MALOR, I NGJASHËM ME BORONICËN	AUTORI FRENG, ALFONS	OKSIGJENI	QYTETI I LINDJES SË ATLETIT NË FOTO
MALËSOR					
KËNGËTARJA, RITA				AUSTRIA DUSHMAN	
VEPËR LETRARE					
RËSHQITËSI LTONIAN, KIVLENIËKS					
AKULLINAJË NË ANTARKTIK, ... GLASIER					
BËJ GATI, GATTIT (BISED.)					
RUMANIA		PANJUHURA E PARE QË KA TË BËJË ME ARITMETIKËN			
AUTORI ANGLEZ, FLEMING				IMPULSI VRAPUES I SHPEJTË, SHIH FOTON	
NUMËR			SKËNDER TEMALI MARS EXPLORATION PROGRAM		QYTET HISTORIK NË ZVICËR
KOHA	TËRËSIA E PAJISJEVE PËR PRODHIM SHAKATAR, HOKATAR				NEODYMIUM ALUMINIUM BORATE
THAHET				NDESHJET SPORTIVE QYTET NË UKRAINË	QYTETI I ILIAD
K					KOHA
POSEDON (VETA II)		LIDHËZ, OSE, JA (BISED.)			NGSTREMI
BRINJË TË TREKENDËSHIT		ISH VOLEJBOLLISTJA SHQIPTARE, TASE			VENDI I KAMP BOTËROR 1997, KU E FITOI ARIN ATLETI NË FOTO
K				LLOJ PEME (PEKMEZI) PASKJALINA GRUDA	
XHAZISTI AMERIKAN, DIZI					
SHTET NË AMERIKËN E MËSMË					ASTATI ANGSTREMI
N					TEMPERATURA



ZGJIDHJET: MALOK, ORA, A ROMAN, INARS, SIRMA, GATIS, R, IKS, IAN, I NR, ST, IMPIANT, A, SHTER, GARAT, KAMPION BOTE, KE, NDO, JIN, KATEFE, MANI, XHILESPI, AS, NIKARAGUA, T.

Shumë i lehtë Sudoku mesatar

				3			1								8						5			
4		7	1	5		6									9	7		5	2					
			3			2									4								2	9
			8	4		7									7				6	9				
1	7														4			5	2	7			6	
		4		8		1	5											4	8					9
7				3											8								7	4
			4		8	5											6	9	4				8	5
2				1													3							

Shumë i lehtë: 526934871, 497158623, 813672495, 358427169, 179563248, 642891537, 781346952, 934285716, 265719384. Mesatar: 682394571, 197652438, 534718629, 378169254, 941527863, 265483197, 819235746, 726941385, 453876912.



GJASHTË KOLEGE INFERMIERE SHTATZËNË NË TË NJËJTËN KOHË!

Një grup infermieresh të departamentit të onkologjisë në Qendrën Mjekësore Baptiste në Winston-Salem, NC, po jetojnë një kohë të pazvëndësueshme njëherësh.

Kohët e fundit, u zbulua se gjashtë gra të këtij departamenti janë shtatzënë në të njëjtën kohë. Grupi i nënave të ardhshme u përfshinë në "Fabulous Six-Pack" - dhe po, janë ethe e foshnjave që po vijnë në jetë. Po lajmi zyrtar i pritjes së ëmbël? 32-vjeçarja Nina Day zbuloi e para se ishte në pritje të një fëmije që pritet të vijë në jetë më 31 korrik, Bethany Stringer mori lajmin e dyta dhe pritet të lindë më 8 shtator. Emily Johnson është e treta në radhë (25 shtator), e ndjekur nga Nikki Huth (11

tetor), Sabrina Hudson (13 nëntor) dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, Katie Carlton (12 dhjetor).

Sipas Today, pasi e ndau lajmin me koleget se ishte në pritje të fëmijës së dytë, Sabrina vuri në dukje se Katie do të ishte nëna tjetër, e gjashtë. Dhe ky ishte, natyrisht, lajmi tjetër i mirë, sepse Katie kishte dëshirë të kishte një fëmijë të dytë me bashkëshortin e saj. Vetëm një muaj më vonë, Katie u surprizua pasi mësoi se ishte shtatzënë pas 5 kolegeve të saj dhe u çudit se sa shpejt erdhi shtatzënia e saj, edhe me suportin e kolegeve: "Sinqerisht, është një eksperiencë shumë e bukur", - thotë Katie. "Pas pesë shtatzënieve, isha shumë e lumtur të thosha se

dikush tjetër është në pritje të një fëmije."

Naturisht, 6 nëna shtatzënë në të njëjtën kohë është edhe një temë diskutimi për pacientët? "Siguriiiisht" - përgjigjen ato njëzëri: "I intrigon njerëzit dhe u jep mundësi të fokusohen kur nuk janë të përqendruar". Por pavarësisht pyetjeve, të gjitha këto nëna janë të lumtura që po jetojnë pritjen e ëmbël në të njëjtën kohë. "Që shumë nëna janë shtatzënë në të njëjtën kohë, kjo nuk është gjë e rrallë", thotë Sabrina. "Ne jemi shumë entuziaste për fëmijët tanë dhe mezi po presim datat. Nuk mendoj se pas shtatzënisë nuk do të kemi më gjëra të përbashkëta për të ndarë me njëra-tjetrën".

Apple e para! Gjigantët më të mëdhenj të teknologjisë në botë

Kompanitë e mëdha mund të gjenden pothuajse në çdo vend të botës. Për shembull, kompanitë për prodhimin e veturave në masë mund të gjenden gjithandej në hartën e botës. Ford nga SHBA, Toyota e Japonisë, Volkswagen - Gjermani, Hyundai - Korea e Jugut, Volvo e Suedisë, Tata Motors e Indisë e Magna nga Kanada, janë vetëm disa nga kompanitë më të mëdha që prodhojnë çdo pjesë të veturave. E edhe bankat, farmacitë, kompanitë energjetike e industritë e ndryshme gjithashtu janë të shpërndara gjithandej, por kjo nuk mund të thuhet edhe për industrinë e teknologjisë që është rritur tepër shpejt. Në 20 gjigantët globalë të teknologjisë, asnjë prej tyre nuk gjendet jashtë Shteteve të Bashkuara e Kinës. Këto janë 20 kompanitë më të mëdha teknologjike në botë: 7 kompanitë e para përbëjnë 81% të vlerës totale të listës, e që së bashku vlerësohen mbi 450 miliardë dollarë. Aty përfshihen që nga kompania që udhëheq, e që është kompania më e vlefshme në botë, Apple pasuar nga Alphabet, Amazon e Microsoft e Facebook, por pas tyre renditen edhe 2 kompani kineze, Tencent e Alibaba.



Martesa e keqe dëmton shëndetin

Një martesë e keqe me konflikte të shpeshta mund të shkaktojë probleme serioze në shëndetin tuaj, ka treguar një studim i realizuar së fundmi. Hulumtuesit e universitetit të Nevadës dhe Michigan-it kanë analizuar 373 çifte për të parë nëse mosmarrëveshjet rreth çështjeve të ndryshme, siç janë çështjet e fëmijëve, financave, aktiviteteve gjatë kohës së lirë, kanë ndikim negativ në shëndet.

Ata kanë treguar se konfliktet martesore ndikojnë negativisht në shëndetin e burrave dhe grave, ndonëse ekziston një ndikim më i madh te meshkujt sesa te femrat. Çiftet që e kanë më të lehtë të merren vesh me njëri-tjetrin gëzojnë përfitime shëndetësore në fillimet e para të lidhjes, por ky efekt mbrojtës largohet gjatë viteve të vonshme të martesës.

Konfliktet në lidhje mund të shpijnë në inflamacion, ndryshim në apetit, nivele të larta të kortizolit (hormon i stresit), e që të gjitha këto mund të shpijnë në sëmundje të zemrës apo në sëmundje tjera.

636 - Arabët marrin nën kontroll pjesën më të madhe të Palestinës nga ana e Perandorisë bizantine.

1148 - Kryqëzatat sulmojnë Damaskun.

1215 - Frederiku II kurorëzon veten Mbret roman katolik.

1298 - Hebrenjtë masakrohen në Vurzburg të Gjermanisë.

1431 - Hapet Këshilli i Bazelit.

1540 - Turqia njeh Janosh Zigmund Zapoljain si vazal - mbret të Hungarisë.

1793 - Prusia okupon Majensin.

1798 - Napoleoni okupon Aleksandrinë në Egjipt.

1914 - Austro-Hungaria i jep ultimatum Serbisë dhe kjo çon deri te fillimi i Luftës së Parë Botërore.

1944 - Trupat amerikane okupojnë qytetin Piza të Italisë.

1973 - Kryetari Nikson refuzon të lëshon incizimet e Watergate bisedave në Shtëpinë e Bardhë në lidhje me hulumtimin Watergate.

1978 - Qeveria izraelite refuzon thirrjen e kryetarit të Egjiptit, Sadatit për kthimin e dy hapësirave të Sinait.



Lënda e Lumturisë bëhet pjesë e kurrikulës së arsimit në më shumë se 1 000 shkolla në kryeqytetin e Indisë, New Delhi. Lënda e Lumturisë, që është projekt i ministrit të Arsimit të Nju Delhit, Manish Sisodia, ka filluar të praktikohet në më shumë se 1000 shkolla që nga fillimi i kësaj jave. Kjo lëndë zhvillohet çdo ditë dhe zgjat 30 deri në 45 minuta.

CILI ËSHTË...

- Mësuesja: Beni, cili është presidenti i SHBA-ve?
- Beni: Nuk e di mësuese.
- Mësuesja: Beni, duhet të kujdesesh më shumë për mësimet.
- Beni: Po ti mësuese, e di cila është Maria?
- Mësuesja: Jo.
- Beni: Duhet të kujdesesh më shumë për burrin tënd.



Do t'i ruash fshehtësitë prej armiqve? Mos ua thuaj miqve!

(Fatmir Muja)